

ARSIM
QYTETAR
PËR KLASËN E 9-TË
•UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS•

PËRMBAJTJE

Tema

1	IDENTITETI QYTETAR	4
----------	---------------------------------	----------

Tema

2	BASHKËPUNIM DHE LIDHSHMËRI NË SHOQËRINË QYTETARE	48
----------	---	-----------

Tema

3	QYTETARI DHE SHOQËRIA QYTETARE	116
----------	---	------------

Tema

4	KULTURA, IDENTITETI KULTUROR, RELIGJIONI DHE MEDIAT SOCIALE	160
----------	--	------------

Tema

5	QYTETARI DHE SHTETI	202
----------	----------------------------------	------------

Tema

6	QYTETARI DHE EVROPA	248
----------	----------------------------------	------------

Tema

1

IDENTITETI QYTETAR

Përmbajtja:



Zhvillim i
veçorive
personale

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të sqarojë zhvillimin e veçorive personale, të bëj dallimin mes veçorive të tij/saj dhe veçorive të të tjerëve.



Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësjë është i/e aftë të:

- ➔ Analizojë dhe vlerësojë zhvillimin e veçorive personale dhe shqyrton përparimin, suksesin dhe sfidat
- ➔ Vendosë qëllime reale që janë të harmonizuara me veçoritë dhe mundësitë e tij/saj dhe është i/e përgjegjshëm/e dhe këmbëngulës/e në arritjen e të njëjtave.



Materiale të nevojshme:

Fleta pune 1.1. dhe 1.2., letër, stilograf.



Metoda dhe teknika:

Punë individuale, punë në çifte, intervistë, diskutim grupor.



Pjesa hyrëse e orës

(10 min.)

Në pjesa hyrëse e orës arsimtari i njofton nxënësit se do të punojnë në planifikimin, vendosjen dhe realizimin e qëllimeve.

Aktivitet **Më-momenti** **(ngjarje)**

Nxënësit punojnë në çifte. Kanë për detyrë të përkujtohen në ndonjë moment të rëndësishëm që u ka ndodhur gjatë vitit. Kjo mund të ndërlidhet me diçka që kanë arritur, me diçka me të cilën krenohen, diçka në të cilën kanë punuar dhe kanë dhënë mundin e tyre. Mund të jetë diçka që i ka bërë të lumtur dhe që u është shumë e rëndësishme. Së pari njëri anëtar i çiftit e përshkruan/rrëfen këtë moment, ndërsa nxënësi/nxënësja tjetër dëgjon me kujdes, parashtron pyetje përmes të cilave tenton të mësojë sa më shumë detaje interesante.



Diskutim

Arsimtari e fillon diskutimin me pyetjen: Çfarë mendoni pse filluam me aktivitetin “Më-momenti”? Dëgjohe përgjigjet e nxënësve dhe konstatohet se nga ky aktivitet mund të mësojmë për gjërat që i vlerësojmë dhe të cilat na janë të rëndësishme, gjegjësisht për vlerat tona. Vlerat më tutje mund të shërbejnë si bazë për vendosjen e qëllimeve tona në jetë. Vlerat më tutje mund të shërbejnë si bazë për vendosjen e qëllimeve tona në jetë. Njëherësh, mësuam edhe për mënyrat në të cilat ne i arrijmë qëllimet tona, gjegjësisht për veçoritë tona.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Qëllimet dhe rezultatet e pritura që duhet të arrihen me këtë përmbajtje nuk përfshijnë dituri teorike. Për shkak të kësaj, pjesa kryesore e orës përbëhet prej aktiviteteve përmes të cilave nxënësit do të përvetësojnë shkathtësi për vlerësim të veçorive dhe aftësive personale, si dhe aftësi për vendosjen e qëllimeve personale dhe analizimin e përparimit në arritjen e të njëjtave.

Aktivitet **Identiteti im**

Arsimtari ua shpërndanë nxënësve fletën e punës 1.1. dhe jep udhëzime se si ta plotësojnë në mënyrë të pavarur.

Pas mbarimit të punës individuale, arsimtari i parashtron pyetjet vijuese për diskutim:

Çfarë mendoni, pse e bëmë këtë aktivitet?

Çfarë lidhje kanë veçoritë tuaja me vendosjen e qëllimeve për zhvillimin personal?



Arsimtari bën rezymon se që të mund të planifikojmë zhvillimin tonë, është shumë e rëndësishme të njohim vetveten, vlerat tona, veçoritë, faktorët që ndikojnë në formimin e tyre dhe ngjashëm. Sa më mirë që i dimë karakteristikat personale, aq më të shkathët do të jemi në përcaktimin e qëllimeve tona dhe mënyrave për arritjen e të njëjtave. Në këtë mënyrë realizojmë vetveten si qytetarë të cilët kontribuojnë në bashkësinë në të cilën jetojnë.

Përpunimi i përmbajtjes vazhdon me aktivitetin vijues – Intervistë.

Aktivitet Intervistë



Nxënësit vazhdojnë të punojnë në çifte nga aktiviteti fillestar. U shpërndahet fleta e punës 1.2. Njëri anëtar i çiftit ka për detyrë të vendosë një qëllim që dëshiron ta arrijë gjatë një viti, ndërsa anëtari tjetër i çiftit me ndihmën e intervistës duhet t'i ndihmojë që ta përpunojë në mënyrë të detajuar planin për realizimin e qëllimit të tij/saj. Nëse ndonjë nxënës/e është i/e pavendosur rreth vendosjes së qëllimit të tij/saj, anëtari tjetër i çiftit mund t'i parashtrijë pyetje plotësuese që do t'i ndihmojnë të zbulojë fokusin e tij/saj, gjegjësisht fushën në të cilën do të donte të orientohej. Kjo mund të jetë diçka që i është e rëndësishme dhe këndshme, apo nga ana tjetër, diçka që i mungon, por që e dëshiron.



Pyetje për diskutim:

- ➔ Si ju pëlqeu puna në çifte?
- ➔ Si u ndjetë kur udhëheqnit intervistën, e si kur përgjigjeshit në pyetjet dhe flisnit për vetëveten?
- ➔ Çfarë mësuat për veten? Për bashkënxënësin tuaj?
- ➔ Çfarë mendoni, a është më mirë që të planifikohet ose të lihen që gjërat të ndodhin vetvetiu? Kur është e arsyeshme të planifikohet, e kur të lihen gjërat që të ndodhin vetvetiu?
- ➔ Çfarë mund të bëni kur diçka nuk ju shkon ose kur nuk ia dilni të realizoni/arrini qëllimin?



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Përfundim

Që të mund të realizojmë atë që e dëshirojmë, ekzistojnë gjëra që varen prej vetë nesh dhe me të cilat mund të ndikojmë në të arriturat tona. Para së gjithash, **duhet të njihemi mirë** dhe të kemi pasqyrë reale për aftësitë, potencialet dhe dituritë tona në atë moment. Më pas, **duhet të duam të pranojmë sfida** dhe të jemi të përkushtuar, të qëndrueshëm në arritjen e të njëjtave. Për të arritur këtë **duhet të jemi të organizuar mirë** dhe t'i planifikojmë hapat/aktivitetet.

Është shumë me rëndësi që **të kemi vetëbesim**, gjegjësisht **besim pozitiv në vetveten** se mundemi dhe dimë të bëjmë atë që e dëshirojmë. Mbi vetëbesimin tonë ndikon shumë raporti pozitiv dhe nxitës i prindërve, arsimtarëve dhe miqve.

Edhe vetë mund të ndikojmë në vetëbesimin nëse mundohemi që në çdo situatë të japim gjithçka nga vetja për t'ia dalur, **duke pranuar se përkundër kësaj është i mundshëm mossuksesi**.



Fletë pune numër 1.1. Identiteti im

➔ Mendo për veten dhe aspekte të caktuara të identitetit tënd. Përgjigju në pyetjet vijuese.

➔ Cilat veçori i posedoj (për shembull: qëndrueshmëri, transparencë, ndjeshmëri, nervozizëm, të qenë i zellshëm, të qenët i shoqërueshëm, introvert, ekstrovert, përtac, kreativitet, kureshtar, realist, përshtatshmëri...):

.....

.....

➔ Kur, në çfarë periudhe të jetës (fëmijë i vogël, moshë parashkollore, moshë shkollore) më janë zhvilluar këto veçori:

.....

.....

➔ Në zhvillimin e këtyre veçorive më kanë ndikuar: familja, shkolla, moshatarët, tjetër / të tjerë (kush/cilët):

.....

.....

➔ Cilat veçori i ndaj me shumicën e moshatarëve të mi:

.....

.....

➔ Cilat veçori janë karakteristike vetëm për mua:

.....

.....

➔ Çfarë individi dua të bëhem? Cilat veçori dua t'i ndryshoj, cilat t'i zhvillojë në mënyrë plotësuese?

.....

.....

Pasi të përgjigjesh në pyetjet, shpërndaj dhe krahaso përgjigjet tua me përgjigjet e nxënësit/es në çift. Bisedoni lidhur me atë se në çfarë jeni të ngjashëm, e në çfarë të ndryshëm.



Fletë pune numër 1.2. Intervistë

- ➔ Punoni në çift. Mësoni sa më shumë për bashkënxënësin tuaj dhe parashtroni pyetje që t'i ndihmoni për ta përkufizuar qëllimin e tij dhe planin se si ta realizojë. Përdorni katër tërësitë vijuese:

Qëllim

.....

- ➔ Paramendoni veten pas një viti. Çfarë do të doje të arrish? Çfarë qëllimesh ke vendosur për veten? Zgjidh një qëllim në të cilin do të punojmë sot. Nëse partneri yt ka problem rreth përkufizimit të qëllimit, parashtroni ndonjërin prej këtyre pyetjeve:
- ➔ Çfarë dëshiron të bësh më së shumti (në shkollë, në kohën e lirë)? Çfarë të bën të lumtur? Në çfarë je më i/e mirë? Për çfarë do të thoshin të tjerët se je i/e mirë (se je i aftë për atë)? Çfarë mendon tani, cili është qëllimi yt?

Nxënësi/ja 1:

Nxënësi/ja 2:

Realizim

.....

- ➔ Tani bëj plan. Çfarë është më me rëndësi për të realizuar qëllimin tënd? Çfarë duhet të mësosh, të bësh, të ushtrosh, të ndryshosh për të realizuar qëllimin tënd? Cilat shkathtësi duhet t'i zhvillosh? Si e paramendon veten pasi që e ke realizuar qëllimin tënd? Përshkruaj: Çfarë bën, si dukesh, kush është atje? Çfarë më tutje?

Nxënësi/ja 1:

Nxënësi/ja 2:

Hapa të parë

.....

- ➔ E tani fillojmë! Përpunoi hapat e parë që duhet t'i ndërmarrësh. Cila është gjëja e parë që do ta bësh (që sot ose nesër)? Kush mund të të ndihmojë? Çfarë do të bësh më tutje? Sa kohë do të të nevojitet? Çfarë mund të rezultojë si pengesë/problem? Si do ta tejkalosh? Çfarë do të ndërmarrësh dhe kush mund të të ndihmojë?

Nxënësi/ja 1:

Nxënësi/ja 2:

TANI NDRYSHONI ROLET NË ÇIFT.

Përmbajtja:



Zhvillim i
veçorive
personale

Ora e dytë



Qëllime:

Nxënësi/nxënësja:

- ➔ Të sqarojë zhvillimin e veçorive personale, të bëjë dallimin mes veçorive të tij/saj dhe veçorive të të tjerëve.



Rezultate nga mësimi:

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- ➔ Analizojë dhe vlerësojë zhvillimin e veçorive personale dhe i shqyrton përparimin, sukseset dhe sfidat
- ➔ Vendosë qëllime reale që janë të harmonizuara me veçoritë dhe mundësitë e tij/saj dhe është përgjegjës/e dhe këmbëngulës/e në arritjen e të njëjtave.



Materiale të nevojshme:

Fletë pune 1.3., letër, stilograf.



Metoda dhe teknika:

Analizë e rastit, punë individuale, diskutim në grup.



Pjesa hyrëse e orës

(5 min.)

Aktivitet **Analizë e rastit**


Mësimdhënësi ua lexon nxënësve tekstin si vijon:

Në një shkollë në Japoni mësimdhënësi ka dashur të kontrollojë këmbënguljen dhe përkushtimin e nxënësve të tij. Në orën e matematikës u ka dhënë të zgjidhin detyrë për të cilën ka theksuar se është shumë e ndërlikuar. Nxënësit kanë punuar në këtë detyrë një orë, duke u munduar me këmbëngulje që ta zgjidhin, ndonëse askush nuk ka arritur të zgjidhja. Ata nuk kanë hequr dorë përderisa mësimdhënësi nuk u ka thënë se detyra në fakt nuk mund të zgjidhet.

Pyetje për nxënësit:

- ➔ Si do të kishit vepruar ju në një situatë të tillë? Deri kur do të kishit tentuar që ta zgjidhni detyrën?
- ➔ Pse konsideroni se nxënësit në Japoni kanë vepruar në mënyrë të tillë? Si do të kishin vepruar nxënësit në vendin tonë?
- ➔ Çfarë mendoni, si është pikëpamja e tyre për aftësitë e tyre? Me çfarë është përcaktuar pikëpamja e këtillë?

Mësimdhënësi bën përmbledhje se në disa kultura të caktuara vlerësohet shumë këmbëngulja dhe orientimi drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara. Konsiderohet se përmes bërjes së përpjekjes në arritjen e një detyre të caktuar, individ i përmirëson aftësitë e tij, po madje edhe nëse nuk arrin që ta përfundojë detyrën.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në fletën e punës 1.3. Më pas mësimdhënësi fillon diskutimin lidhur me pyetjet që janë parashtruar në fletën e punës 1.3.

- ➔ Çfarë mendoni, çfarë individ është ai/ajo i/e cili/a në katër pyetje të pjesës 1 është përgjigjur me P0? (përgjigje potenciale: për ta është me rëndësi të duken të mençur, për ta është me rëndësi se çfarë mendojnë të tjerët për ta, konsiderojnë se aftësitë nuk mund të ndryshohen duke bërë përpjekje, heqin dorë lehtë)
- ➔ Individ i cili në katër pyetjet e pjesa 1 është përgjigjur me J0? (përgjigje potenciale: e kundërta nga ajo paraprake. Nuk është për ta aq me rëndësi se si i shikojnë të tjerët, nuk heqin dorë nga sfidat, konsiderojnë se me punë, përpjekje mund të përmirësohen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre)
- ➔ Çfarë do të thonë katër përgjigje pozitive për mundësitë e zhvillimit, përparimit, suksesit të individit? (përgjigje potenciale: individ i me qëndrimet e tij i kufizon mundësitë për zhvillim dhe sukses)
- ➔ Çfarë do të thonë katër përgjigje negative? (përgjigje potenciale: individ i me qëndrimet e tij i zmadhon mundësitë për zhvillim dhe sukses)

Pyetjet e njëjta parashtrohen për deklaratat nga pjesa 2.

(përgjigje potenciale për P0: Këmbëngulës, nuk heqin dorë, duan sfidë, duan të tejkalojnë vetveten, garojnë me vetveten, optimistë)...



Pjesa përfundimtare e orës

(10 min.)

Përfundim

Hulumtimet tregojnë se në bazë të përgjigjeve të dhëna në pyetjet e këtilla dhe të ngjashme, dallohen dy lloje të besimit për zhvillim të aftësive dhe karakteristikave të individit.

Për individët të cilët besojnë se aftësitë janë të lindura dhe se nuk mund të përmirësohen, sado që të mundohen, është me rëndësi mendimi i të tjerëve për ta. Ata duan të jenë të lavdëruar se sa janë të mençur dhe ndjehen keq nëse të tjerët nuk mendojnë ashtu për ta. Nxënësit të cilët kanë bindje të këtilla janë të fokusuar në notat, krahasohen vazhdimisht me të tjerët dhe janë të palumtur nëse nuk janë më të mirë se ata.

Individët të cilët besojnë se mund të arrijnë sukses nëse bëjnë përpjekje të mjaftueshme fokusohen në mësimin, krahasohen me vetveten dhe për ta është me rëndësi që të tjerët ta vërejnë punën e tyre. Kjo i motivon për punë dhe mësim. Gabimet i kuptojnë si normale në punë dhe mësim dhe konsiderojnë se dështimi mund të tejkalohet nëse bëhet përpjekje e mjaftueshme.

Edhe sukcesi edhe dështimi janë pjesë e jetës së çdo njeriu. Kur në një aktivitet arrijmë sukses kjo na motivon që edhe më tutje të vazhdojmë të angazhohemi. Rritet vetëbesimi dhe me këtë rriten gjasat për sukses të ri. Por, ndonjëherë arritja e suksesit mund të na "relaksojë", ndaj mund të pushojmë së përpjekuri aq shumë dhe të përjetojmë dështim. Dhe anasjelltas, nëse dështimin e pranojmë si diçka që është pjesë e jetës së përditshme dhe nëse na nxitë që ta analizojmë sjelljen dhe situatën tonë dhe kuptojmë se ku kemi gabuar, mund të na ndihmojë që t'i përmirësojmë gabimet dhe të arrijmë sukses në ndonjërin prej tentimeve të radhës.

Njëra prej mënyrave për tejkalimin e dështimit është vendosja e qëllimeve reale dhe përpilimi i planit për realizimin e tyre. Plani zakonisht përmban qëllimin, kornizën kohore, hapa konkret për realizimin e qëllimit, burime të mbështetjes dhe ndihmës, probleme të mundshme dhe mënyra për tejkalimin e tyre dhe realizimin e të arriturave.

Është shumë e rëndësishme që të kemi qëndrim dhe bindje se aftësitë tona nuk janë dhënë një herë e përgjithmonë dhe mund të zhvillohen përmes mundit dhe punës me vetveten. Individët të cilët kanë qëndrim të këtillë ndaj aftësive personale vendosin qëllime reale që janë të harmonizuara me veçoritë dhe mundësitë e tyre. Ata janë këmbëngulës në arritjen e qëllimeve të tyre dhe nuk heqin dorë lehtë kur të përballen me disa pengesa të caktuara. Kërkimi i sfidës, synimi drejt qëllimeve më të larta mund të përfundojë me dështim dhe frustrim, por sa më shumë që të kërkojmë sfida, aq më shumë kthehemi mbrapa pas tentimeve të dështuara dhe bëhemi gjithnjë e më shumë të qëndrueshëm ndaj dështimit dhe frustrimit.

Hulumtimet kanë treguar se vetëvlerësimi i lartë i kapaciteteve personale për mësim i inkurajon nxënësit që të përfshihen në mënyrë aktive në mësim dhe ta zhvillojnë ndjenjën e qëndrueshmërisë, të inkurajohen për bërjen e përpjekjes më të madhe dhe të durojnë në detyra më të vështira.



Aktivitet për reflektim

Gjatë aktivitetit për reflektim, nxënësit duhet të vendosin se cili prej qëndrimeve të tyre për vetveten dhe veçorive të tyre potencialisht i kufizojnë mundësitë e tyre për zhvillim dhe përparim, si dhe të zgjedhin njërin në të cilin do të mund të punonin për ta ndryshuar.



Fletë pune numër 1.3.

Shëno me √ vetëm një përgjigje, për çdo pohim në tabelë.

POHIME	PO	JO
PJESA 1		
Jam intelegjent/e aq sa jam lindur dhe këtë nuk mund ta ndryshoj shumë		
Njerëzit të cilët janë me të vërtetë të zgjuar nuk duhet të bëjnë shumë përpjekje kur duhet të arrijnë diçka.		
Kur një njeri do të hasë në problem, më mirë do të ishte të heqë dorë me kohë sesa të rrezikojë të përballet me dështim.		
Kur nuk arrij sukses brengosem për atë se çfarë do të mendojnë të tjerët për mua.		
PJESA 2		
Detyrat për të cilat nuk jam i/e sigurt se mund t'i bëj janë më interesante, sesa detyrat për të cilat besoj se mund t'i bëj.		
Një herë kur do ta filloj detyrën qëndroj deri sa nuk e përfundoj atë.		
Nëse nuk jam i/e mirë në diçka, do të doja më shumë të përpiqem që ta përvetësoj atë, sesa të vazhdoj me diçka për çka ndoshta jam i/e mirë.		
Kur jam në situatë të vështirë zakonisht mund të gjejë mënyrë që të dalë prej saj.		





Përmbajtja:



Etikë, vlerë
dhe humanitet



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të di të dallojë vlera shoqërore dhe personale dhe të sqarojë se çfarë është etikë dhe humanitet.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ E përshkruan sjelljen në situata të ndjeshme etike (dilema morale).



Materiale të nevojshme:

Fletë pune 1.4. dhe 1.5., letër, stilograf.



Metoda dhe teknika:

Diskutim në grupe, punë në çifte, punë në grupe të vogla.




Pjesa hyrëse e orës

(5 min.)

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të rrëfejnë situata në të cilat nuk kanë qenë të sigurt si të veprojnë. Kanë bërë diçka, e më pas janë penduar. Janë përballur me dilemë të brendshme nëse diçka është e drejtë ose jo. Janë përballë me presion nga moshatarët, etj. Për të hapur shkëmbimin e përvojave, mësimdhënësi mund të prezantojë rrëfimin e tij personal.

Mësimdhënësi bën të ditur se konfliktet e këtilla të brendshme zakonisht i quajmë dilema morale.





Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Arsimtari e fillon orën me prezantimin e shembullit nga fleta e punës 1.4

Pas prezantimit të shembullit, vijon diskutimi i orientuar përmes pyetjeve vijuese:

- ▶ Cila është dilema morale e Bobanit?
- ▶ Përmend të gjithë që Bobani mund t'i lëndojë me mashtrimin në test?
- ▶ A ke parë ndonjëherë ndonjë të moshuar ose shok/shoqe tëndin/tënden të bëjë diçka që t'i konsideron se nuk është në rregull? Çfarë bëre ti? Si u ndjeve atëherë?
- ▶ A mendon se Bobani duhet të tentojë që edhe një herë të bisedojë me babanë e tij lidhur me gënjeshtrenë në kinema?
- ▶ Babai i Bobanit tha se është në rregull të jesh i pandershëm nëse me atë nuk lëndohet askush. Çfarë mendon, kush do të mund të lëndohej nga gënjimi i tij në sportelin e biletave?
- ▶ A ke pasë ndjenjë ndonjëherë se dëshiron të bësh (ose ke bërë) ndonjë punë "të keqe", meqë ke konsideruar se ia vlen të bëhet? A mendon ende se ia ka vlejtur?

Mësimdhënësi ua shpërndanë nxënësve, të ndarë në çifte, fletën e punës 1.5: „Dilema e Adrianit“. Detyra e tyre është që ta lexojnë rrëfimin dhe të përgjigjen në pyetjen e parashtruar në fletën e punës.

Më pas nxënësit ndërlidhen në grupe të vogla të përbëra prej nga dy çifte. Në kuadër të grupeve të vogla së pari kanë për detyrë t'i krahasojnë përgjigjet dhe të përgatiten për prezantimin e punës në grup. Nxënësit (në grupe) i prezantojnë konstatimet e tyre dhe duhet të sqarojnë në çfarë baze janë udhëhequr gjatë marrjes së vendimit, cilët kanë qenë argumentet "për" dhe "kundër", çfarë ka mbisunduar në fund dhe pse.

Mësimdhënësi në tabelë i shënon arsyet që i kanë shtyrë nxënësit dhe fillon diskutim:

- ▶ Cila është dilema morale e Adrianit?
- ▶ Cilat vlera kundërshtohen në këtë situatë?
- ▶ Cilat prej arsyeve të përmendura kanë të bëjnë me interesin personal?
- ▶ Cilat nga arsyet e përmendura kanë të bëjnë me kujdesin për njerëzit tjerë, për mirëqenien e gjithë shoqërisë?
- ▶ A janë disa arsye më të mira se të tjerat? Pse?
- ▶ A është e arsyeshme që qytetarët t'i shkelin ligjet për shkak të "arsyeve të mira"? Pse?

Udhëzime për mësimdhënësit për drejtimin e diskutimit rreth dilemës morale të Adrianit

Shembulli i sipërpërmendur me Adrianin mbështetet në shembullin e mirënjohur për "Dilemën e Hajncit" në të cilën mbështetet *Teoria e zhvillimit moral të Kolbergut*. Përmes hulumtimit longitudinal, duke parashtruar shembullin e njëjtë njerëzve të njëjtë në stadiume të ndryshme të jetës, ka konstatuar se ekziston skemë në mënyrën në të cilën njerëzit i arsyetojnë veprimet e Hajncit, gjegjësisht në këtë rast të Adrianit.

Shembuj të arsyeve (argumenteve) që nxënësit do të mund t'i përmendnin duke (mos)aprovuar një veprim të caktuar të Adrianit, e që kanë të bëjnë me gjashtë stadiume të zhvillimit moral (*sipas teorisë së Kolbergut*):

Stadiumi 1: Dëgjueshmëri

„Adriani nuk duhet ta vjedhë ilaçin, meqë do të përfundojë në burg, që do të thoshte se ai është person i keq.“, ose

„Adriani duhet ta vjedhë ilaçin, meqë i njëjti vlen më pak sesa ajo që i ka kërkuar farmacisti; Adriani madje edhe është ofruar ta paguajë ilaçin dhe nuk vjedhë asgjë tjetër“.

Stadiumi 2: Interes personal

„Adriani duhet ta vjedhë ilaçin, meqë ai do të jetë më i lumtur nëse ia shpëton jetën bashkëshortes së tij, përkundër faktit që do të duhet të vuajë dënimin me burg“, ose

„Adriani nuk duhet ta vjedhë ilaçin meqë burgu është një vend i tmerrshëm dhe me siguri do të qëndrojë gjatë në burg pas vdekjes së bashkëshortes së tij“.

Stadiumi 3: Konformizëm

„Adriani duhet ta vjedhë ilaçin, meqë bashkëshortja e tij e pret ilaçin; ai dëshiron të jetë bashkëshort i mirë“ ose

„Adriani nuk duhet ta vjedhë ilaçin meqë vjedhja është e keqe dhe ai nuk është kriminel. Ai tentoi të bëjë çmos që mundej pa e shkelur ligjin dhe për këtë arsye nuk mund ta akuzojmë“.

Stadiumi 4: Ligji dhe rendi

„Adriani nuk duhet ta vjedhë ilaçin meqë ligji ndalon vjedhjen“ ose

„Adriani duhet ta vjedhë ilaçin për bashkëshorten e tij, por edhe të dënohet për veprën e kryer kriminale dhe t’i paguajë farmacistit aq sa i ka borxh. Kriminelët nuk mund të vrapojnë rreth e rrotull pa u përgjigjur para ligjit. Veprimet kanë pasoja“.

Stadiumi 5: Të drejta të njeriut

„Adriani duhet ta vjedhë ilaçin meqë secili ka të drejtën e jetës, pa marrë parasysh ligjin“ ose

„Adriani nuk duhet ta vjedhë ilaçin meqë shkencëtari ka të drejtën e kompensimit korrekt. Fakti që bashkëshortja e tij është e sëmure, nuk i arsyeton veprimet e tij“.

Stadiumi 6: Parime universale etike


„Adriani duhet ta vjedhë ilaçin meqë shpëtimi i një jete të njeriut është vlerë shumë më e rëndësishme, në raport me të drejtat pronësore të dikujt tjetër“ose

„Adriani nuk duhet ta vjedhë ilaçin, meqë edhe njerëzve të tjerë ndoshta ilaçi u është po aq i domosdoshëm, edhe jetët e tyre janë po aq të rëndësishme“.

Aktiviteti vazhdon me pyetje nga mësimdhënësi:

- ➔ A keni qenë në situatë kur duhet të zgjidhni mes një gjëje që është e drejtë (ligjore) dhe morale (etike)? Përshkruani.
- ➔ Në çfarë jeni mbështetur kur keni vendosur se si të reagoni?

Këto stadiume mund t’i shërbejnë mësimdhënësit që të shqyrtojë nivelin mesatar të përkatësisë së nxënësve nga klasa drejt një stadiumi të caktuar. Ndonëse në zhvillimin moral të të rinjve, është e pashmangshme të gjenden në stadium të ndryshëm, mësimdhënësi duhet t’i nxisë që të mendojnë për argumentet nga stadiumet më të larta morale.



Pjesa përfundimtare e orës

(10 min.)



Pyetje për diskutim dhe reflektim:

- A i kishit sot detyrat e vështira?
- Si ndjeheshit?
- A e kishit vështirë që sinqerisht të flitni gjatë punës në grupe për atë çfarë është e drejtë, e çfarë jo? Pse?

Përfundim

Mësimdhënësi bën rezyme se zgjidhja e dilemave morale i forcon shkathtësitë e nxënësve për të gjykuar, gjegjësisht për të dhënë argumente nëse diçka (ndonjë procedurë) është e drejtë? Me këtë rast, gjatë diskutimit, gjegjësisht argumentimit për atë se çfarë është e drejtë, e çfarë jo, kundërshtohen dy teza, drejtësia nga aspekti i respektimit të rregullave ligjore dhe drejtësia nga aspekti i respektimit të rregullave, normave dhe zakoneve etike.

E drejta dhe etika shpesh janë të harmonizuara, por ndonjëherë edhe dallojnë. E drejta i parashtron rregullat dhe drejtimitet përmes ligjeve dhe rregullave ligjore që, nga ana tjetër, i reflektojnë parimet dhe vlerat që janë të pranura në shoqëri. Për shkak të kësaj, e drejta vazhdimisht sendërtohet, me ligje dhe rregulla të reja, të cilat do të duhej të jenë më të harmonizuara me normat etike. Dilemat morale gjithmonë shkaktojnë mendime dhe qëndrime të ndryshme që bëjnë të ditur në domosdoshmërinë e harmonizimit sa më të afërt të së drejtës dhe etikës, veçanërisht nëse shikohet përmes situatave reale jetësore.



Fletë pune numër 1.4.



Bobani ishte në klasën e nëntë kur ishte kapur duke përshkruar në testin e matematikës.

Ai filloi të tregojë rezultate gjithnjë e më të dobëta nga matematika dhe prindërit e tij iu kërcënuan se nëse nuk i përmirëson notat, nuk do ta lënë të luajë në ekipin e basketbollit. Prandaj ai vendosi të përshkruajë në testin. Kur mësimitdhënësja filloi ta marrë në pyetje, ai në fillim kundërshtonte, por në fund pranoi se i ka pasur të shënuara përgjigjet prej në shtëpi.

Prindërit e Bobanit janë ftuar në mbledhje prindërore dhe Bobani ishte i detyruar të ulet me prindërit e tij, mësimitdhënësen dhe drejtorin që të bisedojnë për rregullat e shkollës që kanë të bëjnë me përshkrimin dhe gënjimimin. Rrugës për në shtëpi, babai i tij i tha se është i dëshpëruar nga ai, se ka pritur shumë më tepër nga ai. Atë natë, Bobani ndjeu sikur e gjithë bota është kundër tij, por ndjeu edhe fajin për shkak se i dëshpëroi prindërit e tij.

Gjatë fundjavës, Bobani dhe familja e tij shkuan në kinema. Kur mbërritën në sportelin e biletave babai i Bobanit kërkoi dy bileta, për Bobanin dhe për djalin e tij gjashtëmbëdhjetë vjeçar. Bobani e shikoi vëllanë e tij, i cili në atë moment shikonte poshtë, ngriti supet e tij dhe shpresoi se shitësja e biletave nuk do të vërejë se është shumë më i moshuar se kufiri për biletë për fëmijë. Shitësja i shikoi me dyshim babanë dhe vëllanë dhe ua dha dy biletat. Kjo ndodhë gjithmonë kur shkojnë në kinema, dhe kjo kontribuon që Bobani të ndjehet çuditshëm.

Pas filmit, rrugës për në shtëpi, Bobani e pyeti babanë e tij pse është në rregull të gënjehet dhe mashtrohet për para në teatër, e nuk është në rregull për testin nga matematika. Babai i tij iu përgjigj se ndonjëherë është në rregull të gënjehet nëse me atë nuk lëndohet askush.

Deri në fund të rrugës, Bobani u bë edhe më i habitur. Mashtrimi në test nuk lëndon askënd. Ai nuk i vodhi përgjigjet nga ndonjë nxënës tjetër. Nëse arsimtarja nuk do ta kapte ai do të mund të gëzohej. Si dallon ajo që e bëri ai me atë që babai i tij e bën vazhdimisht? Dhe a duhet të heshtë edhe herën tjetër kur babai i tij do të gënjejë?



Fletë pune numër 1.5.



Bashkëshortja e Adrianit ishte shumë e sëmurë. Mjekët konsideronin se një ilaç mund ta shpëtojë jetën e saj. Ndonëse ilaçi ka qenë i shtrenjtë për t'u prodhuar, farmacisti të njëjtin e ka shitur për çmim dhjetëfish më të lartë. Fatkeqësisht, familja e Adrianit nuk është mjaftë e fuqishme financiarisht për ta blerë. Adriani ka shkuar te të gjithë për të cilët e ka ditur se do t'i huazojnë para, por ka arritur të grumbullojë vetëm gjysmën e asaj sa ka kushtuar ilaçi. Ai i ka thënë farmacistit se bashkëshortja e tij është shumë e sëmurë dhe ka kërkuar nga ai që t'ia shesë më lirë ose t'ia paguajë më vonë. Por, farmacisti i ka thënë: „Jo, unë e shpika ilaçin dhe planifikoj të përfitoj para prej tij”.

Adriani ka qenë i dëshpëruar dhe ka menduar të hyjë në laboratorin për ta vjedhur ilaçin për bashkëshorten e tij.

ÇFARË MENDONI, ÇFARË DUHET TË BËJË ADRIANI?

A do ta kishit arsyetuar Adrianin nëse hyn me forcë në laborator për të vjedhur ilaçin për bashkëshorten e tij? Nëse po, pse? Për çfarë arsye do të ishit pajtuar me këtë veprim? Nëse jo, pse? Për çfarë arsye konsideroni se nuk duhet të hyjë me forcë në laborator për të vjedhur ilaçin për bashkëshorten e tij?

➔ Adriani do të duhej ta vjedhë ilaçin meqë:

.....
.....

➔ Adriani nuk do të duhej ta vjedhë ilaçin meqë:

.....
.....



Përmbajtja:



Zhvillim
profesional
dhe në
karrierë

Ora e dytë



Qëllimi i orës mësimore:

- ➔ T'i identifikojë përparësitë dhe anët e tij/saj të forta në zhvillim
- ➔ Të shqyrtojnë nevojën e planifikimit të zhvillimit të tyre profesional dhe në karrierë.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Hulumton mundësitë për vazhdim të arsimit dhe ndikimin e tyre në përzgjedhjen e profesionit
- ➔ Demonstron qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit përmes shembujve që dëshmojnë nevojën për të mësuar gjatë gjithë jetës
- ➔ Përcakton qëllime reale të të mësuarit dhe përparim personal.



Materiale të nevojshme:

Letër e bardhë A4 format, stilograf, fletë pune 1.6, 1.7 dhe 1.8.



Metoda, teknika, forma:

Diskutim në grupe, punë individuale (vetëvlerësim).



Ora e parë

Pjesa hyrëse e orës

(10 min.)


Orientimi drejt karrierës paraqet një proces të përgjegjshëm meqë ndikon në zhvillimin e mëtejshëm profesional të secilit nxënës. Kjo temë është e rëndësishme për nxitjen e vetëdijes së nxënësit si qytetar duhet të ndërtojë përgjegjësi ndaj vendimeve personale për karrierë. Kjo do të thotë, se nxënësi do të fillojë të mendojë dhe të informohet për opsionet gjatë marrjes së vendimeve lidhur me karrierën, me këtë rast të kërkojë mbështetje nga familja, shkolla, bashkësia.

Është me rëndësi që nxënësit të dinë se kujdeseni për ta dhe se dëshironi t'u ndihmoni. Në këtë mënyrë do të kenë më shumë vetëbesim që të flasin për mendimet e tyre për atë që duan dhe ku duan të vazhdojnë arsimin e tyre. Në këtë proces, evitoni imponimin e mendimit tuaj, por udhëhiqeni këtë proces që të kenë mbështetje të mjaftueshme në procesin e të menduarit.

Në pjesën hyrëse, arsimtari do të ishte mirë të fillojë bisedën që t'i përfshijë nxënësit në aktivitetet që vijnë në kuadër të orëve të planifikuara për këtë temë. Për shembull, mund të fillohet me pyetjet:

- ▶ **Cilat janë dëshirat dhe ëndrrat tuaj për të ardhmen?**
- ▶ **Me çfarë do të donit të merreni kur do të jenë të rritur?**
- ▶ **Cilët janë anët tuaja të forta?**

Sa më shumë që të dini për interesat personale të nxënësve, aq më shumë do të mund t'i nxitni gjatë orës.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Mësimdhënësi ua jep nxënësve fletën e punës 1.6 *Analiza ime personale* dhe u sqaron se secili duhet të mendojë për veten sipas pyetjeve të parashtruara dhe ta plotësojë atë duke dhënë përgjigje të sinqerta.

Pasi që secili nxënës ta plotësojë fletën e punës, me nxënësin pranë vetes e ndanë atë që e ka shkruar. Më pas mësimdhënësi bisedon me nxënësit për procesin dhe nëse ky ushtrim u ndihmoi që të njohin veten, si mund t'i shfrytëzojnë këto njohuri për veten në planifikimin e tyre për zgjedhjen e arsimit të mëtejshëm.





Fletë pune numër 1.6.

Analiza ime personale

Unë:

Anët e forta

- ➔ Çfarë bëj mirë dhe cilat shkathtësi unike i posedoj?
- ➔ Çfarë di më shumë në raport me të tjerët?
- ➔ Çfarë shikojnë të tjerët te unë si përparësi?

Anët e dobëta

- ➔ Çfarë duhet që të përmirësoj?
- ➔ Në çfarë kam më pak shkathtësi sesa të tjerët? Çfarë konsiderojnë të tjerët se është dobësia ime?

Mundësi

- ➔ Cilat mundësi janë të hapura para meje?
- ➔ Si mund të shfrytëzoj atë që e di dhe në çfarë jam i/e mirë, për t'i arritur qëllimet e mia?

Rreziqe

- ➔ Çfarë mund të më pengojë në rrugën drejt qëllimeve të mia?
- ➔ Në çfarë rreziqesh më ekspozojnë anët e mia të dobëta?






Fletë pune numër 1.5.

Aktivitet **Test për interesa**

Përmes simulimit të ushtrimit interesant secili nxënës e plotëson instrumentin nga fleta e punës 1.7 *Test për interesa*. Nxënësit punojnë individualisht në plotësimin e *Testit për interesa* dhe duhet t'i shënojnë pohimet që kanë të bëjnë me ta.

- ▶ Testi për interesa parashtron pyetje për aspiratat, aktivitetet, shkathtësitë dhe interesat e nxënësve. Testi jep një pasqyrë të llojeve të individëve: realist, hulumtues, artistik, social, sipërmarrës dhe konvencional, si dhe pasqyrë të fushave përkatëse të profesioneve.
- ▶ Testi do t'u ndihmojë nxënësve që në mënyrë argëtuese të zbulojnë informacione për interesat e tyre për arsim të mëtejshëm.
- ▶ Testi do t'u ndihmojë t'i vlerësojnë shkathtësitë, interesat dhe aspiratat e tyre dhe jep listë të profesioneve sipas llojit të individit.
- ▶ Theksojani nxënësve se nuk ka përgjigje të gabuara!
- ▶ Qëllimi i testit është i karakterit informativ, por rezultatet nuk janë vendimtare për vendimet e tyre të mëtejshme.
- ▶ Pasi që do t'i kenë rezultatet nga testi, orientojini drejt aktivitetit të radhës ku rezultatet nga testi do të mund t'i krahasojnë me planet e tyre rrjedhëse për regjistrim në shkollë të mesme.
- ▶ Le ta mbarojnë edhe aktivitetin e radhës duke plotësuar fletën e punës 1.8. para se të kaloni në diskutim për krahasim të rezultateve nga testi dhe aktiviteti i radhës.



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)



Diskutim

- Sa e kishit lehtë/vështirë të vlerësoni vetveten?
- Çfarë për ju ishte më vështirë të vlerësoni? Çfarë për ju ishte më lehtë?
- Çfarë gjëje të re mësuat për veten?
- Si mendoni se këto aktivitete do t'ju ndihmojnë të mendoni për atë që do të donit dhe do të mund të punonit në të ardhmen?

Cila karrierë është përkatëse për ty?

Test për interesa

Ndiq këta hapa të thjeshtë për të parë se cilat janë interesat e tu.

1 Lexoje secilën deklaratë. Nëse je dakord me deklaratën, plotëso rrethin. Nuk ka përgjigje të gabuara!

1.	Dua të punojë në automjete	<input type="radio"/>					
2.	Dua të zgjidhë gjëegjëza	<input type="radio"/>					
3.	Jam i mirë në punë të pavarur	<input type="radio"/>					
4.	Dua të punojë në ekip	<input type="radio"/>					
5.	Jam ambicioz, vetë i parashtrij qëllimet	<input type="radio"/>					
6.	Dua të organizoj (skedare, zyra)	<input type="radio"/>					
7.	Dua të ndërtoj	<input type="radio"/>					
8.	Dua të lexoj për art dhe muzikë	<input type="radio"/>					
9.	Dua të kem udhëzime dhe instruksione të qarta	<input type="radio"/>					
10.	Dua të kem ndikim dhe të bind njerëzit	<input type="radio"/>					
11.	Dua të eksperimentoj	<input type="radio"/>					
12.	Dua të ligjëroj dhe trajnoj	<input type="radio"/>					
13.	Dua t'u ndihmoj njerëzve që t'i zgjidhin problemet	<input type="radio"/>					
14.	Dua të kujdesem për kafshë	<input type="radio"/>					
15.	Nuk më pengon të punoj 8 orë në ditë në zyrë	<input type="radio"/>					
16.	Dua të shes	<input type="radio"/>					
17.	Kënaqem të shkruaj në mënyrë kreative	<input type="radio"/>					
18.	Dua shkencën	<input type="radio"/>					
19.	Shpejt marr përsipër përgjegjësi të reja	<input type="radio"/>					
20.	Jam i interesuar për shërimin e njerëzve	<input type="radio"/>					
21.	Kënaqem të mësoj se si funksionojnë gjërat	<input type="radio"/>					
<i>Gjithsej</i>							
		R	H	A	S	SI	K

22.	Dua të bashkoj dhe formoj gjëra	<input type="radio"/>					
23.	Unë jam person kreativ	<input type="radio"/>					
24.	U kushtoj vëmendje detajeve	<input type="radio"/>					
25.	Dua të mbaj evidencë	<input type="radio"/>					
26.	Dua t'i analizoj gjërat (probleme/situata)	<input type="radio"/>					
27.	Dua të interpretoj ose këndoj	<input type="radio"/>					
28.	Kënaqem të mësoj për kultura të tjera	<input type="radio"/>					
29.	Dua të filloj biznesin tim	<input type="radio"/>					
30.	Dua të gatuj	<input type="radio"/>					
31.	Duhet të aktroj në shfaqje dramaturgjike	<input type="radio"/>					
32.	Unë jam person praktik	<input type="radio"/>					
33.	Dua të punoj me numra dhe tabela	<input type="radio"/>					
34.	Dua të përfshihem në diskutime për tema të caktuara	<input type="radio"/>					
35.	Jam i mirë në evidentimin e punës sime	<input type="radio"/>					
36.	Dua të udhëheq	<input type="radio"/>					
37.	Dua të punoj në vend të hapur	<input type="radio"/>					
38.	Dua të punoj në zyrë	<input type="radio"/>					
39.	Jam i mirë në matematikë	<input type="radio"/>					
40.	Dua t'u ndihmoj njerëzve	<input type="radio"/>					
41.	Dua të vizatoj	<input type="radio"/>					
42.	Dua të mbaj fjalime	<input type="radio"/>					
<i>Gjithsej</i>							
		R	H	A	S	SI	K

2 Mblidhi rrrathët e plotësuar në secilën kolonë, ndërsa për të fituar shumën e përgjithshme mblidh prej dy kolonave të njëjta nga të dy tabelat

3 Sipas shumës së përgjithshme nga dy kolonat, shënoje rezultatin përfundimtar për secilën shkronjë në vendin përkatës më poshtë.

R = realistik
H = hulumtues
A = artistik
S = social
SI = sipërmarrës
K = konvencional

Përmbledhje e përgjithshme

R	H	A	S	SI	K	

4 Shënoi tri shkronjat me numër më të madh të pikëve dhe shënojini nën „Kodi im“

5 Ktheje faqen për ta lexuar rëndësinë!

KODI IM

--	--	--



Cila karrierë është përkatëse për ty?

Rezultate od testi për interesa

R

Realistik

Këta njerëz në të shumtën e rasteve janë të mirë për profesione mekanike ose atletike. Rekomandimet për njerëzit realist janë si vijon:

- Bujqësi
- Punëtor shëndetësor
- Kompjuterë
- Ndërtimtari
- Mekanikë /Makinist
- Inxhinierë
- Ushqim dhe hotelieri

Drejtime të ndërlidhura

Resurse natyrore (ujë, diell, xehe...)
Shërbime shëndetësore
Teknologji industriale dhe inxhinierike
Art dhe komunikime

H

Hulumtues

Këta njerëz duan të mbikëqyrin, të mësojnë, analizojnë dhe zgjidhin probleme. Rekomandimet për hulumtuesit janë si vijon:

- Biologji detare
- Inxhinieri
- Kimi
- Zoologji
- Mjekësi/Kirurgji
- Ekonomi e konsumatorëve
- Psikologji

Drejtime të ndërlidhura

Shërbime shëndetësore
Biznes
Shërbime publike
Teknologji industriale dhe inxhinierike

A

Artistik

Këta njerëz duan të punojnë në mjedis të strukturuar ku do të mund të shprehin kreativitetin e tyre. Rekomandimet për njerëzit artistik janë si vijon:

- Komunikime
- Shërbime kozmetike
- Arte figurative dhe dramaturgjike
- Fotografi
- Radio dhe TV
- Dizajn i brendshëm
- Arkitekturë

Drejtime të ndërlidhura

Shërbime publike
Art dhe komunikime

S

Social

Këta njerëz duan më shumë të punojnë me njerëz të tjerë sesa me gjëra. Rekomandimet për njerëzit social janë si vijon:

- Këshillim
- Kujdes dhe përkujdesje
- Terapi fizikale
- Udhëzime
- Reklamim
- Marrëdhënie me opinionin
- Arsim

Drejtime të ndërlidhura

Shërbime shëndetësore

SI

Sipërmarrës

Këta njerëz duan të punojnë me të tjerët dhe kënaqen gjatë bindjes dhe realizimit. Rekomandimet për njerëzit sipërmarrës janë si vijon:

- Tregti e modës
- Pronë e patundshme
- Marketing/Shitje
- Drejtësi
- Shkenca politike
- Tregti ndërkombëtare
- Veprimtari bankare /Financa

Drejtime të ndërlidhura

Biznes
Shërbime publike
Art dhe komunikime

K

Konvencional

Këta njerëz janë shumë të organizuar, të orientuar drejt detajeve dhe duan të punojnë me të dhëna. Rekomandimet për njerëzit konvencional janë si vijon:

- Kontabilitet
- Raportim gjyqësor
- Sigurim
- Administratë
- Evidencë e ilaçeve
- Veprimtari bankare
- Procedim i të dhënave

Drejtime të ndërlidhura

Shërbime shëndetësore
Biznes
Teknologji industriale dhe inxhinierike




Ora e dytë

Pjesa hyrëse e orës

(10 min.)

Në bazë të aktiviteteve që i kanë bërë në orën paraprake, arsimtari kërkon që secili nxënës të shënojë në një stiker fjalë/fjali që ia kujton kuptimin karrierë. Stikerët i ngjitin në tabelë, ndërsa arsimtari i grupon sipas përmbajtjes dhe bën përmbledhjen e konstatimeve.





Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Secili nxënës merr fletë pune 1.8 dhe mendon individualisht dhe përzgjedhë një lloj të arsimit në të cilin dëshiron të regjistrohet në arsimin e mesëm dhe sqaron pse e ka përzgjedhur atë me një arsytim të shkurtër.

Më pas arsimtari ua tregon linkun e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ku është publikuar konkursi për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme publike dhe u jep detyrë që t'i hulumtojnë mundësitë dhe kriteret e kërkuara për regjistrim në arsimin e mesëm.



Diskutim

- ➔ Çfarë mësuar për mundësitë për regjistrim në shkollë të mesme?
- ➔ A ka në rrethinën tuaj (qytet, komunë) shkollë sipas interesave tuaj?



Fletë pune numër 1.8.


Dua arsimin tim të mëtejshëm ta vazhdojë në:

- Gjimnaz
- Gjeologji, xehetari dhe metalurgji
- Ndërtimtari dhe gjeodezi
- Grafikë
- Ekonomi, drejtësi dhe tregti
- Elektroteknikë
- Shëndetësi dhe mbrojtje sociale
- Bujqësi, peshkatori dhe veterineri
- Shërbime personale
- Makineri
- Komunikacion, transport dhe magazinim
- Tekstil, lëkurë dhe produkte të ngjashme
- Hotelieri dhe turizëm
- Kimi dhe teknologji
- Pylltari dhe përpunim të drurit
- Gjimnaz i sportit
- Tjetër

Mendoj për këtë lloj të arsimit për shkak se dua:

.....

.....



Pjesa përfundimtare e orës

(10 min.)

Pas përfundimit të ushtrimeve, mësuesi sqaron dhe bën ndërlidhjen e procesit të përzgjedhjes së arsimit, me përzgjedhjen e mëtejshme të profesionit.

Njofton nxënësit se të punosh do të thotë të bësh përpjekje për të bërë diçka (ndonjë produkt) ose të japësh shërbime. Për shembull, punë e arkitektit është të vizatojë dhe planifikojë se si do të duket ndonjë ndërtesë (produkt), ndërsa puna e doktorit është të kontrollojë dhe shërojë njerëzit të cilët janë të sëmurë (të ofrojë shërbime). Arkitekti dhe doktori punojnë që njerëzit tjerë të kenë ku të jetojnë dhe të jenë të shëndoshë.

Është shumë e rëndësishme derisa punojmë, vazhdimisht të mundohemi të jemi më të mirë dhe të mësojmë diçka të re. Kjo quhet ndërtim i karrierës.

Për shembull: Denisi dëshiron të ndërtojë karrierë të floktarit të mirë – prandaj ai planifikon të përfundojë shkollën e mesme për floktar, të punësohet rregullisht në sallon, e më vonë ndoshta edhe të hapë edhe sallonin e tij. Për të qenë floktar i mirë duhet ndjekur vazhdimisht trajnime, duhet të blejë revista dhe të ndjekë panairë për të mësuar se cilat modele të flokëve janë moderne dhe cilat produkte përdoren.

Tashmë kemi folur se çfarë është karriera dhe përmendëm shembuj se në çfarë mënyre punohet në ndërtimin e karrierës (shembulli me floktarin). Karriera i përfshin diturinë tuaj, vendet e punës, si dhe atë që e bëni gjatë kohës së lirë (për shembull, a bëni punë vullnetare, lexoni, etj.). Ju vetë zgjidhni se çfarë do të jetë karriera juaj. Ajo që e shikoni, për çfarë mësoni, për çfarë flitet në shtëpi (ose ndoshta e punojnë prindërit tuaj) ndikon në atë që do ta përzgjidhni si karrierë. Planifikimi i karrierës nuk do të thotë vetëm “të bëj punë” ose të studioj “diçka”.

Për përshtatje dhe efektivitet më të madh në mësim, është mirë që mësuesi këto informacione t’i nxjerrë nga nxënësit me qëllim që të nxisë të menduarit e tyre ku mund të kërkojnë informacione.

Që karriera të planifikohet mirë, është me rëndësi:

- Të dimë se çfarë na intereson, në çfarë jemi të mirë, çfarë dhe ku do të donim të punojmë;
- Të pyesim dhe të bisedojmë me njerëzit që dinë (prindër/kujdestarë, mësues, shërbim profesional në shkollë, komunë, biznesmenë të suksesshëm) lidhur me atë se cilat profesione janë më të kërkuara në këtë moment;
- Të parashtrijmë qëllime: çfarë duam të arrijmë dhe si planifikojmë ta arrijmë atë.

Pas përfundimit të aktiviteteve, nxënësit thirren që të tregojnë se sa testit të interesave me të vërtetë i pasqyrojnë dëshirat dhe planet e tyre për regjistrim në shkollë të mesme.



Aktivitet për reflektim

Nxënësit mes vete parashtrijnë pyetje për orientim në karrierë. Secili duhet të përpilojë 1-2 pyetje që mësuesi i mbledhë në kuti/enë. Më pas, secili tërheqë nga një pyetje dhe përgjigjet në të.



Tema

2

BASHKËPUNIM DHE LIDHSHMËRI NË SHOQËRINË QYTETARE

Përmbajtja:



Pranim dhe
respektim të
dallimeve

Ora e parë



Qëllim/e i/të orës mësimore:

- ➔ Të di t'i dallojë dhe sqarojë ngjashmëritë dhe dallimet në raport me përkatësinë etnike, fetare, sociale, gjinore dhe racore
- ➔ Të sqarojë se çfarë është diskriminimi dhe të ndërtojë qëndrim kritik ndaj të njëjtit.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Diskuton respektimin dhe mosrespektimin e dallimeve në bazë etnike, fetare, gjinore, sociale përmes shembujve konkret
- ➔ Analizon shembuj të diskriminimit në kushte të mënyrës bashkëkohore të jetesës.



Metoda, teknika, forma:

Diskutim, aktivitet hulumtues.



Pjesë hyrëse e orës

(10 min.)

Mësimdhënësi për zgjedhë dy vullnetarë të cilët duhet të dalin përpara dhe të qëndrojnë të kthyer me shpinë drejt njëri-tjetrit. Nga nxënësit kërkohet të përmendin nga një dallim që e kanë dy vullnetarët (p.sh. flokë të gjata/shkurtra, xhemper të kuq/bardhë) dhe gjatë çdo dallimi vullnetarët largohen një hap prej njëri-tjetrit. Kur do të mbërrinë deri te skajet e kundërta të klasës, kthehen drejt njëri-tjetrit, ndërsa nga nxënësit kërkohet që të përmendin nga një ngjashmëri që e kanë vullnetarët. Për çdo ngjashmëri të shprehur vullnetarët afrohen për një hap drejt njëri-tjetrit.



Diskutim

- Mendoni për gjërat që janë përmendur si dallime. Sa prej këtyre dallimeve ishin diçka që mund ta vërejmë menjëherë (gjinia, lartësia, ngjyra e flokëve, veshja, etj.)?
- Çfarë është përmendur si ngjashmëri? Përveç ngjashmërive evidente, a mendoni se ka edhe ngjashmëri që nuk janë të dukshme? Cilat janë ato?
- Duke iu referuar edhe materialit nga *Doracaku për nxënës për klasën e VIII*, mësimdhënësi së bashku me grupin duhet ta theksojnë rëndësinë e ekzistimit të dallimeve dhe ngjashmërive mes anëtarëve të një grupi të caktuar, e veçanërisht të ceket rëndësia e pranimit të të gjithë anëtarëve të grupit.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Mësimdhënësi u tregon nxënësve se është marrë vendim nga drejtoria e shkollës që të gjithë nxënësit të cilët mbajnë xhinse, sot gjatë pushimeve, nuk do të guxojnë të dalin jashtë, por do të mbeten në klasë. Mësimdhënësi duhet të lërë pak kohë për të parë se si do të reagojnë nxënësit, e më pas mund të zhvillojë diskutim në raport me pyetjet si vijon:

- Si ndjehen nxënësit që mbajnë xhinse?
- A konsideroni se vendimi i këtillë është i arsyeshëm? Nëse jo, atëherë pse?
- Si ndjehen nxënësit që nuk mbajnë xhinse, kur e shohin se shokëve të tyre u është ndaluar të shkojnë në pushim?
- Kush është i diskriminuar në këtë situatë dhe pse?
- Çfarë do të bëjnë nxënësit të cilët janë të diskriminuar?
- Çfarë mund të bëjnë bashkënxënësit kur shikojnë se shokët e tyre janë të diskriminuar?

Mësimdhënësi i sqaron kuptimet kryesore

DISKRIMINIM. Raporti i pabarabartë dhe jokorrekt ndaj individëve ose grupeve të tëra të njerëzve quhet diskriminim. Ndaj diskriminimit mund të ekspozohen individë ose grupe të njerëzve me atë që trajtohen si më pak të vlefshëm, u shkurtohen të drejtat ose u merren mundësitë vetëm për shkak të përkatësisë ndaj ndonjë grupi. Bazë për diskriminim mund të jetë ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, përkatësia fetare dhe etnike, mosha, etj.

LLOJE TË DISKRIMINIMIT:

- **Diskriminimi i drejtpërdrejt** ndodhë kur një person i caktuar trajtohet në mënyrë më të pavolitshme sesa individët ose grupet tjera, për shkak të përkatësisë së tyre ose karakteristikave personale (p.sh. nëse një person më i rritur refuzohet për ndonjë pozicion të punës, për shkak se punëdhënësi konsideron se për shkak të moshës personi nuk ka njohje të mirë të punës me kompjuterë)
- **Diskriminimi indirekt** ndodhë kur një rregull ose procedurë e caktuar ka të bëjë njëjtë me të gjithë, por efekti nga zbatimi i rregullës ose procedurës është më i pavolitshëm për persona ose grupe të caktuara. (p.sh. Një person i verbër dëshiron

të blejë bileta për koncert. Biletat shiten vetëm përmes internetit, ndërsa faqja e internetit në të cilën mund të blihen biletat nuk është përshtatur që të mund ta përdorin persona të verbër. Personi lajmërohet te kompania që i shet biletat për të blerë biletë, mirëpo i thuhet se biletat mund të blihen vetëm onlajn. Në këtë rast ka procedurë e cila është e njëjtë për të gjithë, mirëpo nuk është marrë parasysh specifika e personave kështu që për shkak të pengesës me shikimin ky person ose do të mbetet pa biletë për koncert ose do të duhet të kërkojë ndihmë nga një person tjetër për t'ia blerë biletën)

Intervenime paqedashëse për luftimin e diskriminimit:

Rezistencë pa dhunë - praktikë e arritjes së qëllimeve të caktuara pa përdorimin e mjeteve të dhunshme. Disa nga praktikat e rezistencës pa dhunë janë: protesta simbolike, padëgjueshmëri qytetare, demonstrata, greva, bllokada

Diskutimi orientohet drejt nxënësve personalisht dhe mësimdhënësi i pyet:

- ➔ A keni qenë ndonjëherë dëshmitar i ndonjë mënyre të diskriminimit ose nga ana tjetër, keni dëgjuar/lexuar diçka që do të dukej si akt diskriminimi?



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Përfundim

- Duhet të jemi të vetëdijshëm se mes njerëzve ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime dhe se dallimet mes njerëzve shpesh paraqesin bazë për diskriminim
- Në situatë kur dikush është i diskriminuar, nuk duhet të "kthejmë kokën në anën tjetër", por duhet të qëndrojmë në mbrojtje të të diskriminuarve.

Përgatitje për hulumtim

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe dhe u jep detyrë që gjatë një jave të bëjnë hulumtim për raste të diskriminimit dhe të identifikojnë si vijon:

- Cila ka qenë baza për diskriminim? Për çfarë dallimi/dallimesh bëhet fjalë?
- Kush ka qenë i diskriminuar (individit ose grupi)?
- Kush e bën diskriminimin?
- Në çfarë mënyre është bërë diskriminimi?
- Kush dhe si ka kundërshtuar diskriminimin?

Nxënësit nxiten që të gjejnë shembuj nga jeta e përditshme dhe rrethimi i tyre. Të mendojnë për përvojat personale me diskriminim, të pyesin anëtarë të familjes, të hulumtojnë ngjarje për të cilat janë informuar mediat, etj. Pasi të hetojnë, nxënësit do të duhet të bëjnë një afishe (në hamer të ngjiten fotografi, të vizatojnë, të shkruajnë, etj.) që do ta prezantojnë në orën e radhës dhe do ta ngjisin në klasë ose ndonjë vend tjetër përkatës në shkollë.

Shënim: që ta kenë më lehtë nxënësit, mësimdhënësi mund t'u cekë edhe raste konkrete të diskriminimit (Gandi, Mandela, Roza Parks, sufrazhetka - gratë që luftuan për të drejtat e tyre, diçka me personat me nevoja, etj.)



Përmbajtja:



Pranim dhe
respektim të
dallimeve

Ora e dytë



Qëllim/e i/ të orës mësimore:

- ➔ Të di të dallojë dhe sqarojë ngjashmëritë dhe dallimet në raport me përkatësinë etnike, fetare, sociale, gjinore dhe racore
- ➔ Të sqarojë se çfarë është diskriminimi dhe të ndërtojë qëndrim kritik ndaj të njëjtit
- ➔ Të iniciojë aktivitete që promovojnë pranimit, respektim të dallimeve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Diskuton respektimin dhe mosrespektimin e dallimeve në bazë etnike, fetare, gjinore, sociale përmes shembujve konkret
- ➔ Analizon shembuj të diskriminimit në kushte të mënyrës bashkëkohore të jetesës
- ➔ Propozon dhe merr pjesë në aktivitete konkrete që promovojnë respektim të dallimeve dhe bashkëpunim.



Metoda, teknika, forma:

Diskutim, aktivitete hulumtues.



Materiale të nevojshme:

Hamerë, flomasterë.




Pjesa hyrëse e orës

(5 min.)

Meqë ora paraqet vazhdimësi të orës paraprake, mësimdhënësi mund të bisedojë disa minuta për procesin nëpër të cilin kanë kaluar nxënësit për të përpunuar aktivitetin hulumtues:

- ➔ A ka qenë interesante për ta?
- ➔ A kanë hasur në ndonjë vështirësi?
- ➔ A mos kanë kërkuar ndoshta ndihmë prej prindërve ose ndoshta kanë diskutuar edhe me ta për rastet që i kanë hulumtuar?






Pjesa kryesore e orës

(30 min.)

Secili grup e prezanton atë që e ka punuar, ndërsa mësimdhënësi i nxitë për diskutim, përmes pyetjeve si vijon:

- Çfarë mësuarat nga shembujt për diskriminim që i hulumtuat?
- Çfarë bazash të diskriminimit ekzistojnë?
- Në cilat mënyra ndonjë person/grup mund të diskriminojë?
- Në cilat mënyra mund t'i kundërvihemi diskriminimit?
Propozoni aktivitete.

(pritet që nxënësit të referojnë për: baza të ndryshme për diskriminim, si diskriminohet, si "zhvillohet luftë" kundër diskriminimit pa përdorimin e metodave dhe mjeteve të dhunshme, etj.).





Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të mendojnë për (mos) diskriminimin në shkollë, përmes pyetjeve:

- ➔ Nëse jeni dëshmitarë i rastit të diskriminimit në shkollë, çfarë konsideroni se duhet të bëni?
- ➔ Çfarë aktivitete mund të bëjë shkolla për të promovuar pranimin e dallimeve dhe respektimin e ndërsjellë dhe çfarë aktivitete për të punuar në parandalimin e rasteve potenciale të diskriminimit?

Përfundim

- ➔ Me diskriminim bëhet shkelje/shkurtim i të drejtave të njeriut që në mënyrë të barabartë u janë garantuar të gjithë njerëzve pa dallim të përkatësisë etnike, gjinisë, ngjyrës së lëkurës, religjionit, etj.
- ➔ Kur ekziston diskriminim duhet të bëhet e ditur se kjo ndodhë dhe të reagohet përmes aktiviteteve dhe intervenimeve paqedashëse.





Përmbajtja:



Qëndrime
dhe
pikëpamje



Qëllim/e i/të orës mësimore:

- ➔ Të sqarojë se njerëzit kanë të drejtën e të menduarit, qëndrimeve dhe pikëpamjeve të tyre
- ➔ Të di të hulumtojë pikëpamje të ndryshme për një situatë.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Prezanton dhe diskuton mendime, qëndrime dhe pikëpamje të mundshme që i shprehin njerëzit për një temë konkrete
- ➔ Respekton pikëpamje të ndryshme që i kanë të tjerët për një temë të caktuar
- ➔ Diskuton shembuj të tolerancës për pikëpamje të ndryshme.



Materiale të nevojshme:

Fotografia 2.1 dhe fotografia 2.2, fletë pune 2.1, tabelë, letër.



Metoda dhe teknika:

Diskutim në grupe, analizë e rasteve, punë në grupe.



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Mësimdhënësi ua tregon nxënësve fotografinë 1 dhe i pyet:

- Çfarë ndjenjash ju shkakton fotografia?
- Kjo është reklamë e vërtetë për kravatat e vitit 1951. Çfarë mendoni, si është pranuar reklama në atë kohë? Çfarë qëndrimesh dhe pikëpamjesh për rolet gjinore ka transmetuar?
- Si do të ishte pranuar nëse do të paraqitej tani? Pse?
- Çfarë reklamash për kravata do të ishin pranuar sot?



Diskutim

Diskutimi që duhet të zhvillohet duhet të ndërlihet me qëndrimet e ndryshueshme për rolet gjinore që sot dallojnë dukshëm në krahasim me vitet e 50-ta të shekullit të kaluar. Atëherë, reklama të këtilla dhe të ngjashme, ku gratë paraqiten në gjendje të nënshtruar ndaj burrave, ku roli i tyre identifikohet me kryerjen e punëve të shtëpisë, etj. do të ishin të zakonshme. **Qëndrimet** e numrit më të madh të qytetarëve kanë qenë se kjo është krejtësisht e pranueshme. Sot, ndonëse ende është e pranishme, paraqitja stereotipe e roleve mes gjinive konsiderohet e papranueshme. Për shkak të kësaj, një numër i madh i kompanive kanë për qëllim të ndërrojnë paraqitjen si stereotip të roleve gjinore dhe, për shembull, të paraqesin reklama në të cilat edhe burrat bëjnë punët e shtëpisë. Si rezultat i kësaj, edhe qëndrimet e qytetarëve gjithnjë e më shumë shkojnë në drejtim të mospranimit të nënshtrimit të një gjinie në raport me ndonjë gjini tjetër. Pra, gjatë viteve të 60-70, qëndrimet në shoqëritë perëndimore në raport me barazinë gjinore kanë ndryshuar në masë të konsiderueshme. Në këtë kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, ndërsa mediat (në mesin e tyre edhe reklammat) janë vetëm një faktor që mund të ndikojë në formimin dhe ndryshimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve.

- ➔ Cilët faktorë të tjerë ndikojnë në formimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve? Në çfarë mënyra?
- ➔ Çfarë ka ndikuar në qëndrimin tuaj për rolet gjinore në familje (kush çfarë duhet të punojë në shtëpi dhe jashtë shtëpisë)?

(përgjigje të pritura: familja, grupi i moshatarëve, arsimi, mediat, vendbanimi, religjioni, (sub) kultura, etj.)



Përkujtim për arsimtarin:

Fotografia 2.1 e cila përdoret për nxitjen e diskutimit duhet të analizohet në mënyrë kritike, nga perspektiva e sotme e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Nga diskutimi që do të zhvillohet në klasë, mësuesi mund të ndjekë se sa nxënës të ndryshëm dinë të formulojnë qëndrim të qartë për temën, ta mbështetin me argumente, të tregojnë respektimin e qëndrimeve të tjerëve, etj.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e diskutimit paraprak dhe konstaton:

Secili prej nesh e vlerëson rrethimin e tij. Formojmë mendime për atë nëse diçka na pëlqen ose jo. Rrallë ndodhë që dikush të ketë qëndrim neutral, për shembull: çokollatë, lloj i caktuar i muzikës, personalitet i njohur. Thjeshtë, qëndrimet janë vlerësim i njerëzve, objekteve ose ideve. Secili ka të drejtën e qëndrimit të tij për gjërat që e rrethojnë dhe të cilat i janë të rëndësishme. Të tjerët duhet të respektojnë qëndrimin e tillë, ndonëse nuk janë dakord me të.

Qëndrimet janë të rëndësishme për shkak se ato shpesh e përcaktojnë atë që e bëjmë – a hamë çokollatë, a jemi të pranishëm në koncerte dhe votojmë për ndonjë individ. Prandaj, shumë kompani mundohen të ndikojnë në qëndrimet tona – që t'i blejmë produktet e tyre. Nga ana tjetër, politikanët tentojnë të ndikojnë në qëndrimet tona për të na bindur që të votojmë për ta. Edhe mediat shpeshherë tentojnë të ndikojnë në disa qëndrime tona përmes prezantimit të ndryshëm të një lajmi të njëjtë.

Për këtë arsye, është shumë me rëndësi që t'i formojmë me kujdes pikëpamjet dhe qëndrimet tona, si dhe t'i rishqyrtojmë nëse hasim në fakte të reja relevante për një temë të caktuar.

Aktivitet Tituj të lajmeve

Nxënësit punojnë në tri grupe. Secili grup merr një set të titujve të lajmeve (nga fleta e punës 2.1) dhe duhet të bisedojnë dhe konstatojnë se cili titull është i mbështetur në fakte (1 prej secilit set të titujve), e të cilat (2 nga secili set i titujve) paraqesin mendim dhe janë tentim për të ndikuar mbi lexuesit. Secili grup ka kohë prej 5 minutave për punë, pas çka duhet të arsyetojnë përzgjedhjen e tyre para gjithë klasës. Mësimdhënësi përcjellë se si do të përgjigjen dhe u parashtron pyetje për arsyetimin e përgjigjeve:

- ➔ Mbi çfarë baze e konstatuat këtë? (p.sh. prezantim i fakteve përballë qëndrimit personal)
- ➔ Çfarë mendimesh dhe ndjenjash shkaktojnë titujt "sensacional" përballë atyre real/faktik?
- ➔ Drejt çfarë qëndrimesh dhe sjelljesh mund të shpijnë?
- ➔ Çfarë stereotipash mund të krijojnë?

(përgjigje të pritura dhe drejtime për diskutim:

Seti 1 i titujve

Titulli i tretë prezanton fakte, pa tentim për të krijuar qëndrim të caktuar te lexuesit. Titulli i parë dhe i dytë i shënojnë vajzat si të papërgjegjshme, jomorale dhe tentojnë të krijojnë qëndrim negativ për ta dhe sjelljen e tyre.

Seti 2 i titujve

Titulli i dytë prezanton fakte, pa ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrimet e lexuesve. Titulli i parë, implikon ekzistimin e situatës ekstreme të keqe, prej të cilës duhet ikur, dhe me këtë krijon mendim te lexuesit se në vend është shumë keq për të jetuar. Titulli i tretë implikon se largohen një lloj i caktuar i njerëzve (më të mirët) gjë që nënkupton se ata që mbeten janë më pak të mirë (gjegjesisht i stigmatizon ata që mbeten).

Seti 3 i titujve

Titulli i parë paraqet transmetim preciz të fakteve, pa tentim për krijimin e mendimit. I dyti është tentim që të krijohet ndjenja e frikës dhe panikut përmes paraqitjes së pasqyrës fataliste për të ardhmen, ndërsa i treti – tentim që të ulet dhe mohohet serioziteti i situatës dhe të krijohet ndjenjë e shkujdesur.

Duhet të konstatohet se ndonëse shpeshherë nuk jemi të vetëdijshëm, në qëndrimet tona mund të ndikojnë informacione të ndryshme qëllimi i të cilave është që të manipulojnë me mendimin e opinionit dhe të krijojnë qëndrim të caktuar për dukuritë/ngjarjet. Sensacionalja në paraqitjen e ngjarjeve të caktuara shpeshherë krijon qëndrime negative ndaj grupeve të caktuara ose dukurive në shoqëri.

Çfarë mund të bëni që të formoni mendim personal për një temë të caktuar dhe të jeni të sigurt në qëndrimet tuaja? Mund ta ndiqni këtë formulë që t'i formoni mendimet personale dhe të keni besim në qëndrimet tuaja:

- 1)** mëso faktet;
- 2)** parashtroni pyetje;
- 3)** kontrolloni atë që do ta dëgjoni dhe lexoni;
- 4)** mendoni për të gjitha informacionet dhe formoni mendime personale.

Aktivitet **Diskutim** **në orë për** **thashetheme** **dhe mendime**

Shumë shpesh, miqtë tanë ndikojnë në atë se çfarë qëndrimi do të formojmë për dukuri të ndryshme. Ata mund të jenë burim i rëndësishëm i informacioneve, por megjithatë duhet të jemi të kujdesshëm kur pranojmë një qëndrim ose pikëpamje të caktuar. Dhe në çfarë situatash duhet të synojmë t'i zbulojmë faktet para se t'i formojmë mendimet dhe idetë tona personale.

Mësimdhënësi fillon diskutimin për thashethemet mes miqve. Mund të udhëhiqet nga pyetjet si vijon:

- Sa shpesh në shoqërinë tuaj dëgjoni thashetheme për disa individë/situata të caktuar/a?
- Sa ndikojnë thashethemet (ajo që do ta dëgjoni nga të tjerët) në qëndrimin tuaj për individ/dukuri të caktuar?
- Sa ju përkujtojnë thashethemet/përgojimet në ekzagjerimin e një lajmi të caktuar nga mediat?
- Si mund të dalloni një "përgojim" nga informacioni real?

Theksoni se kur kuptohen mirë disa gjëra të ndryshme dhe mësohen faktet, ata mund të ndjehen të sigurt në konstatimet e tyre dhe t'u shmangen paragjykimeve ose të veprojnë në mënyrë diskriminuese. Gjithashtu, edhe kur duan të prezantojnë qëndrimin e tyre, duhet t'i përmbahen transmetimit të fakteve dhe dhënies së argumenteve për të njëjtin, pa përdorur: ofendime ndaj grupeve të caktuara, përdorimin e stereotipave për ta, etj.



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)



Aktiviteti: Renditja në formë të diamantit

Kërkoni prej nxënësve, sipas grupeve, të shkruajnë 9 pyetje që i kanë në lidhje me përmbajtjen. Më pas, duhet t'i renditin bashkërisht në formë të diamantit (fotografia 2.2), me ç'rast pyetjet më të rëndësishme janë në majën e diamantit, ndërsa ato më së paku të rëndësishme në fund (të vizatohet në fletën e punës, me këtë rast e njëjta mund të përdoret për reflektim dhe vlerësim).

E njëjta mund të bëhet edhe me renditjen e 9 gjërave që i kanë mësuar/perceptuar gjatë orës.

Pyetje:

1. Si erdhi deri te marrëveshja në grupin tuaj?
2. A është vështirë ose lehtë që të arrihet marrëveshje? Pse?
3. A konsideronin të gjithë se idetë e tyre janë dëgjuar?

Përfundim

Shumë gjëra mund të ndikojnë në qëndrimet dhe pikëpamjet tona, në mënyrë të mirë ose të keqe. Prandaj është me rëndësi që të diskutohet pse është e rëndësishme t'i formojmë qëndrimet tona në bazë të kuptimit dhe grumbullimit paraprak të informacioneve dhe fakteve.

Duhet t'i respektojmë qëndrimet dhe mendimet e njerëzve të tjerë, e nëse duam ta arsyetojmë mendimin tonë, këtë duhet ta bëjmë në mënyrë të argumentuar, përmes prezantimit të fakteve.

Foto 2.1

show her
it's a man's world

Van Heusen[®]
man's world
ties

For men only! ... brand new
man-talking, power-packed patterns that
tell her it's a man's world ... and
make her so happy it is. And man ...



Fletë pune numër 2.1.

Tituj të lajmeve: Fakt ose mendim?

Seti 1 i titujve:

TITULLI 1: Tinejxheret janë "jashtë kontrollit"

TITULLI 2: Vajzat – gjenerata e radhës e pijanecëve!

TITULLI 3: Hulumtim: numri më i madh i vajzave në krahasim me djemtë konsumojnë alkool

Seti 2 i titujve:

TITULLI 1: Të rinjtë ikin nga vendi!

TITULLI 2: Në 10 vitet e fundit, migrimi i të rinjve është rritur për 20%

TITULLI 3: Më të mirët largohen – kush do të mbetet?

Seti 3 i titujve:


TITULLI 1: Gjatë 50 viteve të ardhshme, pritet që temperaturat të rriten për 3 gradë..

TITULLI 2: Për 50 vite, do të zhdukemi.

TITULLI 3: Ngrrohje globale, po çka? Kujt do t'i pengojë nëse në vitin 2070 nuk kemi dimër?

Foto 2.2

Renditje në formë të diamantit







Përmbajtja:



Konflikte dhe
përballje me
konflikte

Ora e parë



Qëllim/e i/të orës mësimore:

- ➔ Të dallojë lloje të konfliktit në shoqëri dhe t'i identifikojë arsyet për paraqitjen e konflikteve.



Materiale të nevojshme:

- ➔ Vizatime për perceptimin e temës konflikt (Fletë pune 2.2)
- ➔ Skenarë për 4 lloje të konfliktit (Fletë pune 2.3).



Metoda, teknika dhe forma:

Analizë e skenarëve paraprakisht të përgatitur me situata të konfliktit, diskutim i strukturuar, pyetje në nivele, sipas Taksonomisë së Blumit, analizë e "fotografive të dyfishta" (iluzione optike).



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Nxënësve u tregohen fotografi në të cilat janë paraqitur “fotografi të dyfishta” (*Fletë pune 2.2 Fotografi të dyfishta*), që secili i shikon, analizon dhe përshkruan varësisht nga perceptimi i tij/i saj. Pasi që secili nxënës do të shprehet se çfarë shikon në vizatim (ajo që shohin do të dallojë, ndaj ndoshta do të formohen edhe “grupe” që do të mbrojnë qëndrimin e tyre për atë që është në fotografi) arsimtari mund të nxisë konfrontim të vogël për ta vendosur konceptin e konfliktit të shkaktuar nga perceptimi i ndryshëm.

Arsimtari e udhëheq procesin ashtu që i udhëzon nxënësit se për një ngjarje, dukuri ose proces mund të ketë mendime, qëndrime dhe pikëpamje të ndryshme.

Perceptim

Si do të sillemi ndaj ndonjë njeriu, objekti, dukurie, ngjarjeje, varet shumë nga ajo se si i perceptojmë. Perceptimi është proces që na mundëson të paramendojmë dhe të përjetojmë atë që truri ynë e pranon si përmbledhje e nxitjeve (për shembull, njeriu). Njëherësh, perceptimi përfshin edhe vlerësimin, duke na mundësuar që për njeriun që e shohim të themi se është i lartë, i ulët, i shëmtuar, i mirë, i keq, etj. Sjellja jonë ndaj tij do të jetë nën ndikimin e madh të asaj se si e kemi perceptuar - nëse e kemi perceptuar si të keq, ndaj tij do të sillemi më ndryshe, sesa nëse e kemi perceptuar si të mirë.

Mbi perceptimin ndikojnë përvoja paraprake dhe pritjet. Nëse me dikë keni pasur përvojë pozitive ose negative, presim që ai të sillet ashtu ndaj jush edhe në të ardhmen. Një nxënës që ka marrë 5 në fillim të vitit shkollor, mund të kënaqet në famën e vjetër. Interesat dhe vlerat ndikojnë dhe shkaktojnë që njerëzit të mos e shikojnë atë që do të duhej ta shikojnë. Për shembull, një qen, dikush e sheh si kërcënim, dikush si kanakar... Te njerëzit ekziston tendenca që të perceptojnë situatën vetëm nga perspektiva personale. Prandaj, njerëz të ndryshëm shikojnë veçori të ndryshme të një objekt i njëjtë dhe njerëz të ndryshëm përshkruajnë një ngjarje të njëjtë në mënyrë të ndryshme.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Punë në grupe

Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secilit grup i jepet nga një situatë konflikti (*Fletë pune 2.3 Skenarë për situata konflikti*). Në fletën e punës janë paraqitur katër situata edhe atë: situata 1 – konflikt intrapersonal; situata 2 – konflikt interpersonal; situata 3 – konflikt intergrupor; situata 4 –konflikt intragrupor.

Në kuadër të grupit, nxënësit duhet ta analizojnë situatën e fituar dhe të përgjigjen në pyetjet vijuese:

- Cila është arsyeja për konfliktin?
- Kush është i përfshirë në situatën e konfliktit, gjegjësisht, mes kujt (individ ose grupe) paraqitet konflikti?

Prezantim

Pasi të përfundojnë aktivitetin, secili grup i prezanton përgjigjet.

Në përputhje me përgjigjet nga grupet që në parim do të duhej të shkojnë në drejtim të identifikimit të saktë të arsyeve për konflikt dhe palëve të përfshira në konflikt, arsimtari jep sqarim të pjesës teorike që ka të bëjë me **arsyet për paraqitjen e konflikteve** dhe sqaron **në cilat nivele mund të paraqiten situata konflikti sipas asaj se kush është i përfshirë në konflikt**.

Ekzistojnë më shumë arsye për paraqitjen e konfliktit, por në të shumtën e rasteve konfliktet krijohen për shkak të:

- Resurseve të kufizuara
- Nevojave të paplotësuara themelore
- Vlerave të ndryshme
- Qëllimeve të ndryshme.

Shumë konflikte paraqesin kombinim të dy ose më shumë niveleve.

Konfliktet, **për shkak të resurseve të kufizuara**, në të shumtën e rasteve krijohen kur dy individë ose dy grupe duan një gjë të njëjtë, por nuk ka mjaftueshëm

për të dyja palët. Në situatë konflikti resurset identifikohen që në vetë fillimin e mosmarrëveshjes dhe zakonisht janë në fokusin e konfliktit. Ndonëse mund të ndodhë që kufizimi i tyre të jetë burim i vërtetë i konfliktit, është shumë më i shpeshtë rasti, në prapavijën e problemit të vërtetë, të qëndrojnë nevoja të paplotësuara psikologjike. Atëherë identifikimi i arsyes për konfliktin bëhet më i vështirë dhe zgjidhja e konfliktit ndërlikohet.

Nevojat themelore të paplotësuara mund të jenë të natyrës së ndryshme – psikologjike dhe fiziologjike (ose biologjike). Sipas psikologut Abraham Maslov, të gjitha nevojat e njerëzve mund të klasifikohen në nivele të sistemuara hierarkike të nevojave individuale ose grupe. Nivelin e parë e përbëjnë nevojat fiziologjike të cilat sigurojnë mbijetesë (ushqim, ujë, ajër, ëndërr, seks). Më pas vijojnë nevojat psikologjike në mesin e të cilave numërohen nevoja e sigurisë, nevoja e përkatësisë dhe nevoja për vetërespekt dhe respekt nga ana e të tjerëve. Lidhur me nevojat psikologjike, grupet nuk dallojnë nga individët – edhe te ata mund të jetë i pranishëm secili nga nivelet e përmendura të nevojave psikologjike. Plotësimi i nevojave psikologjike është me rëndësi për shëndetin psikik të njerëzve, njëjtë siç plotësimi i nevojave fiziologjike është i domosdoshëm për ruajtjen e shëndetit fizik. Nëse dihet se plotësimi i nevojave psikologjike që gjenden në nivelet më të larta në hierarkinë e përbëjnë esencën e zhvillimit të individit, nuk është çudi që nevojat e pakënaqura psikologjike paraqesin burime më të shpeshta të konflikteve. Nevojat e paplotësuara psikologjike janë në bazën edhe të shumë konflikteve që në shikim të parë duken sikur janë shkaktuar prej faktorëve të tjerë.

Vlerat e ndryshme te njerëzit rezultojnë nga dallimet në besim për atë se cilat aktivite, cilat punë dhe cilat ide janë të drejta, të rëndësishme, të dobishme dhe të mira, e cilat nuk janë. Sistemi i vlerave formohet gjatë gjithë jetës përmes ndikimeve më të gjera kulturore, edukimit familjar dhe përvojës personale dhe paraqet standard që udhëheq veprimet e njerëzve. Kur vlerat janë kundërshtuese, palët në konflikt janë të përqendruara në atë nëse kërkesat janë “të rregullta ose të parregullta”, “të mira ose të këqija”. Madje edhe kur konflikti duket se është konflikt rreth qëllimeve të ndryshme drejt të cilave synojnë palët, është më se e sigurt se bëhet fjalë për konflikt për shkak të vlerave të ndryshme – burimi i konflikteve të tilla është i lidhur ose me rëndësinë relative të qëllimeve për

secilën prej palëve kundërshtuese ose me faktin se palët vlerësojnë lartë qëllime të ndryshme. Konfliktet rreth vlerave zgjidhen më vështirë për shkak se përfshijnë gjëra për të cilat njerëzit janë të ndjeshëm – besimet që e formojnë identitetin e individit dhe i japin rëndësi jetës. Kur vlerat janë në konflikt, pjesëmarrësit e përjetojnë konfliktin si sulm ndaj individit, për shkak të cilës arsye individit (dhe/ose grupi) reagon me defansivitet të shprehur dhe përputhje edhe më të madhe të bindjeve, prioriteteve dhe parimeve. Në një situatë të këtillë më vështirë është të braktisen “shabllonët” e vjetër të sjelljes dhe të përzgjidhet mënyrë më e ndryshme e reagimit.

Nevojat psikologjike përzihen edhe në konfliktet rreth vlerave. Sistemet rigide të vlerave mund të jenë faktor serioz kufizues në plotësimin e nevojave themelore psikologjike, veçanërisht nevoja e përkatësisë. Sa më shumë që individit qëndron pranë ndonjë vlere, aq më shumë mundësitë e tij për përkatësi janë barazuar vetëm në ato të cilat janë të pranishme bindjet, prioritetet dhe parimet e njëjta. Vlerat që nuk janë fleksibile thuajse gjithmonë pengojnë edhe kur bëhet fjalë për pavarësi që plotësohet përmes mundësisë për zgjedhje personale. Njerëzit që kanë vlera më të ndryshme shihen sikur nuk janë në të drejtë, ndërsa situatat që devijojnë nga standardet e pritura konsiderohen të këqija. Në rast të tillë, përzgjedhjet që bëhen në jetë (po madje edhe përzgjedhja e miqve) kufizohen në një rreth të ngushtuar të mundësive.

Konfliktet për shkak të **qëllimeve të ndryshme** krijohen kur palët në konflikt kanë ide të ndryshme për atë se si të plotësojnë një nevojë të caktuar.

Varësisht nga palët e përfshira në konflikt, konfliktet në përgjithësi ndahen në:

- ➔ Konflikte që ndodhin mes individëve (konflikte interpersonale) – p.sh. bashkëshorte – bashkëshort, prind - fëmijë, kolegë - kolege
- ➔ Konflikte që paraqiten në vetë individin, si interesa kundërshtues (konflikte intrapersonale) – p.sh. a të shkohet në seminar gjatë fundjavës ose të qëndrohet me familjen, në cilën shkollë të regjistrohesh – atje ku dua ose ku më shkojnë shokët

- Konflikte që paraqiten si rezultat i interesave kundërshtuese mes grupeve me madhësi dhe natyre të ndryshme (intergrupore)– p.sh. klasë-klasë, grupe të ndryshme etnike
- Bëhet fjalë për konflikte që paraqiten mes pjesëtarëve të një grupi (intragrupore) – p.sh. konflikte mes anëtarëve të ekipit sportiv, kolektiv i punës, klasë.



Diskutim

Në kuadër të diskutimit nxënësit nxiten që të përkujtohen në ndonjë situatë konflikti në të cilën kanë qenë të përfshirë edhe vetë ose kanë qenë dëshmitarë, e për të cilën nuk do ta kishin problem të flasin. Me këtë rast, diskutimi udhëhiqet sipas pyetjeve të përmendura më poshtë që të bëhet introspektion i përjetimit personal të konfliktit, si dhe të kuptuarit e tij në raport me përpunimin e konfliktit të paraqitur në aktivitetin kryesor.

- Cila ka qenë arsyeja dhe mes kujt ka qenë konflikti?
- Si janë ndier?
- A keni pikëpamje më të ndryshme të situatës konfliktuoze tani, pasi që përvetësuat dituri për ndikimin e perceptimeve të ndryshme në krijimin e situatave konfliktuoze?



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Përfundim

- ▶ Pikëpamja, mirëkuptimi, të kuptuarit e ndryshëm të gjërave (perceptimi) mund të rezultojë me mosmarrëveshje të ndërsjellë dhe të krijojë konflikt potencial
- ▶ Arsye më të shpeshta për paraqitjen e konfliktit janë: nevojat, qëndrimet, vlerat, qëllimet e ndryshme
- ▶ Varësisht nga palët e përfshira në konfliktin, konfliktet në përgjithësi ndahen në intrapersonale, interpersonale, konflikte intra grupore dhe intergrupore.




Aktivitet për reflektim

Për reflektim të arritjes së qëllimeve përdoret aktiviteti pyetje-përgjigje. Nxënësit përpilojnë pyetje që kanë të bëjë me përmbajtjen mësimore.

I shkruajnë në fletë e më pas arsimtari i mbledhë fletët në një enë/kapele. Nxënësit tërheqin pyetje dhe tentojnë t'u përgjigjen me ndihmën e arsimtarit.



Fletë pune 2.2
Fotografi të dyfishta









Fletë pune 2.3

Skenarë për situata konflikti

Situata 1:

Jovana dhe Arta janë shoqe që nga klasa e parë. Tani janë në klasën e nëntë dhe duhet të kenë test nga fizika. Nota nga testi do të ndikojë në notën finale në fund të vitit shkollor. Arta e di se fizika nuk i shkon aq mirë dhe se nëse merr notë më të ulët kjo do t'i ndikojë në sukses dhe ndoshta nuk do të mund të regjistrohet në shkollën e mesme në të cilën dëshiron të shkojë. Ajo mësoi se Jovana i ka gjetur pyetjet e testit, ndërsa Jovana madje i ofroi Artës që t'ia japë. Arta e di se ajo që e bën Jovana nuk është në rregull, por gjithashtu e di se duhet doemos të marrë pesë në testin që të ketë sukses në fund të vitit që do t'i garantojë regjistrim në shkollën që e do.

Situata 2:

Kireja dhe Erhani ishin në terren basketbolli dhe gjuanin kosha në anët e kundërta të terrenit për lojë. Ishin të kthyer me shpinë dhe as që vërejtën se janë afruar pranë njëri-tjetrit. Erhani i qëllonte të gjithë koshat, derisa Kireja tërë kohën gjuante huq. Në një moment Erhani, pa dashur e shtyu me shpinë Kiren, i cili i nevrkosur nga seria e gjuajtjeve huq, ndërsa edhe pak i turpëruar nga shokët të cilët e shikonin si publik, u kthye dhe i bërtiti Erhanit. Erhani nuk e kishte të qartë pse i bërtet Kireja dhe në mënyrë instinktive edhe ai filloi t'i bërtasë Kires.

Situata 3:

Djemtë dhe vajzat duan ta shfrytëzojnë terrenin e vetëm për lojë në mëhallë. Djemtë ishin marrë vesh të luajnë futboll, ndërsa vajzat volejboll. Filluan të zihen rreth asaj se kush ta shfrytëzojë terrenin. Djemtë thoshin se terreni është për futboll dhe se nuk është e thënë që vajzat të luajnë volejboll meqë edhe ashtu ai është "sport i mërzitshëm". Vajzat ndjeheshin të ofenduar dhe u kundërpërgjigjën se futblli është "sport i krisur" dhe se djemtë vazhdimisht e përdorin terrenin, ndaj rendin e kanë tani vajzat ta shfrytëzojnë. Askush nuk lëshonte pe. Situata rezultoi me zënka të mëdha mes dy grupeve të fëmijëve.

Situata 4:

Pesë miq kanë themeluar bandë muzikore dhe zakonisht interpretojnë përpunime të grupeve tjera. Megjithatë, kohë më parë vendosën që të bëjnë këngë me tekst dhe muzikë personale. Një ditë këngëtari erdhi me tekst për muzikë që kitaristi dhe bateristi e kishin bërë. Teksti nuk i pëlqeu kitaristit meqë konsideronte se përmban fjalë vulgare dhe se kjo nuk do të ishte mirë për imazhin e grupit. Bateristit i pëlqeu teksti meqë konsideronte se në këtë mënyrë grupi do të duket "kull". Edhe dy anëtarët tjerë të bendit kishin mendime të ndara rreth tekstit të këngës.





Përmbajtja:



Konflikte dhe
përballje me
konflikte

Ora e dytë



Qëllimi/e i/të orës mësimore:

- ➔ Të sqarojë zgjidhje konstruktive të konflikteve
- ➔ Konfliktet dhe kontestet t'i zgjidhë në mënyrë konstruktive.



Materiale të nevojshme:

Laps, letër, fletë pune 2.4, format për analizë të situatës (Fletë pune 2.5).



Metoda, teknika dhe forma:

Punë në çifte, teknika *Një laps* – dy vizatues, diskutim, analizë të situatës.



Aktivitet hyrës

(15 min.)

Një laps – dy vizatues

Nxënësit punojnë në çifte, ashtu që secili çift ka për detyrë me një laps, në fletë të vizatojë pikturë të përbashkët, pa marrëveshje dhe marrëveshje të ndërsjellë. Koha për punë – një minutë. Pas përfundimit të pjesës së parë të detyrës, secili nxënës në anën tjetër të fletës vizaton vizatimin e tij sërish me një laps, pa marrëveshje dhe në qetësi të plotë. Në fund lutini nxënësit që t’ua tregojnë dy pikturat.

Pas përfundimit të aktivitetit nxënësve u parashtrihen këto pyetje:

- Si ndjeheshit derisa vizatonit?
- A ka ardhur deri te ndonjë përplasje/konflikt?
- A kanë arritur të merren vesh disi përkundër asaj se nuk kanë guxuar të bisedojnë mes vete? A do të ishte më lehtë nëse do të mund të komunikonin verbalisht? Pse?
- A është imponuar ndonjëri anëtarë i çiftit që ta vizatojë idenë e tij/saj ose ka hequr dorë nga vizatimi i idesë së tij? Pse? *(përgjigjet në këto pyetje arsimtari do të duhet t’i mbajë mend meqë do të shërbejnë si hyrje në orën e radhës kur do të punohen stilet personale në përballje/zgjidhje të konflikteve)*

Aktiviteti është argëtues, por njëherësh edhe shumë serioz dhe hapë mundësi për bisedë për atë se kush si ia del dhe sillet në situatë me konflikt dhe stres, kur duhet doemos të bashkëpunojë me të tjerët. Nxënësit mund t’i analizojnë veprimet personale derisa kanë vizatuar dhe të përkufizojnë se në çfarë mënyre janë sjellur në situata konfliktoze.

Përmes këtij ushtrimit duhet të përfshihen elementet/koncepte që janë veçanërisht të rëndësishme në procesin e të kuptuarit dhe analizimit të konfliktit, e këto janë: identifikimi i ndjenjave dhe sjelljes në situatë konflikti, stile personale të zgjidhjes së konfliktit dhe rëndësia e komunikimit efektiv si bazë për zgjidhje konstruktive të konflikteve.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Bazuar në ushtrimin paraprak, arsimtari ofron sqarime të detajuara të koncepteve vijuese:

- ➔ Ndjenja, sjellje dhe relacione në situata të konfliktit
- ➔ Komunikim efektiv si bazë për zgjidhje konstruktive të konflikteve.

Në të shumtën e rasteve gjëja e parë që e vërejmë në situatë të konfliktit është **sjellja** (bërtitje, rrahje, përplasje të derës, tërheqje, etj.). Prapa çdo sjelljeje ekziston **ndjenjë** që e shkakton sjelljen e tillë (hidhërim, frustrim, pafuqi, etj.). Ndjenja është shkaktuar nga një **problem** i caktuar, ndërsa problemi në të shumtën e rasteve krijohet mes personave që kanë ndonjë **relacion/raport**. Këto katër elemente, sjellje, ndjenjë, problem dhe relacion/raport, janë elemente themelore të konfliktit dhe kur synojmë drejt zgjidhjes konstruktive të konflikteve duhet t'i kemi parasysh të gjitha.

Komunikimi efektiv është bazë për përballjen dhe zgjidhjen konstruktive të konflikteve. Kur zgjidhja e konflikteve shqyrtohet nga perspektiva e komunikimit, konfliktet në fakt shikohen si pjesë normale e raporteve ndërmjet njerëzve. Me zbatimin e komunikimit efektiv synohet të gjendet zgjidhje që do t'i kënaqë të gjitha palët e përfshira në konfliktin.

Komunikimi mes palëve të konfrontuara nënkupton pjesëmarrje në mirëkuptimin e ndërsjellë – komunikimi ekziston kur secila palë në konflikt synon që së pari ta kuptojë tjetrën, e më pas edhe vetë të jetë e kuptuar. Që të realizohet komunikimi efektiv, është e domosdoshme që palët të kenë zhvilluar disa teknika/shkathtësi që mundësojnë të komunikohet në drejtim konstruktiv, edhe atë:

- ➔ Teknika e **dëgjimit aktiv**
- ➔ Teknika e **UNË fjalimit**

Dëgjimi aktiv nënkupton dëgjim me qëllim që të kuptojmë personin që flet. Njerëzit që dëgjojnë në mënyrë aktive mund të hyjnë në lëkurën e të tjerëve dhe ta shikojnë problemin nga perspektiva e tyre dhe t'i kuptojnë ndjenja e tyre. Kjo nuk do të thotë se duhet doemos edhe të pajtohen me të tjerët, por vetëm se duhet t'i kuptojnë nga pikëpamja intelektuale dhe emocionale. Dëgjimi aktiv krijon mundësi të secili pjesëmarrës në konflikt që të kënaqen shumica e nevojave bazike psikologjike. Në një situatë të tillë, palët në konflikt bëhen të vetëdijshme se vetë janë përgjegjëse për gjetjen e zgjidhjes dhe synojnë që me të gjitha forcat ta bëjnë atë. Prandaj edhe konfliktet të cilave u qasen në këtë mënyrë bëhen konstruktive. Elemente themelore të dëgjimit aktiv janë:

- ▶ **Parafrazimi** – përmbledhje e shkurtër e detajeve të asaj që bashkëbiseduesi na e tregon. Në këtë mënyrë do të mësoni se çfarë ka paraqitur biseda, ndërsa oratori do të mund të ju sqarojë diçka nëse nuk e keni kuptuar tërësisht.
- ▶ **Parashtrim i pyetjeve** – në këtë mënyrë tregoni interes për atë që ua thotë bashkëbiseduesi ose kërkoni sqarim. Me parashtrimin e pyetjeve oratori do të dijë se jeni i vëmendshëm dhe dëgjoni dhe se jeni të interesuar për temën. Gjatë parashtrimit të pyetjeve, duhet të kushtohet kujdes që të mos teprohet dhe personi që e dëgjoni të mos fitojë përshtypje se jeni duke e marrë në pyetje.
- ▶ **Empati** – të tregojmë aftësi për mirëkuptim dhe t'i kuptojmë emocionet, vuajtjet dhe ndjenjat e huaja.

UNË fjalimi është teknikë e komunikimit që do të mundësojë shprehje të nevojave dhe dëshirave, është konstruktiv dhe i fokusuar në një problem specifik. UNË fjalimi flet qartë për sjelljen dhe ndjenjat e shkaktuara në situata të konfliktit dhe nuk hyn në kualifikimin, vlerësimin ose gjykimin e personalitetit/personit. UNË fjalimi nuk shpie drejt evitimit të konfliktit, por drejt hapjes së komunikimit rreth arsyeve të konfliktit. Përmes fjalimit të këtillë ne bëjmë të ditur se jemi të hapur për komunikim dhe jemi të gatshëm për bisedë dhe kërkimin e zgjidhjes së ndërsjellë të pranueshme të problemit. Me UNË fjalimin fokusohemi në vetveten dhe nevojat, dëshirat dhe të drejtat tona.

Shpeshherë në situata konflikti akuzohemi mes vete, shprehim hidhërim, ofendojmë, rrudhim vetullat dhe e gjithë kjo mund të shpie drejt eskalimit të konfliktit dhe largimit nga arsyeja e vërtetë e konfliktit dhe çfarë është ajo që neve na ka ofenduar në situatë të tillë, cila është nevoja jonë ose çfarë duam në të vërtetë. Përmes UNË fjalimit ne kthehemi në fillim të konfliktit drejt asaj që për ne është e rëndësishme ose asaj që neve na pengon dhe nuk shkaktojmë reagim mbrojtës në anën tjetër. Përmes përdorimit të UNË fjalimit në situatë konflikti pikësynohet sjellja e personit/individit me të cilin jemi në konflikt.

Struktura e UNË fjalimit:

Kur shikoj se /kur më thua.....unë ndjej /dëshiroj.....do të doja



Kur më thua të hesht, ndjehem i ofenduar dhe sikur fare nuk brengosesh për mua dhe mendimin tim. Do të doja të mund të bisedojmë dhe të më thuash se çfarë të pengon në fakt.



Diskutim

Gjithashtu edhe në orën paraprake, nxënësit nxiten që të kujtojnë konfliktin në të cilin vetë kanë qenë pjesëmarrës ose nga ana tjetër kanë qenë dëshmitarë. Me këtë rast do të duhet të nisesh diskutim rreth dy pyetjeve të përmendura më poshtë, me ç'rast arsimtari paralelisht me diskutimin do të prezantojë/plotësojë akullnajën që i paraqet elementet e dukshme dhe të fshehura të konfliktit:

- ➔ Çfarë është ajo që është e dukshme ose mund të vërehet qartë në një situatë konflikti? *(në këtë pyetje nxënësit do të duhej të përgjigjen lehtë dhe do të duhej t'i referohen sjelljes dhe komunikimit verbal dhe joverbal – bërtitje, përplasje të derës, goditje të tavolinës, kërcënime, shprehje e fytyrës, emocione, etj.)*
- ➔ Çfarë është ajo që është e padukshme në një situatë konflikti? *(kjo pyetje mund të jetë më e vështirë për nxënësit dhe nëse është kështu arsimtari do të duhet t'i nxisë me shembuj – këtu duhet t'u referohet stereotipave dhe paragjytimeve, vlerave personale, frikës, xhelozisë, fuqisë/pafuqisë, nevojave, interesave, etj.)*

Koncepti i “Akullnajës” – Pse është konflikti si akullnajë? **(Fletë pune 2.4 Akullnajë)**

Akullnaja shumë shpesh përdoret si analogji për konfliktin, meqë i tregon elementet e konfliktit të cilat janë të dukshme dhe perceptuese (këto elemente e paraqesin pjesën e akullnajës që është mbi sipërfaqen e ujit), por i tregojnë edhe elementet e padukshme të konfliktit që nuk i vërehet ose për të cilat nuk jemi të vetëdijshëm (këto elemente e paraqesin atë pjesë të akullnajës që është nën ujë, që nuk e shikojmë, e që është shumë më e madhe sesa pjesa e dukshme e akullnajës).

Zakonisht, kur jemi në situatë konfliktit, ajo që është e dukshme dhe lehtë e perceptueshme janë: sjellja, qëndrimet, komunikimi joverbal (grimasa e fytyrës, kërcënime me dorë, gisht), dhunë, emocione, kërcënime, shantazhe, etj.

Ajo që nuk e vërejmë në konfliktin dhe për të cilin nuk jemi të vetëdijshëm janë: arsyet e vërteta për konfliktin, vlerat personale, prapavija kulturore e personave të përfshirë në konflikt dhe përvojat e tyre paraprake jetësore, paragjykimet, pritjet, nevojat, etj.



Dy fqinj zihen rreth asaj se i kujt është druri. Secili prej tyre thotë se druri është në tokën e tij dhe qëndrojnë në qëndrimin se druri duhet t'i takojë njërit prej tyre. Prerja e drurit përgjysmë nuk është opsion meqë në këtë mënyrë do të kalbet dhe asnjëri prej tyre nuk do ta ketë. Përkundër faktit që qëndrimi i të dyve është se druri i takon vetëm njërit prej tyre, në fund u tregua se të dy kanë interesa të ndryshëm meqë e duan drurin – njëri e dëshiron për shkak të hijes në të cilën dëshiron të pushojë, derisa tjetri e dëshiron për shkak të frutave. Ajo që në shikim të parë shihet është se që të dy kanë qëndrime të papajtueshme (që janë në pjesën e dukshme të akullnajës) në raport me atë se i kujt është druri, mirëpo nëse analizohen interesat (që janë në pjesën e padukshme të akullnajës) arrihet deri te pozicioni në të cilin mund të kërkohet zgjidhje që do të kënaqte interesat e të dyja palëve.

Komunikimi efektiv dhe përdorimi i teknikave për komunikim efektiv janë bazë për “shprehjen” e elementeve të fshehura të konfliktit në pjesën e dukshme të akullnajës.



Pjesa përfundimtare e orës

- ▶ Të bëhet i ditur koncepti i komunikimit efektiv si bazë e zgjidhjes (jo) konstruktive të konflikteve dhe të sqarohen teknikat e dëgjimit efektiv dhe *Unë fjalimit* që nxënësit duhet t'i zbatojnë në situata të konfliktit, meqë në këtë mënyrë krijohen kushte për kuptimin e nevojave personale, por edhe nevojat e të gjitha palëve të përfshira në konflikt, si dhe respektim i ndërsjellë.
- ▶ Përmes vendosjes së akullnajës, nxënësit duhet të kuptojnë se gjithmonë kur janë në situatë të konfliktit duhet të jenë veçanërisht të vetëdijshëm për elementet e fshehuara të konfliktit që në të shumtën e rasteve ndikojnë në ndjenjat dhe sjelljet që palët në konflikt i tregojnë.



Aktivitet për reflektim

Fletë për analizimin e situatës konkrete të konfliktit – për shtëpi (Fletë pune 2.5. Analizë e konfliktit)

Me këtë fletë të reflektimit nxënësit duhet t'i zbatojnë dituritë që i kanë për analizë të situatës së konfliktit. Me këtë rast, secili nxënës (në mënyrë individuale, shtëpi) duhet të bëjë analizë të ndonjë situatë të konfliktit (në të cilën ka marrë pjesë ose në të cilën ka qenë dëshmitar) dhe t'i përfshijë të gjitha elementet që janë punuar në këtë dhe orën paraprake. Ndonëse mund të duket si përsëritje meqë në të dyja orët referohej për reflektimin e konfliktit personal, këtui marrim parasysh stilet e ndryshme të nxënies dhe u jepet mundësi edhe atyre nxënësve të cilëve u nevojitet më shumë kohë për të menduar, observuar dhe reflektuar që të mund ta bëjnë analizën në tërësi.



Fletë pune 2.4


Akullnajë

ELEMENTE TË
DUKSHME
TË KONFLIKTIT

ELEMENTE TË
FSHEHURA TË
KONFLIKTIT




Fletë pune 2.5. Analizë e konfliktit



ANALIZË E KONFLIKTIT

Arsyeja e konfliktit	
Lloji i konfliktit sipas palëve të përfshira	
Sjellje e palëve të përfshira në konflikt	
Ndjenjat që janë paraqitur te palët e përfshira në konflikt	
Mënyra e komunikimit – a janë zbatuar teknikat e komunikimit efektiv; nëse nuk janë zbatuar atëherë si kanë komunikuar palët në konflikt?	
Nga aspekti i analizës së konfliktit përmes konceptit të <i>Akullnajës</i> , a mund të supozoni elemente që kanë qenë të fshehura?	





Përmbajtja:



Konflikte dhe
përballje me
konflikte

Ora e tretë



Qëllim/e i/të orës mësimore:

- ➔ Të sqarojë zgjidhje konstruktive të konflikteve
- ➔ Konfliktet dhe mosmarrveshjet t'i zgjidhë në mënyrë konstruktive.



Materialë të nevojshme:

Fletë pune 2.6 me 5 stile/qasje të sqaruara personale për përballje dhe zgjidhje të situatave të konfliktit, fletë pune 2.7., tabela, letër.



Metoda, teknika dhe forma:

Lojë rolesh, diskutim, pyetësor për vetëvlerësim.



Aktivitet hyrës

(5 min.)

Arsimtari i kthehet ushtrimit **Një laps – dy vizatime** nga ora paraprake. Përmes pyetjes „A është imponuar ndonjëri anëtarë i çiftit që ta vizatojë idenë e tij ose ka hequr dorë nga vizatimi i idesë së tij?“, tenton që prej nxënësve të marrë informacion nëse dikush është imponuar të vizatojë, nëse ndonjëri është tërhequr, etj. Nëse këto përgjigje janë marrë në orën paraprake, atëherë arsimtari mund t’u referohet përgjigjeve dhe në këtë mënyrë të bëjë hyrje në pesë stilet/qasjet personale të përballjes me situatë konflikti. Arsimtari vetëm i emëron stilet dhe i njofton nxënësit se do të ndahen në tre grupe, ku secili grup do të marrë fletë me përshkrim të stileve/qasjeve personale të përballjes me situatën e konfliktit (**Fletë pune 2.6. Stile personale të përballjes/zgjidhjes së konflikteve**). Mund të përdoren shembujt e **Fletës së punë 2.3. Skenarë për situata konflikti** ndonëse rekomandohet që nxënësit vetëm të përpilojnë situatën e konfliktit. Në bazë të përshkrimeve të marra, secili grup do të duhet të përgatisë lojë të roleve në të cilat do t’i stimulojë stilet që i kanë marrë. Kohëzgjatja e një loje të roleve të mos jetë më e gjatë se 5 minuta.



Pjesa kryesore e orës

(30 min.)

Përgatitje e lojës së roleve

Grupi i parë do t'i marrë stilet – **garë, përshtatje dhe evitim**. Që të tri stilet do të duhet t'i simulojnë në një situatë konflikti. Këto tri stile janë të kombinuara në një lojë rolesh meqë është më lehtë të përfshihen në një situatë. Gjithashtu, për shkak të kufizimit në kohëzgjatjen e orës së shkollës nuk është e mundur në aspektin kohor që secili stil të paraqitet në lojë të posaçme rolesh.

Grupi i dytë merr stilin **kompromis**.

Grupi tretë merr stilin **bashkëpunim**.

Te stilet kompromis dhe bashkëpunim nxënësit nxiten që t'i përdorin teknikat e dëgjimit aktiv dhe *UNE fjalim* që i kanë punuar në orën paraprake.

Prezantim i lojës së roleve

Secili grup ka 5 minuta për të realizuar lojën e roleve dhe rreth 2 minuta për të sqaruar se cili stil është prezantuar dhe ta përshkruajë në përputhje me informacionet në fletë.

Stile/qasje në përballje/zgjidhje të konflikteve:

- 1) Garë** – ky stil nënkupton se personi i përfshirë në konfliktin synon me çdo çmim të imponojë mendimin ose zgjidhjen e tij të problemit. Këta persona dinë të jenë dukshëm me ndikim. Shpesh dinë t'i sulmojnë ata që nuk pajtohen me ta, po madje edhe të jenë të vrazhdë dhe agresiv;
- 2) Përshtatje** – ky stil nënkupton se personi i përfshirë në konfliktin ka prirje miqësore dhe synon t'u përshtatet të gjitha palëve të tjera të përfshira në konflikt. Këta persona nuk u japin rëndësi të mjaftueshme nevojave të tyre,

gjë që me kalimin e kohës mund të kalojë në pakënaqësi nga vetvetja. Nga ana tjetër, ndonjëherë problemi nuk u është aq i rëndësishëm ndaj për këtë arsye nuk insistojnë në propozime të tyre për zgjidhjen e konfliktit;

3) Evitim – ky stil nënkupton se personi i përfshirë në konflikt me çdo çmim synon t’u përshtatet të gjithëve. E gjithë situata e konfliktit u është e pakëndshme dhe nuk duan të përballen me konfliktin. Këta persona shtiren se problemi nuk ekziston ose nga ana tjetër se nuk është serioz;

4) Kompromis – kur situata nuk është aq e rëndësishme, por problemi duhet të zgjidhet atëherë mundohemi të “bëjmë pazar” me palët që janë të përfshira në konfliktin. Me këtë rast, secili heq dorë nga pak nga diçka dhe në fund vjen deri te zgjidhja e kompromisit në të cilën secili do të humbë diçka mirëpo do të arrihet deri te zgjidhja e përgjysmuar me të cilën të gjitha palët janë pjesërisht të kënaqura;

5) Bashkëpunim – kur zbatohet stili i bashkëpunimit, secila prej palëve është e rëndësishme dhe secili aktivitet kontribuon në gjetjen e zgjidhjes së përbashkët. Zgjidhja nuk është e thënë të jetë e përsosur, por duhet të jetë mjaftë e mirë dhe e pranueshme për të gjithë. Zakonisht, procesi i gjetjes së zgjidhjes rrjedhë më gjatë dhe kërkon komunikim aktiv nga të gjitha palët e përfshira. Synohet që të gjendet zgjidhje cilësore me të cilën të gjithë janë të kënaqur dhe ndjehen si fitues përkundër faktit që ndoshta kanë hequr dorë nga diçka. Në procesin e bashkëpunimit është veçanërisht e rëndësishme që secili mendim i secilës palë në konflikt respektohet dhe mbahet llogari edhe për interesat personal, por edhe për interesat e të gjitha palëve.



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Diskutimi udhëhiqet sipas pyetjeve të përmendura më poshtë në drejtim të identifikimit të mënyrave konstruktive të përballjes dhe zgjidhjes së konflikteve:

- ➔ Cili prej stileve të prezantuara shpie drejt zgjidhjes së konflikteve? Pse?

Përfundim

Theksi duhet të vihet në stilet bashkëpunim dhe kompromis si mënyra konstruktive për përballje dhe zgjidhje të konflikteve, meqë stilet tjera nuk shpijnë drejt procesit konstruktiv në të cilin të gjitha palët në konflikt janë të vlerësuara, ndërsa qëndrimet dhe mendimet merren parasysh dhe respektohen. Në mënyrë plotësuese, bashkëpunimi dhe kompromisi e përfshijnë edhe dimensionin e komunikimit efektiv si bazë në qasjen konstruktive të zgjidhjes së konflikteve.



Aktivitet për reflektim

Nxënësit plotësojnë *Pyetësor për vetëvlerësim dhe identifikim të stilit personal të përballjes/zgjidhjes së konflikteve* (Fletë pune 2.6 **Test për identifikimin e stilit personal të përballjes/zgjidhjes së konflikteve**) dhe duhet të mendojnë se sa është stili i tyre konstruktiv.



Fletë pune 2.6

Stile personale të përbaljes /zgjidhjes së konflikteve

- 1) Garë** – ky stil nënkupton se personi i përfshirë në konfliktin synon që me çdo çmim të imponojë mendimin ose zgjidhjen e tij për problemin. Këta persona dinë të jenë dukshëm me ndikim. Shpesh dinë t'i sulmojnë ata që nuk pajtohen me ta, po madje edhe të jenë të vrazhdë dhe agresiv.
- 2) Përshtatje** – ky stil nënkupton se personi i përfshirë në konfliktin ka prirje miqësore dhe synon t'u përshtatet të gjitha palëve të tjera të përfshira në konflikt. Këta persona nuk u japin rëndësi të mjaftueshme nevojave të tyre, gjë që me kalimin e kohës mund të kalojë në pakënaqësi nga vetvetja. Nga ana tjetër, ndonjëherë problemi nuk u është aq i rëndësishëm ndaj për këtë arsye nuk insistojnë në propozime të tyre për zgjidhjen e konfliktit.
- 3) Evitim** – ky stil nënkupton se personi i përfshirë në konflikt me çdo çmim synon t'u përshtatet të gjithëve. E gjithë situata e konfliktit u është e pakëndshme dhe nuk duan të përballen me konfliktin. Këta persona shtiren se problemi nuk ekziston ose nga ana tjetër se nuk është serioz.
- 4) Kompromis** – kur situata nuk është aq e rëndësishme, por problemi duhet të zgjidhet atëherë mundohemi të "bëjmë pazar" me palët që janë të përfshira në konflikt. Me këtë rast, secili heq dorë nga pak nga diçka dhe në fund vjen deri te zgjidhja e kompromisit në të cilën secili do të humbë diçka mirëpo do të arrihet deri te zgjidhja e përgjysmuar me të cilën të gjitha palët janë pjesërisht të kënaqura.
- 5) Bashkëpunim** – kur zbatohet stili i bashkëpunimit, secila prej palëve është e rëndësishme dhe secili aktivitet kontribuon në gjetjen e zgjidhjes së përbashkët. Zgjidhja nuk është e thënë të jetë e përsosur, por duhet të jetë mjaftë e mirë dhe e pranueshme për të gjithë. Zakonisht, procesi i gjetjes së zgjidhjes rrjedhë më gjatë dhe kërkon komunikim aktiv nga të gjitha palët e përfshira. Synohet që të gjendet zgjidhje cilësore me të cilën të gjithë janë të kënaqur dhe ndjehen si fitues përkundër faktit që ndoshta kanë hequr dorë nga diçka. Në procesin e bashkëpunimit është veçanërisht e rëndësishme që secili mendim i secilës palë në konflikt respektohet dhe mbahet llogari edhe për interesat personal, por edhe për interesat e të gjitha palëve.



Fletë pune 2.7

Test për identifikimin e stilit personal të përballjes /zgjidhjes së konflikteve

Me zgjidhjen e këtij testi do të mund të zbuloni stilin tuaj personal të përballjes/zgjidhjes së situatës së konfliktit. Mendoni rreth rezultatit që do ta merrni dhe shikoni nëse me të vërtetë përputhet me stilin të cilin ju mendoni se e zbatoni. Në këtë test nuk ka përgjigje të sakta dhe të gabuara, ndërsa rezultati që do ta merrni do të ju nxisë që më tutje të mendoni në drejtim të asaj se sa qasje konstruktive keni në përballje dhe zgjidhjen e situatave të konfliktit.

Instruksione për zgjidhjen e testit: lexoni me kujdes deklaratën dhe rrethoni numrin përkatës të shkallës. Për shembull, nëse një deklaratë e caktuar është shumë karakteristike për ju, atëherë rrethoni numrin 6 ose 5, e nëse nuk është fate karakteristike për ju e rrethoni numrin 1 ose 2. Tentoni që sa më pak t'i zgjidhni numrat vijues 3 dhe 4.

A. Në situatë konflikti diskutoj në mënyrë aktive dhe kërkoj mënyrë se si t'i plotësoj nevojat e të tjerëve, por edhe nevojat e mia.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

B. Në situata konflikti mundohem të siguroj që e vërteta ime të mbisundojë dhe nuk mundohem t'i kënaq të tjerët.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

C. Në situata konflikti mundohem të jem i/e arsyeshëm/me ashtu që nuk kërkoj të plotësohet gjithë ajo që e dua unë, por synoj të fitoj së paku diçka nga ajo që e dua.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

Ç. Në situatë konflikti nuk insistoj të jetë siç dua unë, por edhe nuk e bëj atë që e kërkojnë të tjerët.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

D. Në situatë konflikti i lë anash nevojat e mia dhe mundohem të mos e prishi raportin me personin/at me të cilët jam në konflikt.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

DH. Në situatë konflikti përfshihem më pak në komunikim me palët tjera dhe qëndroj anash.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

E. Në situatë konflikti e bëj atë që mendoj se duhet ta bëj dhe shpresoj se relacionet me palët tjera në konfliktin do t'i përmirësojmë më vonë.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

Ë. Në situatë konflikti brengosem shumë për ndjenjat e të tjerëve.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

F. Në situatë konflikti, veçanërisht u kushtoj kujdes dëshirave të të tjerëve, por megjithatë insistoj në atë që edhe të tjerët t'u kushtojnë kujdes dëshirave të mia.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

G. Në situatë konflikti, ushtroj „presion“ që të arrihet njëfarë kompromisi që të zgjidhet situata më shpejtë dhe të vazhdojmë më tutje.

Nuk është fare karakteristike për mua

← 1----2----3----4----5----6 →

Është shumë karakteristike për mua

Zgjidhje

Pranë çdo shkronje shkruaj numrin që e keni rrethuar në pyetjen përkatëse. Mblidhni të dy numrat dhe shënoni rezultatin. Atje ku kemi rezultat më të madh nga të dy numrat, ai stil është me siguri stili juaj personal i përballjes me situata të konfliktit.

Bashkëpunim

$$A \text{ _____ } + F \text{ _____ } = \text{ _____ }$$

Kompromis

$$B \text{ _____ } + G \text{ _____ } = \text{ _____ }$$

Përshtatje

$$D \text{ _____ } + E \text{ _____ } = \text{ _____ }$$

Evitim

$$Ç \text{ _____ } + DH \text{ _____ } = \text{ _____ }$$

Garë

$$B \text{ _____ } + E \text{ _____ } = \text{ _____ }$$



Përmbajtja:



Interkulturalizmi
në shoqërinë
qytetare

Ora e parë



Qëllim/e i/të orës mësimore:

- ➔ T'i sqarojë multikulturalizmin dhe interkulturalizmin si dukuri
- ➔ T'i sqarojë elementet e shoqërisë interkulturore.



Rezultate nga mësimi

- ➔ Bën dallimin mes multikulturës dhe interkulturës
- ➔ Dallon elemente të shoqërisë interkulturore
- ➔ Realizon aktivitete konkrete që kontribuojnë në ndërtimin e vlerave interkulturore.



Metoda, teknika, forma:

Diskutim, stuhi të ideve, teknika e rrushit, Diagrami i Venit, punë frontale dhe në grupe.



Materiale të nevojshme:

- ➔ Fotografi 2.3 me rrethe (multikulturalizmi dhe interkulturalizmi), tabelë, letër.



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Me qëllim – njohje me qëllimet dhe rezultatet e pritura dhe inicimin e diskutimit hyrës për përkatësinë në bashkësi/kultura/grupe të ndryshme, që të vendosen konceptet e multikulturalizmit dhe interkulturalizmit, mësimdhënësi paralajmëron:

Vitin e kaluar kemi punuar në tema që kanë të bëjnë me identitetin personal dhe pranimin dhe respektimin e dallimeve. Të përkujtohem:

- ➔ Çfarë ishte ajo që personalisht më bën të ndryshëm nga të tjerët në: shkollë, mjedisin në të cilin jetoj, në shtet?

Pas këtyre pyetjeve mësimdhënësi mundet me një-dy fjali të bëjë përmbledhjen e dallimeve (e edhe ngjashmërive) që vijnë për shkak të faktit se të gjithë i takojmë grupit/bashkësisë/kulturës së ndryshme, secila me veçoritë e saj dhe ta parashtojë pyetjen:


- ➔ A mund të përmendni pjesëtarë të kulturave të ndryshme në lagjen në të cilën jetoni ose në territorin e shtetit tonë?

Pasi që nxënësit do të përgjigjen në pyetjen, mësimdhënësi mund të bëjë përmbledhje se jetojmë në shoqëri në të cilën ekzistojnë më shumë grupe/bashkësi/kultura të ndryshme dhe të vazhdojë me diagramet për t'i sqaruar konceptet e multikulturës dhe interkulturës.

Mësimdhënësi u tregon nxënësve dy fotografi (Fotografia 2.3 dhe 2.4) të cilat simbolikisht paraqesin multikulturalizëm dhe interkulturalizëm. Fillohet diskutimi:

- 1) Çfarë shikoni në njëërën, e çfarë në fotografinë tjetër?
- 2) Çfarë paraqesin rrathët?
- 3) Si dhe nëse ato komunikojnë mes vete në të parën, e si në të dytën?

Përmes diskutimit duhet të arrihet deri te konstatimet se në të dyja fotografitë janë paraqitur bashkësi të ndryshme, por se në të parën nuk komunikojnë/bashkëpunojnë mes vete, në të dytën të gjithë kanë bashkëveprim të ndërsjellë (bashkëpunim, komunikim). Prej aty kalohet në sqarimin e koncepteve të multikulturalizmit (të paraqitura në mënyrë simbolike përmes fotografisë 2.3) dhe interkulturalizmi (i paraqitur në mënyrë simbolike përmes fotografisë 2.4).



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Në pjesën teorike të orës mësimdhënësi, kryesisht, duhet të përqendrohet dhe t'i sqarojë nocionet (të bëjë dallimin) multikulturalizëm, shoqëri multikulturore, interkulturalizëm, shoqëri interkulturore:

Shoqëri multikulturore është shoqëria në të cilën jetojnë disa grupe të ndryshme kulturore ose etnike. Njerëzit jetojnë në hapësirë të njëjtë, por individët nga një grup kulturor në të shumtën e rasteve komunikojnë vetëm brenda grupit. Për shembull, në fqinjësinë multikulturore, njerëzit mund të shkojnë të hanë në restorant që shërben ushqim tipik për ndonjë bashkësi etnike, por të mos kenë kontakt fare me njerëzit e asaj bashkësie.

Shoqëri interkulturore është shoqëria në të cilën mes bashkësive të ndryshme ekziston mirëkuptim dhe respekt i ndërsjellë. Komunikimi interkulturor fokusohet në shkëmbimin e ndërsjellë të ideve dhe normave kulturore dhe zhvillimit të lidhjeve të ndërsjella. Në shoqërinë interkulturore, askush nuk mbetet i pandryshuar, meqë të gjithë mësojnë prej njëri-tjetrit dhe rriten së bashku.

Aktivitet **Shkollë multikulturore dhe interkulturore**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dy grupe. I vendosë në situatën reale në vendin tonë ku kemi situatë të shkollave njëgjjuhëshe/shumëgjjuhëshe në të cilat mësojnë pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike. Duke marrë parasysh këtë, njëri grup duhet të mendojë se si do të dukej një shkollë multikulturore, ndërsa tjetri të mendojë se si do të dukej një shkollë interkulturore. Si udhëzim në të menduarit e tyre mund të parashtrohen pyetjet si vijon:

- 1) Si do të dukej një klasë?
- 2) Si do të ishte bashkëpunimi mes klasave?
- 3) Si do të dukej një "orë multikulturore", e si një "orë interkulturore"?
- 4) Si do të dukeshin kremtimet dhe manifestimet e shkollës?

5) Çfarë bëjnë mësime në një shkollë multikulturore, gjegjësisht interkulturore?

6) A mund të përmendni shembuj të aktiviteteve në shkollë që kontribuojnë në ndërtimin e vlerave interkulturore?

Grupet mund t'i prezantojnë mendimet e tyre përmes vizatimit/eve (në letër) ose përmes kuptimeve (fjalëve).

Rezultatet për shkollë multikulturore do të duhej të gravitojnë drejt: mësimit për kultura të tjera pa komunikim/bashkëveprim të drejtpërdrejt; klasave homogjene në aspektin etnik/gjuhësor; nuk ka orë/aktivitete të përbashkëta mes klasave; në mënyrë të ndarë përgatiten pikat/aktivitetet për manifestime dhe kremtime; mësime vetëm i mësojnë nxënësit për kulturën e të tjerëve, por nuk krijojnë mundësi reale që nxënësit e bashkësive/kulturave të ndryshme etnike të takohen bashkë në aktivitete mësimore ose jashtë mësimore dhe ngjashëm; mësime nuk bashkëpunojnë mes vete gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimit.

Rezultatet për shkollën interkulturore do të duhej të gravitojnë drejt si vijon: klasës së përbërë prej nxënësve të bashkësive të ndryshme; orë të përbashkëta ku do të nxitet dialogu mes nxënësve që të mund të njoftohen më mirë mes vete; planifikim dhe realizim i përbashkët i manifestimeve dhe kremtimeve shkollore; mësime krijojnë mundësi reale që nxënësit të takohen dhe së bashku të mësojnë dhe të shoqërohen (jepet mundësi për vendosjen e dialogut mes nxënësve të bashkësive/kulturave të ndryshme); mësime e grupeve/kulturave të ndryshme etnike/gjuhësore bashkëpunojnë mes vete dhe janë shembull për bashkëpunim dhe komunikim të ndërsjellë dhe ngjashëm.

E përbashkët për të dyja do të ishte: vetëdija për ekzistimin e kulturave të tjera, njohje dhe respektim të ndërsjellë të dallimeve, mosdiskriminim i asnjë grupi kulturor.

Derisa grupet bëjnë prezantim, mësime në tabelë mund të ketë vizatuar *Diagramin e Venit* dhe drejtpërdrejt t'i shënojë konceptet/kuptimet kryesore nga prezantimi i nxënësve. Ajo që do të përsëritet, ndërsa vlen edhe për multi/interkulturalizmin, në fund do ta shkruaj në prerjen e diagramit si të përbashkët.



Pjesa përfundimtare e orës

(5min.)

Aktivitet

Diskutim për interkulturalizmin

Mësimdhënësi nxitë diskutim për interkulturalizmin, duke theksuar interkulturalizmin si koncept i cili shkon “një hap më tutje” nga multikulturalizmi. Mund të përdoren pyetjet si vijon për diskutim:

- 1) A mund të dallojmë në mjedisin tonë elemente të interkulturalizmit - cilat?
- 2) A jeni në dijeni për aktivitete ose ngjarje në qytet/shtet që kontribuojnë ose kanë kontribuar në bashkëpunimin dhe bashkëveprimin më të madh mes pjesëtarëve të bashkësive/kulturave të ndryshme? Nëse „po” cilat? Nëse „jo”, atëherë çfarë do të bënit ju që të kontribuoni drejt krijimit të shoqërisë interkulturore? (Këtu mësimdhënësi mund t’i referohet ushtrimit paraprak nëse grupi ka identifikuar aktivitete në nivel të shkollës, t’i nxisë nxënësit të mendojnë se çfarë do të mund të bëhej në nivel të shoqërisë)
- 3) Në çfarë shkolle do të donit ju të mësoni? Në çfarë mjedisi të jetoni?

Përfundim

- ➔ Jetojmë në shoqëri në të cilën ekzistojnë bashkësi/grupe/kultura të ndryshme dhe duhet të synojmë ndërtimin e shoqërisë interkulturore në të cilën do të ketë bashkëpunim mes kulturave të ndryshme;
- ➔ Që të ndërtojmë shoqëri interkulturore nevojitet që te secili prej nesh të zhvillojmë kompetenca interkulturore që nënkuptojnë: njohje dhe respektim të dallimeve; vetëdije për identitetin tënd personal dhe kulturor dhe pranim se për arsye të ndryshme, ekzistojnë dallime mes grupeve/bashkësive/kulturave të ndryshme; vendosje dhe mirëmbajtje të komunikimit dhe dialogut mes grupeve/bashkësive/kulturave të ndryshme; pranim i atyre që janë të ndryshëm nga ne dhe aftësi për bashkëveprim me të ndryshmit prej nesh që është i liruar nga qëndrimet negative (stereotipa, paragjykimet, diskriminim).
- ➔ Shoqëria interkulturore na mundëson të mësojmë për njëri-tjetrin, të plotësojmë njëri-tjetrin dhe të zhvillohemi si individë.

Foto 2.3.





Foto 2.4.



Tema

3

QYTETARI DHE SHOQËRIA QYTETARE

Përmbajtja:



Përgjegjësi
sociale

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të përshkruajë sjelljen e qytetarëve në shoqëri
- ➔ Të dallojë sjelljen e përgjegjshme nga ajo e papërgjegjshme.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Analizon në mënyrë kritike dhe diskuton role dhe sjellje të ndryshme të qytetarët
- ➔ Dallon se çfarë është përgjegjësia sociale në shkollë dhe bashkësi.



Materiale të nevojshme:

Fletë pune 3.1., tabelë, letër.



Metoda, teknika dhe forma:

Analizë e rasteve, punë në grupe, diskutim në grupe, vetëvlerësim.




Pjesa hyrëse e orës

(10 min.)

Mësimdhënësi i përfshin nxënësit në temën përmes diskutimit lidhur me pyetjet si vijojnë:

- 1 A ju kanë treguar prindërit tuaj se duhet të "merrni përsipër përgjegjësi" për diçka? Çfarë mendojnë me këtë? Çfarë do të thotë "të merrni përsipër përgjegjësi"?
- 2 A konsideroni se jeni individ i përgjegjshëm? Sqaroni!
- 3 Si ndikon sjellja e përgjegjshme në raportin tuaj me miqtë? Sa është kjo e rëndësishme?
- 4 Si ndikon sjellja e përgjegjshme në raportin tuaj me prindërit/kujdestarët? Sa është kjo e rëndësishme?
- 5 A i keni shkaktuar ndonjëherë problem dikujt me papërgjegjësinë tuaj? Çfarë ndodhi? A do të vepronit më ndryshe nëse do të keni mundësi?
- 6 A ju ka shkaktuar edhe juve dikush problem me papërgjegjësinë e tij/saj? Çfarë ndodhi? Çfarë do të donit që ai person të mësojë nga veprimi i tij?
- 7 Konsideroj se ekziston lidhje mes asaj të jesh i përgjegjshëm dhe të jesh individ i besueshëm? Të qenët i përgjegjshëm dhe të qenët i respektuar?





Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Në çdo shoqëri, vlerat e pranuar morale dhe etike bëjnë të ditur se cila sjellje e njerëzve është e përgjegjshme ose e pranueshme. Pasi që të përcaktohet sjellja e përgjegjshme, dallohet edhe sjellja e papërgjegjshme, sjellje jashtë kornizave të rregullave morale dhe etike të bashkësisë. Sjellja e përgjegjshme dhe e papërgjegjshme dallohet edhe në shoqërinë bashkëkohore qytetare.

Aktivitet **Sjellje e** **përgjegjshme**

Nxënësit janë të ndarë në 2-4 grupe (varësisht nga numri i nxënësve në klasë) dhe mësuesi u ndanë fletat e punës 3.1. dhe 3.2. për „Sjellje të përgjegjshme”. Nxënësit duhet të lexojnë situatën që e kanë marrë dhe të diskutojnë në kuadër të grupit.

Më pas, në kuadër të gjithë klasës fillohet diskutim për situatat.



Udhëzime të mësimdhënësit për situatën 1: Me paraqitjen e Internetit, u paraqitën lloje të reja të dilemave për sjellje të përgjegjshme, që janë veçanërisht karakteristika për të rinjtë. Ideja e situatës është që nxënësit të mos e anashkalojnë kompasin personal moral. Nëse ndjejnë se diçka nuk është në rregull, me siguri me të vërtetë nuk është në rregull. Duhet ta dëgjojmë “kompasin” tonë. Në mënyrë plotësuese, situata mund të përdoret si shembull për atë se si disa aktivitete dhe procedura që konsiderohen si personale mund të reflektohen në mjedisin. E kujt është përgjegjësia në atë rast?

Fillohet diskutimi sipas pyetjeve që vijojnë (lista e pyetjeve mund të plotësohet):

- Cila prej ideve për zgjidhjen e problemit, për të cilat mendon Sara, ju duket më e logjikshme? A mund t’ju kujtohet ndonjë mënyrë më e mirë për zgjidhjen e problemit?
- Çfarë do të kishit bërë ju në situatë të tillë? Nëse konsideroni se varet nga përmbajtja e fotografisë, ku do të tërhiqni vijën? A mund të sqaroni pse?
- A konsideroni se secili duhet të mund të thotë se çfarë do nëse është në mesin e njerëzve që ju beson? Pse? Pse jo?
- A keni qenë në situatë të ngjashme? Çfarë ndodhë? Çfarë mendoni për mënyrën në të cilën është zgjidhur situata?
- A është situata e këtillë problem i shkollës, nëse nuk e shikon dikush përveç anëtarëve të grupit të mbyllur?
- A kemi përgjegjësi morale kur përdorim Internetin? Si do ta kishit definuar këtë përgjegjësi?
- Çfarë është „kompasi moral”? A konsideroni se keni kompas moral? A e kanë të gjithë njerëzit? Si mund të dini nëse dikush vepron në përputhje me kompasin moral të tij?

Udhëzime për mësimdhënësit për situatën 2: Mund të filloni diskutimin me vërejtjen se të gjithë jemi hasur në situatë të këtyllë ose të ngjashme ndonjëherë në jetë. Vendimin që e kemi marrë nëse do të jemi hero ose gënjeshtar e kemi arsyetuar në njëfarë mënyre. Kështu edhe Kani siç duket është fëmijë i mirë, ngjashëm me ne. Për shkak të kësaj, a kemi prirje që ta arsyetojmë ose nga ana tjetër na hidhëron përzgjedhja e tij?

Mund t'i shfrytëzoni pyetjet si vijojnë për të drejtuar diskutimin:

- ➔ Vihuni në vendin e Kanit? Çfarë do të kishit bërë?
- ➔ A do të vendosnit më ndryshe nëse do ta dinit se paratë i takojnë bankës, e jo ndonjë individ?
- ➔ A do të kishit vendosur më ndryshe nëse do të kishte njerëz të tjerë duke kaluar?
- ➔ A do të vendosnit më ndryshe nëse do të ishit me shokë? Çfarë do të bënit?
- ➔ A keni bërë diçka që e dini se është e gabueshme, meqë askush nuk ka shikuar? Si ndjeheshit kur e bënit këtë? A do ta kishit bërë këtë sërish? Pse? Pse jo?
- ➔ Çfarë do të fitoni nëse i zbatoni fjalët e gjyshit të Kanit për mashtrim? A jeni dakord se gjithmonë kur mashtroni jeni më afër asaj që t'ju konsiderojnë si "gënjeshtar"?
- ➔ Mendoni për ndonjë vendim që e keni bërë para do kohë, e që mund të reflektohet te një numër më i madh i njerëzve përveç jush. Tani paramendoni nëse secili në botë e bën punën e njëjtë. Si do të ishte ajo botë? A do të donit të jetoni në të?





Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Arsimtari pyet: Si ndjehemi kur e mbarojmë mirë atë për çfarë jemi përgjegjës?

Kur e kemi mbaruar mirë atë për çfarë jemi përgjegjës, ndjehemi të kënaqur dhe me vetërespekt të lartë. Secili prej nesh ka përgjegjësi ndaj vetes, shokëve, familjes, kafshëve të përkëdhelura shtëpiake, shkollës, bashkësisë më të ngushtë dhe më të gjerë, ndaj botës dhe të tjerëve. Ndonjëherë jemi të shtrënguar mes vendimeve nëse duhet të bëjmë diçka meqë ndoshta do të jemi të gjykuar nga shokët, do t'i shkaktojmë shqetësim dikujt tjetër, etj. Megjithatë, duhet të udhëhiqemi edhe nga ndjenja jonë personale për atë se çfarë është e drejtë dhe çfarë do të bënim në periudhë afatgjate që të ndjehemi të kënaqur dhe krenar.

Nëse sillemi me përgjegjësi, atëherë të tjerët do të kenë besim te ne dhe do të mund të mbështeten te ne, ndërsa ne vetë do të kemi pasqyrë pozitive për veten dhe vetërespekt të lartë. Do të kemi ndjenjë të mirë se ajo që jemi duke e bërë është për të mirën e përbashkët për të gjithë dhe do të shkaktojmë ndryshim pozitiv te të tjerët.



Fletë pune 3.1

Sjellje e përgjegjshme ndaj shokëve

Situata 1:

Të jesh ose të mos jesh?

Sarën e ftuan t'i bashkëngjitet grupit të fëmijëve nga shkolla e saj në Facebook. Meqë zakonisht ishte e druajtur dhe prej para do kohë filloi të shoqërohet me atë shoqëri, ndjehej shumë mirë që e "pranuan" në grupin. Ishte shumë argëtuese, shkëmbejin buzëqeshje, dakordoheshin për të dalë për zbavitje. Deri sa një ditë nuk ndodhi...

Sara e hapi Facebook-un dhe pa se dikush ka postuar një fotografi të një vajze të klasës së saj, në të cilën koka e saj ishte montuar në trupin e një kafshe. Anëtarët tjerë të grupit filluan me komentimin dhe ngacmimin e vajzës në fotografi. Sara, ndonëse nuk e njihnte shumë mirë vajzën në fotografi, ishte e sigurt se nëse e sheh fotografinë – do të jetë e lënduar.

Sara e dinte se ky është grup i mbyllur dhe gjithçka që postohet e shikojnë vetëm anëtarët, por filloi të mendojë nëse dëshiron të jetë pjesë e një grupi në të cilin postojnë gjëra të këtilla. Çfarë flet kjo për të? Nëse e sheh dikush këtë, mund të mendojë se është qëndrim i të gjithë anëtarëve të grupit. Mendonte edhe për atë nëse dikush jashtë grupit do të kishte mundësi të shikonte fotografinë. Çfarë nëse e njëjta "shpërndahet" përmes Internetit, ndërsa ajo nuk ka bërë asgjë për ta penguar këtë?

Po t'u thoshte diçka anëtarëve të grupit, a do të përgjigjeshin me "qetësohu" dhe do ta konsideronin si të çuditshme. Megjithatë, nuk mund të pajtohej me situatën. A t'u thotë diçka prindërve, e të rrezikojë që t'ia ndërpresin qasjen në internet. A t'i tregojë kujdestares së klasës, të cilën e respektonte shumë dhe të rrezikojë që të iniciojnë temë në nivel të gjithë shkollës dhe t'i ndëshkojnë të gjithë nxënësit? A t'u thotë anëtarëve të grupit dhe të rrezikojë që ta "përrjashtojnë" nga shoqëria. A të braktisë grupin?

Ndjehej shumë e bllokuar mes vendimesh. Ajo nuk ka bërë asgjë të keqe. Vetëm iu bashkëngjiti FB grupit. Pse i paraqiste kjo problem kaq të madh? Si të veprojë?



Fletë pune 3.2

Sjellje e përgjegjshme ndaj bashkësisë

Situata 2:

~~A është gabim nëse askush nuk e ka parë?~~

Kani u përshëndet me shokët dhe u nis drejt shtëpisë. Kishte disponim të shkëlqyeshëm, pushimi sapo kishte filluar dhe mund të rrinte tërë ditën me shokët. Lëshoi muzikë në telefon, i vendosi kufjet dhe buzëqeshi. Derisa po kalonte pranë shitoreve rrugës për në shtëpi vërejti diçka në bankomat. U afrua dhe pa të holla.

Kani shikoi rreth e rrotull. Askush nuk ishte. Nuk kishte automjete, askush nuk kalonte. Me siguri dikush ka përdorur bankomatin dhe ka harruar t'i marrë paratë. Kushdo që të ketë qenë, tani më nuk është. Shkoi deri te automati dhe i nxori paratë. Një mijë denarë.

Sërish hodhi një sy rreth e rrotull. Nuk kishte asnjë. Mund t'i kthente paratë në bankë të nesërmen. Por, a do ta bënte? Bëhej fjalë për vetëm një mijë denarë! Me siguri nuk do të thonë shumë për atë që i ka harruar, ndërsa do të thonë shumë për Kanin. Mund të blejë ndonjë dhuratë për ditëlindje, të qeras veten diçka në piceri.

A është e gabuar nëse bën diçka të këtillë vetëm një herë? Kani mendonte për këtë. Kjo nuk do të thotë se është vjedhës. Dikush ka qenë i hutuar dhe i ka harruar paratë. Kani bindi veten se është mirë që t'i marrë paratë. Vetëm një herë e bën këtë. Dhe askush nuk është e thënë ta dijë. I vuri paratë në xhep dhe u largua.

Siç filloi të interpretojë kënga e radhës, Kanit iu kujtua ajo që e ka dëgjuar nga gjyshi i tij "Gjithmonë kur të gënjesh, je më afër asaj që të të konsiderojnë gënjeshtar". Por, kjo nuk ishte punë e njëjtë. Ose? Kani i dha zë muzikës dhe vazhdoi për në shtëpi.





Përmbajtja:



Përgjegjësi
sociale

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të kuptojë nevojën e përgjegjësisë sociale.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Dallon se çfarë është përgjegjësi sociale në shkollë dhe bashkësi
- ➔ Angazhohet në situata në të cilat nevojitet përgjegjësi sociale
- ➔ Merr pjesë dhe inicion aktivitete për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi.



Materiale të nevojshme:

Fletë pune 3.3., letër, stilograf, stikerë.



Metoda, teknika dhe forma:

Stuhi e ideve, punë në grupe, diskutim në grupe, vetëvlerësim.



Pjesa hyrëse e orës


(5 min.)

Mësimdhënësi e prezantoi përmbajtjen mësimore.

Me stuhi të ideve gjegjësisht me shkrim në copë letër të vogël ose stiker secili nxënës e mbaron fjalinë e cila fillon si vijon: „Përgjegjësi sociale është kur...”

Më pas i vendosin në një kuti, ndërsa mësimdhënësi i nxjerrë një nga një dhe i lexon, e më pas i ngjit me shirit ngjitës në flipçart ose hamer në të cilin në mes shkruan përgjegjësi sociale.

Mësimdhënësi duhet të bëjë përmbledhje se për të qenë me përgjegjësi sociale do të thotë që të merret përsipër përgjegjësi për veprimet personale dhe t'i kushtohet kujdes që veprimet tona të mos reflektohen negativisht mbi të tjerët. Përgjegjësia sociale mund të ndërlidhet thjeshtë me përkujdesin për punët në shtëpi (kursim të ujit, p.sh.), në shkollë (ruajtje të orendive në klasë); ndërsa mund të ndërlidhet edhe në ndërmarrjen e aksioneve konkrete për përmirësimin e situatave të caktuara përmes dhënies së ndihmës në bashkësi, vullnetarizëm, ngritjes së vetëdijes për probleme të caktuara në bashkësi, etj. Të kesh përgjegjësi sociale do të thotë edhe të dënohen veprimet negative që i shikojmë te të tjerët (p.sh. sjellje e dhunshme, mashtrim, etj.)



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Aktivitet **Lloje të** **përgjegjësi**

Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secili grup merr nga një fletë pune 3.3. në të cilin është shkruar nga një prej relacioneve si vijon: ndaj shokëve, ndaj familjes, ndaj shkollës dhe ndaj bashkësisë, gjegjësisht nga një pjesë e fletës së punës për nxënësit “Lloje të përgjegjësi”.

Secili grup duhet të shkruajë dy përgjegjësi që nxënësit i kanë në raport me relacionin e marrë. Shembuj për secilin lloj të përgjegjësisë janë dhënë më poshtë.

Më pas duhet t'i shkëmbejnë fletët me grupin që është në anën e tyre të majtë dhe në fletët e grupit tjetër të shtojnë përgjegjësi të reja, nëse konsiderojnë se ka nevojë. Fletët më tutje shkëmbehen dhe plotësohen sipas parimit të njëjtë derisa fleta të kthehet te grupi që e ka filluar. Fletët më pas vendosen në vend të dukshëm dhe mësimdhënësi/ja i lexon përgjegjësitë e shënuara.



Shembuj të përgjegjësi:



Përgjegjësi ndaj të tjerëve

Shembuj:

Të ndihmoj gjatë zgjidhjes së detyrës matematikore nëse ka nevojë
Të sillet mirë me bashkënxënësit

Përgjegjësi ndaj familjes

Shembuj:

Të kontribuoj për mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi
Raporte të mira dhe korrekte me prindërit

Përgjegjësi ndaj shkollës

Shembuj:

Të jem i/e rregullt dhe i/e saktë në orë
Shpenzim i arsyeshëm i energjisë elektrike dhe ujit

Përgjegjësi ndaj bashkësisë

Shembuj:

Mirëmbajtje e mjedisit të pastër
Pjesëmarrje në grumbullimin e mjeteve për qëllime humanitare



Diskutim

- Cilat nga përgjegjësitë e shkruara janë pjesë e përgjegjesisë sociale?
- Mendoni për përgjegjësi të reja, në kuadër të relacioneve të njëjta, që janë të ndërlidhura me përgjegjësinë sociale?
- Përmendni shembuj pozitiv të përgjegjesisë sociale.
- Çfarë aktivitesh do të kishit propozuar në drejtim të përmirësimit të jetës në shkollë dhe bashkësinë?

Mësimdhënësi thekson se disa nga aktivitetet e përmendura mund t'i bëjmë vetë dhe të arrijmë rezultate të kënaqshme, por për një pjesë të mirë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me shkollën dhe bashkësinë, nevojitet t'u përmbahen përgjegjësive të përmendura. Për shembull, nëse vetëm 2 fëmijë në shkollë kujdesen për mirëmbajtjen e mjedisit të pastër (gjegjësisht i hedhin mbeturinat në shportë), shkolla nuk do të jetë e pastër; nëse vetëm një fëmijë organizon aktivitete humanitare, ndërsa askush tjetër nuk merr pjesë – aktivitetet nuk do të jenë të suksesshme dhe nuk do ta arrijnë qëllimin.

Për shkak të kësaj, njerëzit bashkohen në grupe që veprojnë bashkërisht në drejtim të nxitjes dhe praktikimit të aktiviteteve të përgjegjshme sociale. Qytetarët, institucionet dhe organizatat kanë obligim që të veprojnë në favor të shoqërisë në tërësi. Kjo përgjegjësi mund të jetë pasive, duke iu shmangur angazhimit në aktivitete që janë të dëmshme për shoqërinë ose mund të jetë aktive, përmes ushtrimit të aktiviteteve që drejtpërdrejt i avancojnë qëllimet shoqërore. Edhe nxënësit kanë përgjegjësitë e tyre në familje, shkollë dhe bashkësi. Ata mund të jenë aktiv dhe të angazhohen, jo vetëm për dobinë e tyre personale, por edhe për avancimin e klimës shkollore dhe për të mirën e të gjithë nxënësve.



Pjesa përfundimtare e orës

(10 min.)

Përfundim

Secili individ ka përgjegjësi të veprorë në mënyrën që është e dobishme për shoqërinë, e jo vetëm për individin. Nëse aksioni ose vendimi shkakton dëm për shoqërinë ose për mjedisin jetësor, atëherë konsiderohet se aksioni i tillë (kjo sjellje) është i papërgjegjshëm në aspektin social. Nëse aksioni është i dobishëm për shoqërinë ose mjedisin jetësor atëherë themi se bëhet fjalë për përgjegjësi sociale.

Përgjegjësia sociale duhet të inkorporohet në të gjitha aktivitetet/ vendimet ditore, veçanërisht ato që do të ndikojnë mbi persona të tjerë dhe/ose shoqërinë në tërësi.

Veçanërisht biznesmenët, gjegjësisht kompanitë e mëdha industriale duhet të kenë sistem të zhvilluar të përgjegjësisë sociale. Ata duhet të anashkalojnë dobinë personale dhe përfitimet materiale për mirëmbajtjen e përgjegjësisë sociale me çka do të sigurojnë mirëqenie në shoqërinë. Ata dhurojnë një pjesë të fitimit për qëllime humanitare, financojnë në mbrojtjen e mjedisit jetësor, sponsorizojnë aktivitete rinore, klube të sportit etj. Në këtë mënyrë, ekziston baraspeshë mes rritjes ekonomike dhe mirëqenies në shoqërinë dhe mjedisin jetësor.

Mësimdhënësi e jep pyetësorin më poshtë në formë të fletës së punës, ose të shënuar në tabelë, që nxënësit të përgjigjen në fletoret e tyre, secili për vete.

A je individ i përgjegjshëm?

(Përgjigju në pyetjet si vijon dhe vendos vetë për vetveten)

Përgjegjësi personale:

Po	Jo	
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	E bëj atë që duhet të bëhet.
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Të tjerët mund të llogarisin në mua.
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Asnjëherë nuk kërkoj arsyetim dhe nuk i akuzoj të tjerët për sjelljen time.
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Gjithmonë e plotësojë atë që e kam premtuar.

Përgjegjësi sociale:

Po	Jo	
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Mundohem të jem i dobishëm për të tjerët.
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Jam vullnetar në shkollën dhe komunën time.
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Marr pjesë në aktivitete që i ndihmojnë bashkësisë.
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	E bëj atë që mundem për ta ruajtur mjedisin.

Mendoj se jam/nuk jam i përgjegjshëm/e përgjegjshme për shkak se:

Nëse duan, nxënësit mund t'i shkëmbejnë konstatimet e tyre. Mësimdhënësi i paralajmëron se në disa orë të ardhshme do të punojnë në aktivitete që do të forcojnë përgjegjësinë e tyre shoqërore si qytetarë. Prandaj, madje edhe nëse janë vlerësuar si jo mjaftë të përgjegjshëm, do të kenë mundësi që ta tejkalojnë këtë përmes aktiviteteve konkrete për përmirësimin e mjedisit të tyre.



Fletë pune 3.3 Lloje të përgjegjësisë

Përgjegjësi ndaj shokëve

Shembuj:

Përgjegjësi ndaj familjes

Shembuj:

Përgjegjësi ndaj shkollës

Shembuj:

Përgjegjësi ndaj bashkësisë

Shembuj:





Përmbajtja:



Organizatat
qytetare
dhe grupet e
përfaqësimit

Një orë



Qëllime të orës mësimore:

- të identifikojë lloje të organizimit dhe bashkimit qytetar
- të sqarojë rolin e organizatave qytetare në shoqëri.



Rezultate nga mësimi:

- Dallon situata konkrete në të cilat qytetarët mund të ndikojnë në përmirësimin e jetës në bashkësinë përmes bashkimit dhe organizimit
- Hulumton shembuj të iniciativave qytetare
- Pranon veprimin e qytetarëve përmes iniciativave qytetare (formale dhe joformale).



Materiale të nevojshme:

Tabelë, shkumës.



Metoda, teknika, forma:

Diskutim, mësimdhënie, stuhi e ideve, diskutim në grupe.



Pjesë hyrëse e orës

(10 min.)

Në tabelën me shkronja të mëdha shkruani kuptimet si vijon: organizata qytetare, shtëpi për pleq, stacionar për kafshë, SOS fshat për fëmijë. Nxitni shkëmbim të ideve me pyetjen: Çfarë është e përbashkët për gjithë këto organizata/institucione? Shënoni përgjigjet në tabelë (nxitini të vijnë deri te përgjigjet si përkujdesje për ata të cilëve u nevojitet, keqardhje, ndihmesë, pafuqi e një grupi të caktuar të njerëzve...). Me këtë rast, nxitini nxënësit që të përkujtohen edhe për organizata ose institucione të tjera, puna e të cilave mbështetet në ndonjërin prej karakteristikave të përmendura. Më pas, tregojuni nxënësve që të zgjedhin një organizatë që u është interesante nga aspekti i problematikës me të cilën merret.

Parashtrajuni nxënësve pyetjet si vijon:

- Çfarë dini për punën e organizatës?
- Drejt kujt është e orientuar puna e tyre?
- A keni pasur ndonjëherë çfarëdo përvoja me organizatën?

Ndiqni me kujdes nëse nxënësit do të përmendin përfaqësimin për një problematikë të caktuar ose grup të njerëzve ose do të përmendin se punojnë edhe vullnetarë në kuadër të organizatës ose institucionit. Pyetini nëse e dinë:

- Çfarë është përfaqësimi? A e kanë takuar deri tani këtë term?
- Cilët janë vullnetarë ose nëse dikush prej tyre ka qenë vullnetar deri tani?


Nëse deri tani as nuk kanë qenë pjesë e ndonjë aktiviteti për përfaqësim, e as nuk kanë pasur mundësi të jenë vullnetarë parashtroni disa pyetje që nëse përgjigjja është po – ngrihen në këmbë, e nëse është jo – rrinë ulur.

➔ A keni ndihmuar ndonjëherë ndonjë...

- ➔ person më të moshuar që mban torba të rënda?
- ➔ person me probleme me shikim, që të kalojë rrugën?
- ➔ bashkënxënës gjatë mësimit për ndonjë lëndë?
- ➔ shkollën në realizimin e aktivitetit që u ndihmojnë të tjerëve?

Pyetini si janë ndjerë derisa u kanë ndihmuar të tjerëve?

Sqarojuni se nëse bëjnë diçka për dikë që të ndihmojnë, si ndihmë individuale për ndonjë person, kjo mbështetet në karakteristikën shumë të rëndësishme njerëzore – humanitet (njerëzi), ndërsa kur ajo është bazë për aksion me të cilin u ndihmohet të tjerëve, bën të mirë në bashkësinë dhe me këtë rast nuk pritet asgjë si kundërpërgjigje ose nuk përvetësohet kurrfarë dobie materiale, kjo do të thotë të jesh vullnetarë. Gjithsesi mund t'i nxisni që të shkëmbejnë idetë e tyre për definicionin për vullnetarizëm.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Njëra prej mënyrave më efikase të përfshirjes në jetën shoqërore është përmes realizimit të së drejtës së bashkimit të lirshëm. Përdorimi i kësaj të drejte mundëson grupimin dhe veprimin e përbashkët të njerëzve, për shkak të nxitjes së interesit dhe debatit publik, por edhe për shkak të zgjidhjes së pyetjeve me interes për ta. Ajo që për një individ është vështirë të realizohet, mund të realizohet më lehtë bashkërisht me më shumë individë të cilët e ndajnë idenë e njëjtë. Ndarja më themelore e mënyrave se si qytetarët bashkohen për të realizuar një interes të përbashkët të tyre është:

- Bashkim politik (formim dhe anëtarësim **në parti politike**):
- Bashkim në **organizata qytetare**; dhe
- Bashkim në **grupe joformale** (për shembull: grup i fqinjëve për të rregulluar hyrjen e ndërtesës).

Sipas *Deklaratës universale për të drejtat e njeriut të KB-ara* dhe *Konventës evropiane për të drejtat e njeriut*, secili njeri ka të drejtën e tubimit dhe bashkimit të qetë. Bashkimi i lirshëm nënkupton mundësinë për formimin, anëtarësimin, aderimin dhe largimin e lirshëm nga një shoqatë ose formë tjetër e organizimit. Individët bashkohen në organizata qytetare për shkak të realizimit të qëllimeve më të ndryshme, që mund të jenë qëllime të interesit më të gjerë publik (për shembull: shoqatë për mbrojtjen e mjedisit jetësor), por edhe qëllime me interes për grup më të vogël të njerëzve (për shembull: klub i shahistëve, shoqatë e peshkatarëve, klub debati, klub studentor i biologëve, etj.).

Kushtetuta e shtetit tonë përmes nenit 20, e rregullon të drejtën e bashkimit të lirshëm, sipas të cilit: *„Qytetarët mund të themelojnë lirshëm shoqata të qytetarëve dhe parti politike, të aderojnë në to dhe të dalin prej tyre“*. Rregullimi më i hollësishëm i kësaj të drejte është parashikuar me *Ligjin për shoqata dhe fondacione*, ndërsa për të themeluar formalisht shoqatë të qytetarëve, gjegjësisht organizatë qytetare, nevojiten 5 themelues – individë.

Organizatat qytetare paraqesin një pjesë të rëndësishme të bashkësisë në të cilën veprojnë. Ato janë të lidhura ngushtë me të dhe mund të identifikojnë dhe të ofrojnë zgjidhje përkatëse për nevojat lokale (për shembull higjiena në hapësirën publike, sigurim të shtigjeve për biçikleta, përkujdesje për kafshët endacake). Por, përveç asaj që zbatojnë aktivitete me rëndësi për bashkësinë lokale, organizatat qytetare luajnë rol të rëndësishëm edhe në përfshirjen e individëve, kompanive, institucioneve dhe palëve të tjera të prekura në zbatimin e këtyre aktiviteteve.

Secila organizatë, në fakt si edhe sektori publik dhe ai i biznesit, funksionon në kontekstin shoqëror që na rrethon. Meqë në një shoqëri ka faktorë të ndryshëm, me rëndësi të madhe është edhe bashkëpunimi i organizatës qytetare me institucionet shtetërore dhe vendimmarrëse me qëllim që të vendoset komunikim i drejtpërdrejt mes qytetarëve dhe pushtetit shtetëror.

Përfaqësimi nuk është qëllim vetvetiu, kjo duhet të jetë pjesë përbërëse e punës së përditshme të organizatave qytetare drejt realizimit të qëllimeve që duhet të jenë në drejtim të realizimit të të drejtave të caktuara të anëtarëve të tyre ose të grupeve qëllimore. Shembull, organizatat për mbrojtjen e mjedisit jetësor përfaqësojnë qëllime që i përfshijnë interesat e shumicës së madhe të bashkësive të ndryshme. Grupet për përfaqësim janë grupe ose organizata që tentojnë të ndikojnë te autoritetet dhe përdorin forma të ndryshme të përfaqësimit me qëllim që të ndikojnë në mendimin publik ose politikën. Shembull është grupi ekologji "Grinpis" i cili përdorë lobimin për të marrë mbështetje politike për fushatat e tyre. Ata ngritin çështje lidhur me mjedisin jetësor, me qëllim që t'i transmetojnë problemet dhe zgjidhjet në krijimin e politikave publike, si për shembull nxitjen e shfrytëzimit të burimeve përtëritëse të energjisë dhe riciklimit.

Mënyrë tjetër për pjesëmarrje të qytetarëve në realizimin e interesave të tyre të përbashkëta ose interesave të tërë opinionit është vullnetarizmi.

Vullnetarizmi është investim vullnetar i kohës personale të lirë, të mundit, diturisë dhe shkathtësive me të cilat realizohen aktivitete ose shërbime për të mirën e një personi tjetër ose për të mirën shoqërore, pa dobi materiale ose përfitim personal nga e njëjta. Këto aktivitete të qytetarëve në shtetin tonë janë të rregulluara me *Ligjin për vullnetarizëm*. Mund të bëhet vullnetarizëm në organet e pushtetit shtetëror (ministri, agjenci), njësi të vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit, institucione publike (spitale, muze, shkolla, fakultete, kopshte për fëmijë), organizata qytetare dhe fondacione.

Vullnetarët janë njerëz të cilët janë të nxitur nga llojet e ndryshme të motivimit. Gjëja e tyre e përbashkët është që punojnë me kënaqësi duke besuar në misionin që e përmbushin. Përderisa janë vullnetarë kanë mundësi të mësojnë diçka të re dhe me këtë rast të njoftojnë njerëz të rinj, të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë që bashkësia të jetë vend më i mirë për jetë, ndërsa njëherësh ta shfrytëzojnë në mënyrë kreative kohën e tyre të lirë, të prishin monotoninë e përditshmërisë dhe t'i zhvillojnë aftësitë e tyre personale.

Nga perspektiva ekonomike, ndikimi i vullnetarizmit te të rinjtë luan rol të madh. Përmes përfshirjes së të rinjve në aksionet vullnetare, ata zhvillojnë shkathtësi dhe karakteristika personale: vetëbesim, shkathtësi organizative, rritje të diturisë së tyre në fushave të ndryshme, ulje të stresit dhe përmirësim të shëndetit të tyre – që shpie deri te zhvillimin më i madh personal i tyre që është i domosdoshëm për punësimin e të rinjve.



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Nxënësit duhet ta kuptojnë rolin aktiv të qytetarit në shoqëri, mundësinë për të vepruar në mënyra të ndryshme dhe përmes formave të ndryshme me qëllim që të përmirësohet jeta në bashkësi (nga mjedisi i drejtpërdrejt, bashkësia lokale deri te bashkësia më e gjerë).



Aktivitet për vlerësim:

Qytetar aktiv

Mësimdhënësi në tabelë shkruan – ‘qytetar aktiv’ ndërsa nxënësit duhet të shprehin kuptime që asociojnë në kuptimin e shënuar. Përgjigjet e asocuara mund të ndërlidhen me sjelljen/vlerat/karakteristikat (iniciativ, i përgjegjshëm, këmbëngulës/i qëndrueshëm, vullnetarizëm, angazhohet, bashkohet, etj.), ndërsa mësimdhënësi mund t’i klasifikojë në kategori nëse vlerëson se ekziston një mundësi e tillë.



Përmbajtja:



Bashkësia
e nxënësve
- nisje për
përmirësimin
e jetës në
shkollë dhe
bashkësi

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të analizojë përfitime prej aktiviteteve të organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Propozon lloje të ndryshme të iniciativave për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi.



Materiale të nevojshme:

Fletë pune 3.4, letër, laps kimik.



Metoda, teknika, forma:


Punë në grupe, diskutim, analizë e problemeve reale.



Pjesë hyrëse e orës

(5 min.)

Nxënësit përkujtohen në rolin aktiv të qytetarit në shoqëri, mundësinë për të vepruar në mënyra të ndryshme dhe përmes formave të ndryshme me qëllim që të përmirësohet jeta në bashkësi. Në bazë të kësaj mësimdhënësi u jep aktivitetet përmes të cilit do të bëhen të vetëdijshëm për nevojat në kuadër të shkollës dhe bashkësisë lokale për një aksion të caktuar ose projekt vullnetar. Në këtë mënyrë nxënësit nisen nga vetvetja, përjetimi i përditshmërisë në shkollë dhe bashkësinë lokale, dhe përmes bisedës së përbashkët për problemet që i vërejnë të jenë aktiv dhe të japin kontributin e tyre për zgjidhjen e atyre problemeve. Ndjenja e tyre si udhëheqës të ndryshimeve mund të jetë forcë shtytëse për ndërmarrjen e aksioneve dhe për t'i nxitur për përfshirjen e tyre të plotë.



Pjesa kryesore e orës

(30 min.)

Aktivitet **Planifikim i** **nisjes** **së nxënësve**

Nxënësit ndani në grupe me nga 5 nxënës dhe udhëhiqini përmes tre hapave si vijon:

- ➔ **Hapi 1** – Secili grup merr fletë pune numër 3.4 dhe detyrë për të biseduar se cilat probleme i kanë vërejtur në dhe rreth shkollës dhe çfarë do të donin të ndryshojnë. Përgjigjet duhet të shkruhen në rrethet e zbrazëta rreth rrethit - Shkollë.
- ➔ **Hapi 2** – Nxënësit e vendosin në hartë bashkësinë lokale (parqe, objekte sportive, qendra tregtare, organizata, etj.) në afërsi të shkollës dhe mendojnë se si do të mund të ndihmonin ato që të zgjidhet ndonjë problem, me kë mund të bashkëpunojnë.
- ➔ **Hapi 3** – Në tabelën ngjitni letër A4 në të cilën do të qëndrojë emri i shkollës, ndërsa rreth saj ngjiten fletë të tjera të zbrazëta në të cilat shënohen përgjigjet nga të gjitha grupet në raport me problemet, ndërsa fletë tjera dhe emrat e institucioneve në afërsi të shkollës.



Diskutim

Diskutohet për problemet dhe iniciativat nga ushtrimi i mësipërm. Mësimdhënës paraqitet në rolin e lehtësuesit që të jepet strukturë e mënyrës se si do të prezantohen nismat dhe gjithsesi të nxisë komente nga grupet tjera për një nismë të caktuar



Pjesa përfundimtare e orës

(5 min.)

Nxënësit duhet të zgjedhin nevojën për përfshirje aktive në jetën shoqërore. Mësimdhënësi është i obliguar t'ua bëjë të ditur nxënësve mundësitë që u qëndrojnë në dispozicion për ndërmarrjen e ndonjë aksioni, duke filluar në nivel të shkollës, ose në kuadër të bashkësisë lokale, po madje edhe në interes të opinionit të përgjithshëm.




Fletë pune 3.4

Mendoni për shkollën tuaj dhe bashkësinë lokale në afërsi të shkollës. Së pari mendoni se cilat probleme/nevoja i keni vërejtur në shkollë (hapësirë në shkollë dhe rreth saj, raportet mes nxënësve dhe mes tyre dhe mësimeve, dhuna bashkëmoshatare, etj.).

Më pas, ndiqni hapat për të përzgjedhur një problem/nejvojë dhe të zhvilloni plan të aktiviteteve për zgjidhjen e të njëjtit.

Hapi 1 – **Identifikim i problemeve/nejvojave/sfidave** (Identifikimin e nevojave / problemeve shënojeni në rrethet e zbrazëta)



Hapi 2 - **Vendosje në hartën e bashkësisë lokale** (parqe, objekte sportive, qendra tregtare, organizata, institucione, kompani, etj.) në afërsi të shkollës dhe si do të mund të ndihmonin që të zgjidhet ndonjëri prej problemeve, me kë mund të bashkëpunojnë.

➔ cilat institucione dhe organizata ekzistojnë në afërsi të shkollës?

.....

.....

.....

➔ cilat prej tyre mund t'ju jenë bashkëpunëtorë potencialë për zgjidhjen e një problemi të caktuar?

.....

.....

.....

Hapi 3 - **Ndërlidhje e nevojave me mundësitë** në bashkësinë lokale. Cilat prej problemeve të identifikuara mund të zgjidhen, duke marrë parasysh mundësitë në bashkësinë lokale (institucione, mjete, resurse njerëzore, etj.) ?

.....

.....

.....





Përmbajtja:



Bashkësia e
nxënësve
- nisma për
përmirësimin e
jetës në shkollë
dhe bashkësi

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të analizojë përfitimet nga aktivitetet e organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit.



Rezultate nga mësimi:

- ➔ Propozon lloje të ndryshme të iniciativave për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi.



Materiale të nevojshme:

Fletë pune 3.4 – pjesa 2, letër, stilograf.



Metoda, teknika, forma:

Diskutim në nivel të klasës, analizë e problemeve reale, zbatim i nismës së nxënësve.




Pjesa hyrëse e orës

(5 min.)

Pasi që në orën paraprake grupet identifikuan probleme/ nevoja/sfida, e vendosën në hartë bashkësinë lokale, definuam institucione dhe organizata të cilët mund t'ju jenë bashkëpunëtorë potencial dhe bëme ndërlidhjen e nevojave me mundësitë, gjegjësisht cilat prej problemeve të identifikuara mund të zgjidheni. Në këtë orë ata duhet të zgjedhin një problem/nevojë/sfidë dhe përmes procesit të njëjtë por, këtë herë të orientuara drejt zgjidhjes së problemit.

Mësimdhënësit i përfshinë në aktivitet, sërish, duke i bërë të ditura format dhe mënyrat e mundshme të organizimit dhe veprimit në bashkësi (vullnetarizëm, punë në shoqata të ndryshme të qytetarëve, organizata joqeveritare dhe qeveritare), veçanërisht duke u përqendruar në mundësitë që i kanë nxënësit përmes bashkimit në bashkësinë e nxënësve.



Pjesa kryesore e orës

(30 min.)

Në bazë të hapave të kaluara në orën paraprake, nxënësit duhet në nivel të gjithë klasës të vazhdojnë me realizimin e hapave si vijon:

➔ **Hapi 4 – Përzgjedhje të një problemi për zgjidhjen e të cilit nxënësit do të ngrisin nismë** - Kërkoni prej nxënësve të mendojnë se me cilën prej temave do të donin të përfshihen në projekt vullnetar. Vendosni në diskutim me nxënësit se çfarë është më e rëndësishme për të gjithë. Nëse ekzistojnë preferenca të ndryshme, nxënësit duhet t'i zgjedhin në mënyrë demokratike, përmes votimit (publik ose të fshehtë) dhe përmes diskutimit në bazë të argumenteve.

➔ **Hapi 5 – Përcaktim i mënyrës së ngritjes së nismës**

Nxënësit duhet të përgjigjen në pyetjet vijuese:

- ➔ Cili është ndryshimi që dëshironi ta arrini me nismën tuaj?
- ➔ Cilat përfitime do t'i keni nga realizimi i nismës?
- ➔ Në cilin afat kohor planifikoni ta realizoni nismën tuaj?
- ➔ Kush do të mund të ndihmonte? Si?
- ➔ Cilat janë problemet e mundshme në të cilat do të mund të hasnit? Si planifikoni t'i tejkaloni?

➔ **Hapi 6 – Prezantim dhe përfaqësim i idesë** - Nxënësit merren vesh që t'i prezantojnë idetë e tyre para drejtorit dhe të organizojnë takim me kryetarin e komunës për të marrë mbështetjen e duhur për realizimin e idesë.

➔ **Hapi 7 – Ndërmarrje të aksionit** – Nxënësit bëjnë plan se çfarë mund të ndërmarrin vetë për zgjidhjen e problemit dhe merren vesh se kur dhe në çfarë mënyre do ta zbatojnë aksionin.



Pjesa përfundimtare e orës

(10 min.)

Pas përfundimit të aktivitetit, tentoni që nxënësit t'i krahasojnë dhe t'i ndajnë perspektivat e tyre të ndryshme dhe të përgjigjen në pyetjet si vijon:

- ➔ Si u zhvillua aktiviteti? Çfarë ishte e thjeshtë, e çfarë sfidë? A kishte befasi të papritura gjatë aktivitetit, qoftë pozitive ose negative? Nëse është kështu, sa mirë jeni përballur me to?
- ➔ Çfarë pritjesh keni lidhur me aksionin tuaj?

Pas zbatimit të aksionit:

- ➔ Çfarë ndryshuat me aksionin tuaj?
- ➔ Sa konsideroni se ishit të suksesshëm në qëllimin tuaj?
- ➔ A do të kishit ndryshuar diçka në të ardhmen?
- ➔ Çfarë mund të ndërmerrni më tutje?



Fletë pune 3.4 (pjesa e dytë)

Vazhdon me aktivitetin nga ora e kaluar. Grupet e njëjta të nxënësve përzgjedhin një problem/ nevojë/ sfidë për të cilin ngrisin nismë.

Hapi 4 – **Përzgjedhje e një problemi** për zgjidhjen e të cilit nxënësit do të donin të ngritin nismë.

Hapi 5 – **Përcaktim i mënyrës së ngritjes së nismës** për zgjidhjen e problemit. Në kuadër të grupit, përgjigjuni në pyetjet vijuese:

➔ Cili është ndryshimi që dëshironi ta arrini me aksionin/nismën tuaj?
Cilat përfitime do t'i keni nga realizimi i nismës?

➔ Në cilin afat kohor planifikoni të realizoni aksionin/nismën tuaj?

➔ Kush janë gjithë ata që duhet të përfshihen në realizimin e nismës dhe në çfarë mënyre?

➔ Cilat janë problemet e mundshme në të cilat do të mund të hasnit? Si planifikoni t'i tejkaloni?

Hapi 6 – **Prezantim i idesë** para kryesisë së shkollës (dhe/ose komunës) me qëllim të-
përfaqësimit të idesë dhe sigurimit të mbështetjes së nevojshme për realizim.

Në çfarë mënyre planifikoni t'i rrekeni prezantimit të idesë para palëve të tjera të interesuara?
Si do t'i bindni që t'ju bashkëngjiten/t'ju japin mbështetje?



Tema

4

**KULTURA,
IDENTITETI
KULTUROR,
RELIGJIONI
DHE MEDIAT
SOCIALE.**

Përmbajtja:



Kultura dhe
identiteti
kulturor

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ T'i kuptojë ndikimin, funksionet dhe kulturën në bashkësi.
- ➔ T'i sqarojë elementet që e përbëjnë identitetin kulturor.



Rezultate nga nxënia:

- ➔ Hulumton dhe prezanton kultura të ndryshme nga mjedisi i tij.
- ➔ Përkufizon kuptimin e identitetit kulturor përmes shembullit konkret.




Materiale të nevojshme:

Fletë pune 4.1, letër, stilograf, tabelë



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë në grupe (hulumtim)




Aktivitet hyrës

(5-10 min.)

Duke përdorur teknikën e grumbullit, niset diskutimi lidhur me atë se çfarë nënkuptojnë nxënësit me nocionet kulturë dhe identitet kulturor. Me këtë rast nxiten nxënësit që t'i shqyrtojnë nocionet në kuptimin më të gjerë – si mënyrë e jetës. Diskutohet sipas pyetjeve në vijim:

- 1 A ju kujtohet se çfarë do të thotë nocioni identitet?
- 2 Çfarë, sipas jush, paraqet identiteti kulturor i njeriut?
- 3 Cilët faktorë ndikojnë në zhvillimin e kulturës?
- 4 A mund të përmendni disa karakteristika specifike të një kulture të caktuar në bashkësinë tuaj?



Pjesa kryesore e orës

(20-30 min.)

Në bazë të diskutimit mësimdhënësi jep sqarim të nocioneve kulturë dhe identitetit kulturor (kuptimi, ndikimi, funksionet dhe karakteristikat e kulturës dhe i sqaron elementet që e përbëjnë identitetin kulturor)

Kultura paraqet karakteristika të përbashkëta të një grupi të njerëzve, të cilët përfshijnë: vendin e lindjes, religjionin, gjuhën, kuzhinën kombëtare, sjelljen, artin, literaturën, muzikën, etj. Disa kultura janë shumë të përhapura dhe ka numër të madh të njerëzve që identifikohen me disa vlera të caktuara, besime dhe prejardhje. Kulturat tjera janë më të vogla. Por, vlera e kulturës nuk mund të përcaktohet nga madhësia e saj. Pa marrë parasysh nëse një kulturë e caktuar është shumë e përhapur ose është karakteristike vetëm për një rajon të caktuar më të vogël, nëse është e re ose, nga ana tjetër, ekziston me shekuj, nëse ka ndryshuar me kalimin e kohës ose ka mbetur e njëjtë, secila kulturë është e vlefshme dhe mund të mësohet për vetveten, për të tjerët dhe për bashkësinë tonë.

Besimet dhe praktiket themelore kulturore që në të shumtën e rasteve ndërliken me cilindo grup të caktuar, vazhdimisht ndryshohen dhe zhvillohen me kalimin e kohës. Megjithatë, mund të nxirren dallime mes aspekteve materiale, shoqërore dhe subjektive të kulturës, gjegjësisht mes **resurseve materiale** që zakonisht përdoren nga pjesëtarët e një grupi kulturor (për shembull, veglat, ushqimi, veshja, etj.), **karakteristikat shoqërore** të grupit (për shembull, gjuha, komunikimi, folklori, religjioni, etj.), si dhe besime, vlera dhe praktika **subjektive** të anëtarëve të grupit.

Kultura përbëhet prej të tri aspekteve. Megjithatë, një pjesëtar i një kulture të caktuar nuk është e thënë të identifikohet me të gjitha karakteristikat e saj, por mund të pranojë disa aspekte të caktuara të kulturës. Në këtë mënyrë, secili mund të formojë identitetin e tij personal kulturor që është i ndërlihur me përkatësinë e më shumë grupeve shoqërore. Grupe të tilla shoqërore janë: grupet nacionale, grupet etnike, grupet fetare, grupet gjuhësore, grupet profesionale, grupet e gjeneratave, grupet familjare, etj. Çdo individ u takon më shumë grupeve dhe prandaj ka më shumë lidhje dhe identitete kulturore (për shembull, nacional, fetar, gjuhësor, të gjeneratave, familjar, etj.)

Identiteti kulturor rezulton nga prejardhja e përbashkët që mbijeton në bazë të gjuhës, religjionit, zakoneve, etnosit.

Aktivitet:

Nxënësit ndahen në katër grupe me detyrë që të përpilojnë një projekt në temën: Kulturat në bashkësinë time. Gjatë ndarjes së grupeve dhe delegimit të detyrave mësimdhënësi udhëhiqet sipas parimeve të kooperimit dhe kolaborimit të grupit. Kjo do të thotë se në çdo grup ka nxënës me të arritura të larta, mesatare dhe të dobëta dhe secili anëtar i grupit merr detyrë konkrete.

- ➔ **Grupi i parë** i hulumton dhe paraqet shprehitë kulturore (religjioze, ushqim, veshje, përshëndetje...) e tri bashkësive etnike në komunën/shtetin¹, sipas zgjedhjes së nxënësve;
- ➔ **Grupi i dytë** i hulumton dhe paraqet elementet e përbashkëta në normat morale (rregullat etike të sjelljes) e tri bashkësive etnike në komunën/shtetin, sipas zgjedhjes së nxënësve;
- ➔ **Grupi i tretë** i hulumton dhe paraqet zakonet (pagëzimet, kurorëzimet, festat) e tri bashkësive etnike në komunën/shtetin, sipas zgjedhjes së nxënësve;
- ➔ **Grupi i katërt** ka për detyrë të paraqesë identitetet kulturore përmes shembujve konkret dhe elementeve të tyre përbërëse.

¹ Nëse ka interes nga nxënësit, detyra mund të ndërlidhet me bashkësitë jera etnike, jashtë shtetit (nga Ballkani, Evropa ose më gjerë)

Gjatë realizimit të detyrës, grupet mund të përdorin letërsi sipas zgjedhjes të treguar nga mësimdhënësi ose, nga ana tjetër, të bëjnë intervistë të strukturuar me përfaqësues të kulturave të ndryshme (Fletë pune 4.1: Propozim pyetje për intervistë me anëtarë më të rritur të bashkësisë). Mënyra në të cilën do të bëjnë raportin e hulumtimit (afishe, prezantim, libër...) varet nga marrëveshja me grupin. Afati për përpilimin e detyrës është një javë, ndërsa fillon në orë menjëherë pas formimit të grupeve dhe ndarjen e udhëzimeve për punë.

Nxënësit, në kuadër të grupit bëjnë plan për hulumtim dhe për përgatitjen e prezantimit që ka të bëjë me detyrat, kohën, resurset dhe mënyrën e prezantimit. Së bashku njoftohen me instrumentet e notimit të hulumtimit dhe prezantimit (listë e pikëve dhe listë kontrolluese).



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5-10 min.)

Për reflektimin e aktivitetit përdoren planet e projektit të grupeve, pyetje për intervistë, por edhe diskutimi përmes pyetjeve vijuese:

- ➔ Çfarë keni ditur për këtë temë para orës së sotme?
- ➔ Për cilat gjëra i përmirësuar dituritë/shkathtësitë tuaja?
- ➔ Çfarë ju ndihmoi që të mësoni më mirë/të përvetësoni shkathtësi më të mira?

Mësimdhënësi i kontrollon planet e nxënësve dhe jep informacion kthyes dhe udhëzime për realizimin e aktivitetit të projektit dhe çfarë nga kjo është detyrë shtëpie.



Fletë pune 4.1

Propozim-pyetësor për intervistë (identitet kulturor)

1 Si e përshkruani identitetin Tuaj kulturor?

(Pyetje për nxitje: Cila këngë/rrëfim/ ushqim tradicional ju është i preferuar?, Cilën gjuhë e konsideroni amtare dhe cilat fjalë prej saj ju janë të preferuara?, Nëse jeni religjioz, cilat tradita religjioze i praktikoni?, Çfarë zakonesh praktikoni në kuadër të familjes? Me cilat karakteristika të bashkësisë tuaj etnike më së shumti identifikoheni?)
(Presim përgjigje në drejtim të prejardhjes, gjuhës, religjionit, zakoneve ose përkatësisë etnike)

2 Çfarë ka ndikuar më së shumti në formimin e identitetit tuaj kulturor?

(Pyetje për nxitje: Radhitini sipas rëndësisë ndikimin e: gjuhës, religjionit, zakoneve, përkatësisë etnike, etj.)?
(Presim që të bëhet i ditur ndonjëri prej elementeve të përmendura paraprakisht)

3 Cilin aspekt të identitetit tuaj kulturor i kushtoni rëndësinë më të madhe? Pse?

(Presim përgjigje të ndryshme varësisht nga të intervistuarit)

4 Cilat janë stereotipat më të shpeshtë për kulturën tuaj që i njihni? Me cilat prej tyre nuk identifikoheni?

(Presim përgjigje të ndryshme varësisht nga të intervistuarit)

5 Çfarë mendoni për ndikimin e globalizimit në ndërtimin e identitetit kulturor të njerëzve? Sa është pozitiv ndikimi i globalizimit, e sa negativ? Pse?

(Presim mendime të ndryshme, për dhe kundër globalizimit dhe argumente që do të mbështesin këtë mendim)

6 Çfarë mendoni, sa ndikon identiteti qytetar në uljen e rëndësisë së identitetit kulturor të qytetarëve në shoqëri?

(Presim mendime të ndryshme që lëvizin nga ajo se identiteti qytetar e ulë rëndësinë e identitetit kulturor, deri te ajo se e nxit shprehjen e lirë të identitetit kulturor)



Përmbajtja:



Kultura dhe
identiteti
kulturor

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ T'i kuptojë ndikimin, funksionet dhe kulturën në bashkësinë e tij/saj.
- ➔ T'i sqarojë elementet që e përbëjnë identitetin kulturor.



Rezultate nga nxënia:

- ➔ Hulumton dhe prezanton kultura të ndryshme nga mjedisi i tij/saj.
- ➔ Përkufizon nocionin identitet kulturor përmes shembullit konkret.




Materiale të nevojshme:

Fletë pune 4.2 dhe 4.3, letër, stilograf, tabela



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, prezantim, notim moshatar



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Ora fillon me diskutim të shkurtër me nxënësit për rezultatet e hulumtimit, produktet, sfidat dhe vështirësitë me të cilat janë përballur gjatë realizimit të detyrës.

- 1** Në çfarë mënyre i morët informacionet e nevojshme?
- 2** A keni pasur ndonjë lloj sfidash në punë?
- 3** Si u përballët me to?



Pjesa kryesore e orës

(20-30 min.)

Mësimdhënësi u ndan fletë me pikë për notimin e hulumtimit dhe lista kontrolluese për prezantim gojor (Fletë pune 4.2 dhe Fletë pune 4.3). Grupet kanë nga pesë minuta për prezantimin e rezultateve nga hulumtimi. Derisa një grup prezanton, të tjerët e notojnë prezantimin duke i përdorur instrumentet e përmendura për notim. Pas çdo prezantimi zhvillohet diskutim dhe grupet shprehen mes vete lidhur me atë se si e kanë vlerësuar hulumtimin në raport me listën e pikëve dhe mënyrën e prezantimit në raport me fletën kontrolluese. Mësimdhënësi jep informacion kthyes për anët e mira dhe dobësitë dhe ofron udhëzime për përmirësim.



Diskutim

Mësimdhënësi nxit diskutim përmes pyetjeve si vijon:

- 1) Çfarë mësuat për kulturat në shtetin/komunën tuaj? Cilat gjëra janë të ngjashme, e cilat janë të ndryshme mes kulturave që i hulumtoni? (Nxënësit mund t'i prezantojnë edhe përmes Diagramit të Venit)
- 2) Çfarë ju ishte më vështirë gjatë përcaktimit të karakteristikave të kulturës dhe identitetit kulturor?
- 3) Sa ju janë qartësuar mënyrat në të cilat ndërtohet identiteti kulturor dhe cilët faktorë ndikojnë?
- 4) Pse është me rëndësi t'i njohim kulturat e ndryshme në vendin tonë?
- 5) Çfarë do të donit të mësoni në mënyrë plotësuese?



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Në bazë të diskutimit paraprak, mësime dhënësi i nxitë nxënësit të nxjerrin konstatim për procesin e punës dhe përfitimet nga realizimi i projektit në raport me kulturën dhe identitetin kulturor.

(Përgjigje të pritura: Shtetin tonë e përbëjnë shumë kultura; secila kulturë ka specifikat e saj, elementet, karakteristikat; kulturat ndikojnë në ndërtimin e identitetit kulturor të individit, por edhe në mënyrë se si ata ndikojnë në njëri-tjetrin).

Reflektimi dhe vlerësimi i gjithë procesit bëhet me ndihmën e instrumenteve të notimit (me pika dhe fletë kontrolluese) dhe në bazë të tyre mësime dhënësi jep informacion kthyes gojor në të cilin i thekson anët e fuqishme të secilit grup dhe bën të ditur në atë se për të përparuar duhet të fokusohen në hulumtimet dhe prezantimet e ardhshme.



Fletë pune 4.2

LISTË E PIKËVE PËR NOTIMIN E HULUMTIMIT

Pikë / Nxënës	GRUPI I	GRUPI II	GRUPI III	GRUPI IV
4 pikë Janë zbatuar me sukses shumë teknika hulumtuese. Të dhënat janë relevante, ndërsa hulumtimi është kreativ dhe origjinal.				
3 pikë Janë zbatuar disa teknika hulumtuese dhe janë përdorur burime relevante, por hulumtimi nuk është kreativ dhe origjinal.				
2 pikë Janë zbatuar teknika hulumtuese, por ka probleme në ilustrimin e asaj që është hulumtuar.				
1 pikë Ka vështirësi në zbatimin e procedurave hulumtuese, fondi i të dhënave është minimal.				
0 pikë Nuk është treguar aftësi për hulumtim, grumbullimin e të dhënave dhe për ilustrimin e asaj që është hulumtuar.				



Fletë pune 4.3

LISTË KONTROLLUESE PËR NOTIMIN E PREZANTIMIT GOJOR

NXËNËS PREZANTUES	Përbajtja e prezantimit përkon me detyrën e dhënë	Prezantimi është gjithëpërfshirës	Prezantuesi nuk e lexon vetëm atë që është e shkruar por e sqaron me fjalët e tij	Prezantuesi është i sigurt në diturinë e tij dhe tregon shkathësi prezantuese	Prezantuesi u përgjigjet nënpyetjeve nga nxënësit dhe mësimdhënësi	Prezantuesi respekton kornizën kohore
GRUPI I						
GRUPI II						
GRUPI III						
GRUPI IV						



Përmbajtja:



Roli i religjionit
në shoqërinë
qytetare



Qëllime të orës mësimore:

- Të kuptojë procesin e shekullarizimit të shteteve .
- Të sqarojë rolin e religjionit në shoqërinë bashkëkohore..



Rezultate nga nxënia:

- Dallon dhe përkufizon nocionet: shekullarizim dhe ateizëm.
- Identifikon vlerat nga religjionet që promovojnë vlera të përgjithshme njerëzore.
- Prezanton shembuj pozitiv të tolerancës ndaj tjetrit në aspektin religjioz dhe ateistëve.




Materiale të nevojshme:

Letër, stilograf



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë në grupe,



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Mësimdhënësi paraqet një situatë për të menduar para gjithë klasës

„Paramendoni një botë në të cilën nuk ekzistojnë religjione. Si do të sillen njerëzit? Si do të funksionojnë shtetet? Çfarë do të jetë mirë, e çfarë keq?“

Pritet të zhvillohet diskutim në të cilin do të theksohen funksionet e ndryshme të religjionit.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 2 grupe dhe e paraqet Fletën e punës 4.4. Njëri grup duhet të mendojë dhe të përmendë tri argumente pse religjioni është i nevojshëm në shoqërinë bashkëkohore, ndërsa tjetri të mendojë dhe të përmendë tri argumente pse religjioni nuk është i nevojshëm në shoqërinë bashkëkohore. Si pyetje për udhëzimin e nxënësve, mësimdhënësi mund t'i përdorë si vijon:

- Si është roli i religjionit në shoqërinë bashkëkohore?
- Në çfarë korrelacioni janë religjioni dhe shteti në shoqërinë qytetare?
- Cilat vlera i promovojnë religjionet, ndërsa i konsiderojmë si vlera të përgjithshme njerëzore?
- Cilat janë kërcënimet potenciale të religjionit sot?

Nxënësit punojnë në mënyrë të mëvetësishme, ndërsa mësimdhënësi ndihmon me udhëzime nëse vërehet se nxënësit kanë vështirësi në zhvillimin e argumenteve.

[Argumente potenciale që mund t'i zhvillojnë nxënësit janë:

Religjioni është i nevojshëm në shoqërinë bashkëkohore për shkak se:

- 1) Ofron norma morale për funksionimin e njerëzve dhe shoqërisë
- 2) Përmes zakoneve religjioze njerëzit ndërlidhen dhe ndihmohen
- 3) Ofron strehim në situata kur njerëzit përballen me kriza (personale ose shoqërore)

Religjioni nuk është i nevojshëm në shoqërinë bashkëkohore për shkak se:

- 1) Nuk do të ekzistojë diskriminim i njerëzve sipas përkatësisë religjioze
- 2) Nuk do të ketë lufta/konflikte që janë të nxitura nga religjioni (ekstremizëm i dhunshëm)
- 3) Njerëzit do të jetojnë më lirshëm dhe vetë do të mund të përcaktojnë se cila sjellje është e moralshme/etike.]

Në bazë të ideve të nxënësve, mësimdhënësi nxjerrë konstatim për rolin e religjionit në shoqëri, por edhe domosdoshmërinë e shekullarizimit të shoqërive bashkëkohore. Sqarohen nocionet shekullarizim dhe ateizëm në raport me rëndësinë e tyre në shoqëri

Shekullarizmi është besim se njeriu mund të jetojë dhe të kuptojë botën, pa pasur nevojë për besim në fuqi mbinatyrore ose perëndi. Në shoqëritë shekullore religjioni (ose mungesa e religjionit) është çështje private, që nuk duhet të ketë ndikim në vendimet politike dhe mënyrën e funksionimit të shtetit. Kjo do të thotë se institucionet joqeveritare dhe individët e përcaktuar që të përfaqësojnë shtetin janë të ndarë nga institucionet religjioze dhe personat religjiozë. Pra, veprimet dhe vendimet e njeriut, veçanërisht ato politike, nuk do të duhej të bien nën ndikimin e religjionit.

Shekullarizmi nënkupton se secili ka lirinë të jetë ose të mos jetë pjesëtar i një religjioni të caktuar, dhe ka të drejtën të jetë i liruar nga sundimi dhe mësimi religjioz, si dhe të drejtën e liritimit nga imponimi i religjionit të njerëzit nga ana e shtetit. Autoritetet shtetërore duhet të jenë neutrale në raport me çështjet që kanë të bëjnë me religjionin.

Sot çdo shtet modern evropian është shekullar. Edhe Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet shekullar, sipas Kushtetutës.

Ateizëm, në kuptimin më të gjerë, është refuzimi i besimit në ekzistimin e perëndive. Në kuptimin më të ngushtë, ateizëm është qëndrimi se nuk ekzistojnë perëndi. Ateizëm është e kundërta e teizmit, që nga ana tjetër, në formën e tij të përgjithshme është besim se ekziston së paku një perëndi.



Diskutim

- 1) Çfarë mendoni, pse nevojitet toleranca ndaj tjetrit në aspektin e religjionit?
- 2) Vallë nëse njeriu nuk i takon asnjë religjioni humb një pjesë të identitetit të tij kulturor?
- 3) Çfarë mendoni, pse nevojitet shekullarizim i shoqërisë?
- 4) Në bazë të diskutimit paraprak, mësimdhënësi i nxitë nxënësit që të nxjerrin konstatime që shkojnë në drejtim të kuptimit të nocioneve; potencohet nevoja për shekullarizim të shoqërisë bashkëkohore dhe tolerancës ndaj tjetrit në aspektin e religjionit ose ateistit.



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi i parashtron pyetjet si vijon:

- ➔ Çfarë keni ditur për këtë temë para orës së sotme? Çfarë mësuat të re?
- ➔ Cili aktivitet ju ishte më interesant dhe pse?
- ➔ Çfarë ju ndihmoi që të mësoni më mirë /të përvetësoni shkathtësi më të mira?



Fletë pune 4.4

Teza 1.

Religjioni nevojitet në shoqërinë bashkëkohore për shkak se:

1.
2.
3.

Teza 2.

Religjioni nuk nevojitet në shoqërinë bashkëkohore për shkak se:

1.
2.
3.



Përmbajtja:



Ndikimi i
mediave
sociale mbi
qytetarët

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- Të ndërtojë raport të përgjegjshëm në përdorimin e mediave sociale.



Rezultate nga nxënia:

- Analizon në mënyrë kritike përdorimin e papërgjegjshëm të rrjeteve sociale (sajber-dhunë).




Materiale të nevojshme:

Fletë pune 4.5 dhe 4.6



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë në grupe, vetëvlerësim



Aktivitet hyrës

(5 min.)

Orën filloni me pyetje në mënyrë që t'i futni nxënësit në temën sajber-dhunë (virtuale).

- A keni profil në rrjetet sociale?
- Pse e krijuat atë profil?
- Çfarë bëni në rrjetet sociale?
- A jeni ndjerë ndonjëherë në mënyrë të pakëndshme si përdorues?



Pjesë kryesore e orës

(30 min.)

Ndani nxënësit në grupe më të vogla, ndërsa secili grup mund të ketë detyrë të njëjtë – t'i përmendë anët e mira dhe të këqija të mediave (rrjeteve) sociale. Çdo grupi ia jepni pjesën e parë të *Fletës së punës 4.5*. Qëllimi i kësaj detyre është që nxënësit të kuptojnë se rrjetet sociale mund të jenë argëtuese, por njëherësh edhe shumë të rrezikshme. Në fletët e punës nxënësit le të shkruajnë shembujt e tyre. Më pas njëri prej secilit grup le të prezantojë, ndërsa ju nxirrni konstatim nga prezantimet e tyre.

Aktiviteti i radhës është diskutimi se si e shikojnë ata dhunën përmes mediave sociale. Kjo detyrë është shumë e rëndësishme meqë fëmijët shpesh nuk e dinë nëse janë dhe se mund të jenë viktimë të dhunës virtuale.

Pyetjet vijuese mund t'ju ndihmojnë në diskutimin me nxënësit:

- Tani kur i dëgjojmë anët e mira dhe të këqija të mediave sociale, a janë disa prej tyre të lidhura me sjellje të dhunshme?
- Përmendmi forma të dhunës përmes mediave sociale!
- A njihni dikë (të mos përdoren emra për shembujt) që ka qenë viktimë e dhunës përmes mediave sociale?

Pas kësaj në secilin grup shpërndani pjesën e dytë të *Fletës së punës 4.5*. Në këtë detyrë është me rëndësi që për secilin propozim të bisedoni me nxënësit dhe ta sqaroni në mënyrë të hollësishme. Për shembull, në Fejsbuk në çdo album dhe fotografi mund të përcaktoni nëse do të jetë e dukshme – më saktësisht të përcaktoni se kush mund të ketë qasje deri te një fotografi e caktuar e juaja. Nëse nxënësit kanë edhe ide të tjera për mbrojtje nga rreziku le të sqarojnë se si mund të bëhet kjo.

Mësimdhënësi bën rezymë:

Dhunë (bullying) është ofendim i vazhdueshëm, i qëllimshëm i një individi ose grupi nga një person tjetër ose grup njerëzish. Kjo mund të ndodhë sy më sy ose përmes sajber hapësirës. Sajber-dhuna paraqet keqpërdorim të mediave digjitale (si ueb faqet, rrjetet sociale, aplikacionet celulare dhe porositë tekstuale) për frikësim, shqetësim, maltretim, imitim, mashtrim, publikim të thashethemeve, kërcënimeve, të dhënave personale të viktimave, përhapje të gjuhës së urrejtjes ose për t'i shkaktuar dëm dikujt.

Sajber-dhuna më e shpeshtë është e orientuar drejt përdorimit të komunikimit elektronik në kontekst negativ të racës, religjionit, përkatësisë etnike, statusit social, orientimit seksual, karakteristikës fizike ose mentale, identitetit gjinor dhe karakteristikat tjera personale të dikujt.

Kjo do të mund të ndodhte përmes “telefonit të mençur”, kompjuterit, laptopit, tabletës ose platformës onlajn për lojë. Mund të zbatohet përmes një numri të madh të shërbimeve onlajn ose celulare, siç janë e-posta, ueb faqet për rrjetëzim social, aplikacionet për shkëmbimin e porosive tekstuale dhe vizuale, shërbime për shkëmbimin e fotografive ose të bisedës, ueb-kamera, aplikacione për nxënie vizuale dhe lojëra onlajn. Sot është lehtë të krijohet profil në Fejsbuk, Instagram, Snepçet, ose ueb-sajt dhe bllog deri te i cili do të kenë qasje të gjithë.

Sajber-dhuna dallon nga dhuna sy më sy në disa mënyra kyçe. Sajber-dhuna mund të ndodhë në çdo kohë dhe në çfarëdo vendi. Gjithashtu, është më vështirë të zbulohet, meqë sajber-dhunuesit në të shumtën e rasteve përdorin pseudonime dhe profile të rrejshme përmes të cilave ushtrojnë dhunë ndaj përdoruesve të tjerë të internetit. Në mënyrë plotësuese, sajber-dhuna gjithashtu mund të jetë shumë publike – një numër i madh i njerëzve në internet mund të shohin se çfarë ndodhë.

Karakteristika sipas të cilave sajber- dhuna dallon nga dhuna sy më sy:

- ➔ Dhunuesi mund të përdorë profile anonime virtuale;
- ➔ Mund të ndodhë në çdo kohë dhe vështirë evitohet;
- ➔ Mund të depërtojë deri te një numër i madh i njerëzve – përmbajtja e shpërndarë në ndonjë grup ose e vendosur në platforma publike.

Sajber-dhuna mund të paraqitet në forma të ndryshme:

- ➔ **shqetësim** – dërgim konstant i porosive ofenduese, shqetësuese e të vrazhda dhe materialeve pornografike;
- ➔ **imitim / shtirje** – depërtim në llogari të huaja të përdoruesve dhe dërgimin e porosive të rrejshme, të turpshme në emër të huaj;

- ➔ **nënçmim – shkrimin** e thashethemeve ose deklaratave të tjera të pasakta që mund t'i shkaktojnë dëm viktimës, si dhe fotografi me përmbajtje nënçmuese dhe informacione të turpshme personale dhe dërgimin ose publikimin e tyre në internet;
- ➔ **mashttrim dhe shpalosje publike** – shpërndarja e informacioneve të huaja personale ose mashttrimin e dikujt për t'i shpërndarë fshehtësitë e tij në mënyrë që t'ua ridërgojë të tjerëve;
- ➔ **drejtim vulgar** – dërgim i porosive me përmbajtje vulgare;

Zakonisht, krahas dhunës dhe viktimës, në sajber-dhunën paraqiten edhe njerëz të tjerë që e dëshmojnë të njëjtën, ndërsa një individ i caktuar mund të jetë në rolin e:

- ➔ **Vëzhguesit** vëren konflikt ose sjellje të papranueshme, por nuk merr pjesë në të dhe nuk ndërmer kurrfarë aksioni në raport me atë.
- ➔ **Aleat** ai që reagon ndaj situatës së dhunës përmes mbështetjes së personit që është keqtrajtuar (përmes mbështetjes morale, këshillimit, ndërmarrjes së aksioneve të përbashkëta me viktimën).
- ➔ **Kundërshtues (mbrojtës)** që ndërmer iniciativa në mënyrë aktive në zgjidhjen e rasteve me sajber-dhunën.

Sajber-dhuna mund të ketë pasoja serioze. Viktimat ndjejnë: vetëbesim të zvogëluar, pasiguri, frikë, depresion, shqetësim, pikëllim, pagjumësi, dëshirë të zvogëluar për ushqim, sjellje të zvogëluar dhe sukses në shkollë, agresivitet, mendime negative për vetëlëndim dhe ngjashëm.



Diskutim

Mësimdhënësi e vendos deklaratën e radhës dhe nxitë nxënësit të mendojnë:

Shoku/qja yt/e poston në Fejsbuk: "Ndjem e pikëlluar (emotikon)... pse njerëzit thjesht nuk më lënë rehat?"

Si do të kishit reaguar ndaj postimit të shokut/qes? Mendoni për:

- Si do të ishte reagimi juaj i parë pasi të lexoni këtë?
- Cilët fjalë të tjera do t'i kishit përdorur për t'i përshkruar emocionet e shokut/qes tuaj?
- Pse mendoni se shoku/qja juaj e ka publikuar këtë?
- Si do ta kishit mbështetur shokun tuaj? (Në mënyrë verbale me kontakt sy më sy, diskutim onlajn, etj)
- A do të kishit përfshirë njerëz të tjerë, siç janë familja ose miqtë?

Lexohen të gjitha rekomandimet ose ngjiten si letër flipçart në klasë:

SI TË PARANDALOHET SAJBER-DHUNA?

- ➔ Nëse të dhënat tuaja personale janë keqpërdorur në internet, mund ta denoncosh rastin në Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale (www.dzlp.mk).
- ➔ Për raste të rënda të sajber-dhunës, që përfshijnë kërcënime, mund t'i drejtohesh policisë bashkë me prindërit e tu.
- ➔ Denoncoi keqpërdorimet në ueb-faqet dhe rrjetet sociale përmes opsioneve përkatëse ose duke iu drejtuar drejtpërdrejt administratorit.
- ➔ Mos i zbuloj të dhënat tuaja personale në internet.
- ➔ Mos i trego fjalëkalimet tuaja.
- ➔ Mos iu kundërpërgjigj porosive të dhunshme, vetëm ruaj si dëshmi.
- ➔ Mos çel porosi prej dërguesve të panjohur ose prej fëmijëve për të cilët e di se janë dhunues.
- ➔ Mos publiko në internet diçka që nuk do të doje ta dijë gjithë klasa.
- ➔ Mos dërgo porosi kur je i/e hidhëruar.
- ➔ Mos iu bashkëngjit sajber-dhunës. Nëse e vëren, denoncoje te ndonjë i rritur.

Konstatim

Sot, dhuna virtuale është problem real që bën pjesë në grupin e sajber-kriminit bashkë me sajber-krimin ekonomik (për shembull, me kartela kreditore).

Në rast se je viktimë e sajber-dhunës, mos hesht dhe mos u tërhiq në vetvete. Tregoju prindërve, ose dikujt që i beson së bashku do të gjeni zgjidhje!



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min)

Nxënësit e marrin *Fletën e punës 4.6* dhe duhet të shënojnë se çfarë kanë ditur paraprakisht (shënojnë me √), e çfarë të reje kanë mësuar gjatë orës (shënojnë me +).



Fletë pune 4.5

Ushtrimi pjesa 1

Përmendini anët **e mira**
të mediave sociale:

Përmendini anët **e këqija** të
mediave sociale:

Ushtrimi pjesa 2

Mendoni për mënyrat në të cilat mund të zvogëlohen anët e përmendura të këqija të mediave sociale dhe si mund të mbroheni nga dhuna në rrjetet sociale.



Fletë pune 4.6

Në tabelat vijuese, shëno me \checkmark nëse informacionin e di prej më përpara, ndërsa me + nëse e ke mësuar gjatë orës

Sajber-dhuna mund të nënkuptojë si vijon:

Porosi me përmbajtje të pahijshme	
Shkrim i komenteve ose publikim i fotografive me përmbajtje ofenduese	
Shtirje se jeni dikush tjetër përmes internetit	
Shënim të fotografive të tjera joadekuata në rrjetet sociale	
Diskutime të pahijshme	

Si të dallojmë sajber-dhunën

Çfarë mund të bëni nëse jeni viktimë e një lloji të këtillë të dhunës dhe si të veproni nëse vërejmë dhunë ndaj bashkënxënësve:

Fillimisht të kesh kujdes kur vendos çfarëdo përmbajtje në internet (në këtë mënyrë secila përmbajtje bëhet e përhershme dhe e humb pronësinë mbi të)	
Mos u hakmerr ose përgjigj	
Blokoje personin që të ka keqtrajtuar dhe ndryshoi qëndrimet për privatësi në rrjetet sociale	
Mblidh dëshmi – ruaji porositë në telefonin celular dhe porositë përmes e-postës ose bisedat në rrjetet sociale	
Bisedo me dikë që mund t'i besosh – anëtar i familjes, shok/qe, mësuesdhënës...	



Përmbajtja:



Ndikimi i
mediave
sociale mbi
qytetarët

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- Të analizojë ndikimin e mediave, propagandës mediatike në shoqërinë bashkëkohore;



Rezultate nga nxënia:

- Diskuton për nevojën e interpretimit kritik të mediave dhe propagandës mediatike
- Sqaron nocionet censurë dhe autocensurë




Materiale të nevojshme:

Fletë pune 4.7, stilograf



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë në grupe (analizë e rasteve)



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Mësimdhënësi paralajmëron anketë lidhur me çështjen, që e shënon në tabelë:

A ju ka ndodhur ndonjëherë të doni të “postoni” në profilin tuaj në rrjetet sociale, por keni ndryshuar mendjen?

Nxënësit duhet të përgjigjen në fleta me P0 ose J0 dhe fletët t’i dorëzojnë te mësimdhënësi (në kuti, enë), i cili i numëron përgjigjet.

Pritet që në mesin e përgjigjeve të ketë nxënës që janë përgjigjur me P0. Mësimdhënësi nxitë diskutim me pyetjet:


- ➔ Pse keni ndërruar mendjen?
- ➔ Sa ka ndikuar në vendimin tuaj mendimi – Çfarë do të thonë/Si do të reagojnë të tjerët?
- ➔ A ju ka ndodhur që dikujt tjetër t’ia bëni të ditur se nuk është dashur të “postojë” diçka (tekst/fotografi)?
- ➔ A keni dëgjuar për nocionet censurë dhe autocensurë?

Mësimdhënësi i shkruan fjalët në tabelë, ndërsa nxënësit duhet të tregojnë se si i kuptojnë dhe çfarë mendojnë kur do t’i dëgjojnë.

[Përgjigje potenciale:

Censurë – ndalesë për nxjerrjen e një qëndrimi të caktuar, ndalesë për veshje/sjellje në një mënyrë të caktuar, tregohet fuqi, përdoret për të mbrojtur një grup të caktuar, përdoret për të heshtur dikë, e kundërta e lirisë së fjalës, mund të jetë e ndërlidhur me propagandën, etj.

Autocensurë – vetë i ndalojmë diçka vetvetes për shkak të frikës /paqartësisë/pasigurisë, në mendje i kemi “të tjerët” dhe reagimin e tyre, etj.]



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Bëhet rezyme e kuptimeve të nocioneve: censurë, autocensurë, propagandë mediatike

Censurë është pengim që diçka të jetë e lexuar, e dëgjuar ose e shikuar. Nëse e keni dëgjuar tingullin “biiip” kur dikush ka folur në televizion, kjo është censurim. Të censurohet diçka, do të thotë të merret vendim që të largohen ose të fshihen disa pjesë (të tekstit, fotografisë) për të cilat konsiderohet se janë joadekuate.

Autocensurë është kur vetëpërmbahemi që të themi ose bëjmë diçka, ose nga ana tjetër i përzgjedhim gjërat që i themi/ bëjmë varësisht nga ajo se kush na dëgjon ose shikon.

Propagandë mediatike paraqet informacioni që përdoret për të ndikuar te një publik i caktuar ose për të promovuar interesa të caktuara. Informacionet zakonisht nuk janë tërësisht objektive dhe i prezantojnë faktet në mënyrë selektive, për të nxitur ndjenja të caktuara, perceptim ose të ndikojnë në qëndrime të caktuara te publiku. Informacioni shpeshherë është paraqitur në mënyrë emotive, përballë asaj racionale. Propaganda në të shumtën e rasteve ndërlidhet me materiale që janë të përgatitura prej qeverive, kompanive, grupeve të aktivistëve, organizatave religjioze, mediave, etj.

Aktivitet: Nxënësit ndahen në tri grupe dhe secili merr nga tri situatat e përshkruara në *Fletën e punës 4.7*. Në kuadër të grupit duhet të diskutojnë nëse konsiderojnë se në situatën e përshkruar bëhet fjalë për censurë dhe sa e arsyetojnë atë, gjegjësisht konsiderojnë se është e drejtë në kontekstin e dhënë.



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi i parashton pyetjet si vijon:

- Çfarë keni ditur për këtë temë para orës së sotme? Çfarë mësuat të re?
- Cili aktivitet ju ishte më interesant dhe pse?
- Çfarë ju ndihmoi që të mësoni më mirë/ të përvetësoni shkathtësi më të mira?



Fletë pune 4.7

Situata 1:

Filmi nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 16 vjeçe.

Në vitin 2016, "Kartunnetwork" (Cartoon Network) ndaloi emetimin e një episodi të filmit të animuar „Stiven Junivers” (Steven Universe), për një djalë të ri dhe familjen e tij prej grave-jashtëtokësore, për shkak të paraqitjes së lidhjes romantike të dy personazheve. Dashmirët e serialit nuk kanë qenë të kënaqur nga vendimi i tillë dhe kanë nisur peticion që ka mbledhur mbi 9000 nënshkrime. Autorët e serialit vendosin që episodin e ndaluar të vendosin në internet, që secili të mund ta shikojë.

Çfarë mendoni, a është kjo censurë?

Sa e arsyetoni ose nuk e arsyetoni hapin e këtillë? Sqaroni.

Situata 2:

Nuk publikojmë albume me tekste me përmbajtje ofenduese.

Asociacioni australian për produksion muzikor, ka të ashtuquajturin kod të praktikave që kanë të bëjnë me të gjitha grupet vendore dhe të huaja muzika e të cilave publikohet në vend. Në këtë sistem, niveli i parë i klasifikimit të albumeve muzikore nënkupton shenjë me paralajmërim për tekste eksplicite në këngët. Niveli i dytë shënon paralajmërim për atë se albumi nuk është përkatës për persona nën 18 vjeç, për shkak të përdorimit të vazhdueshëm të gjuhës së pahijshme dhe

dhunës. Niveli i tretë shënon materialin që mund të jetë ofendues për një pjesë të madhe të personave të moshuar dhe përfshin tekste që përshkruajnë lloje të ndryshme të sjelljes kriminale. Albumet e grupeve që bëjnë pjesë në grupin e tretë janë të ndaluara për shitje në Australi.

Çfarë mendoni, a është kjo censurë?

Sa e arsyetoni ose nuk e arsyetoni hapin e këtillë? Sqaroni.

Situata 3:

Teksti nuk do të botohet në formën origjinale.

Aleksi është gazetar në një gazetë lokale dhe për botimin e së shtunës përgatiti një tekst për grevën e punëtorëve të tekstilit në qytet, të cilët duhet doemos të punojnë gjatë fundjavave dhe festave. Kur ia dorëzoi tekstin redaktorit, ky i fundit i tha se teksti duhet doemos të ripërpunohet meqë ngjarja nuk është paraqitur në mënyrë objektive. Redaktori pohon se Aleksi në këtë tekst nuk e ka përpunuar anën e punëdhënësit, i cili konsideron se punëtorët nuk përpiqen sa duhet për t'i përmbushur normat që kërkohen prej tyre dhe prandaj duhet doemos ta përfundojnë punën gjatë fundjavave. Redaktori e ripërpunoi vetë tekstin dhe në versionin e ri ai ishte më pak kritik ndaj pronarit të fabrikës. Pronari i fabrikës së tekstilit, njëherësh është edhe pronar i gazetës lokale.

Çfarë mendoni, a është kjo censurë? Propagandë mediatike?

Sa e arsyetoni ose nuk e arsyetoni hapin e këtillë? Sqaroni.

Tema

5

QYTETARI DH E SHTETI

Përmbajtja:



Sundimi i së
drejtës dhe
shteti juridik

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

Të sqarojë termin shtet juridik.



Rezultate nga nxënia:

Numëron karakteristika të shtetit juridik.



Materiale të nevojshme:

Letër, Fletë pune 5.1



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë në grupe, punë e mëvetësishme



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Mësimdhënësi i pyet nxënësit nëse u kujtohet ndonjë situatë nga përditshmëria e tyre në të cilën kanë thënë ose kanë menduar: *Nuk është korrekte!*

Nxënësit tregojnë shembuj, ndërsa mësimdhënësi e ndërlidhë konceptin "korrekt" me konceptin e "drejtësisë" dhe bën një rezymë se drejtësia (rregullat dhe ligjet) na ndihmon të dallojmë se çfarë është korrekte, e çfarë jo, çfarë është e drejtë, e çfarë jo. Kur drejtësia funksionon, të gjithë ndjejnë se janë të trajtuar në mënyrë të barabartë.

Nëse nxënësit nuk japin shembuj të tyre, mësimdhënësi duhet të ketë të përgatitura shembuj që do t'i ndajë me ta, në mënyrë që të nxisë diskutim.



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Është vështirë të paramendohet jeta e njerëzve pa ekzistimin e rregullave të caktuara, sipas të cilave, ata do të sillen. Rregullat me të cilat rregullohen marrëdhëniet mes njerëzve në një shoqëri quhen rregulla shoqërore. Zhvillimi i bashkësisë shoqërore është reflektuar në nivelin e zhvillimit të rregullave shoqërore. Me paraqitjen e shteteve, e drejta është ajo që paraqet përmbledhje të normave (rregullave) shoqërore që janë të domosdoshme për të gjithë në një shoqëri.

Çfarë do të thotë e drejta?

E drejta është përmbledhje e rregullave me të cilat rregullohen marrëdhëniet e njerëzve në shoqëri. Ato rregulla i miraton shteti dhe karakteristika kryesore e tyre është se janë rregulla të shkruara. Forma më e shpeshtë në të cilën paraqiten rregullat është ligji, por mund të paraqiten edhe si Kushtetutë, akte nënligjore dhe marrëveshje ndërkombëtare.

Secili ligj ka qëllimin e caktuar saktësisht, mbrojtje të ndonjë vlere. Vlerat që janë të mbrojtura me ligj mund të kenë karakter të llojllojshëm edhe atë: ekonomik, social, politik ose moral. Në shtete të ndryshme, në kohë të ndryshme vlerat janë mbrojtur me ligj në mënyra të ndryshme.

Çfarë do të thotë sundim i së drejtës?

Sundimi i së drejtës si kuptim mbështetet në lirinë dhe të drejtat e njeriut dhe në vlefshmërinë e barabartë të të gjitha ligjeve për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Në Kushtetutën e shtetit tonë si vlerë themelore është miratuar koncepti i sundimit të së drejtës. Thelbi i këtij koncepti është kufizimi i arbitraritetit të bartësve të pushtetit shtetëror, gjegjësisht kjo do të thotë se edhe ata që sundojnë duhet t'i respektojnë rregullat dhe pushteti i tyre duhet të mbështetet vetëm në të drejtën.

Çfarë do të thotë nocioni shtet juridik?

Shtet juridik është ai shtet ku respektohet parimi i sundimit të së drejtës. Në një shtet juridik, ata që e udhëheqin shtetin (bartësit e pushtetit) kanë kufij dhe rregulla sipas të cilave duhet të punojnë. Rregullat sipas të cilave duhet të punojnë bartësit e pushtetit janë në fakt rregullat juridike si Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Aktiviteti 1:

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup merr udhëzim që të paramendojë (1) si funksionon **shteti juridik (shtet në të cilin sundon e drejta)** nëse e paramendojmë atë në formë si funksionon një restorant, ndërsa grupi tjetër (2) si funksionon **shteti juridik në të cilin nuk sundon e drejta**, prap nëse e paramendojmë atë në formë si funksionon një restorant.

Nxënësit duhet të sqarojnë si funksionon ai restorant përmes përgjigjes në pyetjet vijuese?

- Si është shërbimi?
- Si është muzika?
- Kush ka qasje deri tek restoranti?
- A paguajnë të gjithë çmim të njëjtë për ushqimin dhe pijet?
- A janë mysafirët e restorantit të kënaqur?
- A merr dikush ushqim më të bukur sesa shumica?

Pas punës në grupe, nxënësit duhet të prezantojnë se çfarë kanë konstatuar në kuadër të grupit. Konstatimet duhet të lëvizin në drejtim të: respektimit të rregullave/ligjeve në shtetin juridik, marrjen e shërbimit të barabartë për të gjithë dhe qasje të njëjtë deri te shërbimet, kënaqësi të qytetarëve nga trajtimi i barabartë, etj.. Konstatimet në rastin me shtetin në të cilin nuk sundon e drejta duhet të jenë në drejtim të: qasjes së pabarabartë deri te shërbimet, trajtim të pabarabartë, pakënaqësi për shkak të diskriminimit të grupeve të caktuara, vendimmarrje (p.sh. për muzikën) nga pozicioni i fuqisë, etj.

Aktiviteti 2:

Mësimdhënësi u shpërndanë Fletën e punës 5.1. nxënësve, me udhëzim: Tani do të lexoni disa pohime. Ju lutemi, shënoni nëse pajtoheni me secilin prej tyre.

Pasi të përgjigjen në pyetjet, mësimdhënësi do të çelë debat për të njëjtat.

Diskutimi do të duhej të shpie drejt konstatimeve si vijon:

- 1) Ligjet duhet doemos të respektohen nëse janë të mira dhe i shërbejnë qytetarit. Por, nëse ligji na shtyn që të bëjmë diçka të keqe nuk është e domosdoshme që ta respektojmë. P.sh.: nëse ligji thotë se gratë duhet trajtuar më keq sesa burrat gjatë punësimit, atëherë ai ligj është i keq dhe duhet të mundohemi që ta ndryshojmë.
- 2) Ligji duhet doemos të respektohet, madje edhe kur bëhet fjalë për mikun ose farefisnin tonë.
- 3) Rregullat duhet të respektohen ashtu siç janë përcaktuar. Nëse një pjesë e madhe e qytetarëve janë të pakënaqur nga procedurat, atëherë duhet të angazhohen për lehtësimin/shkurtimin e tyre dhe ngjashëm, por pa e shkelur me këtë rast ligjin.



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi në tabelë e shkruan nocionin – *Shteti juridik* dhe u bën thirrje nxënësve që të dalin dhe të shkruajnë nocione që atyre ju kujton nocionin e shkruar. Në fund, mësimdhënësi bën përmbledhjen e nocioneve të shënuara, që do të duhej të shënojnë karakteristikat e shtetit juridik.



Fletë pune 5.1

		PAJTOHEM	NUK PAJTOHEM
1	Ligjet duhet doemos gjithmonë të respektohen, madje edhe kur kjo paraqet problem për ju personalisht		
2	Asnjëherë nuk do t'i ndihmoja një miku/e nëse kjo nënkupton të shkel ligjin		
3	Shkelja e rregullave nuk është e tmerrshme nëse i lehtëson dhe/ose shkurton procedurat e zakonshme		





Përmbajtja:



Sundimi i së
drejtës dhe
shteti juridik

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- Të identifikojë ndikimin e dëmshëm të korrupsionit në zhvillimin e individit, grupit dhe shoqërisë.
- Të analizojë mekanizma për parandalimin e korrupsionit dhe mbrojtje nga veprimet korruptuese.



Rezultate nga nxënia:

- Dallon interesin privat nga ai publik dhe përmendë shembuj jo etik në mjedisin e tij.
- Vlerëson se çdo akt që ka për qëllim fitimin personal në dëm të tjetrit është i paligjshëm.



Materiale të nevojshme:

Letër, Fletë pune 5.2



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë e mëvetësishme



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Në pjesën hyrëse të orës mësimdhënësi ua shpërndan nxënësve fletën e punës: *Pyetësor për korrupsion*, që secili nxënës e plotëson në mënyrë të pavarur.





Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Aktiviteti Diskutim

Pasi të plotësojnë pyetësoin, mësime dhënësi nxitë diskutim grupor për secilën prej çështjeve të përmendura. Nxënësit tregojnë se çfarë përgjigje kanë dhënë dhe pse kanë konsideruar se ajo është përgjigjja e duhur, si dhe nëse kanë qenë në situata të ngjashme, e më pas nxirren konstatime. Mësime dhënësi duhet të bëjë të ditur se të gjitha situatat e përmendura janë raste të sjelljes korruptuese, ndonëse me nivel të ndryshëm të keqpërdorimit të pozicionit apo nivel të ndryshëm të ndikimit ndaj pabarazisë së qytetarëve.

Mësime dhënësi konstaton:

Në ushtrimin e të ashtu quajturës punë publike dhe në plotësimin e nevojave në jetën e përditshme të qytetarëve krahas organeve shtetërore paraqiten edhe ndërmarrjet publike, shërbimet dhe institucionet. Të gjitha ato kanë në dispozicion një nivel të caktuar të pushtetit. Këto subjekte të cilave qytetarët u kanë dhënë fuqi për të sunduar në emër të tyre duhet që atë fuqi ta përdorin në interes të të gjithë qytetarëve dhe të mos e keqpërdorin pozicionin e tyre. Kjo do të thotë se postin duhet ta ushtrojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet.

Jo gjithmonë në një shtet demokratik arrihet të sigurohet sundim i së drejtës në tërësi. Njëra prej formave më të vështira të rrezikimit të shtetit juridik konsiderohet **korupsioni** (nocioni “korupsion” rrjedhë nga termi latin *corruptio* i cili përkthehet si dhënie ryshfet/mitosje, kalbësirë/prishje, kalbje dhe shkatërrim si proces). Me korupsion sot nënkuptohet keqpërdorimi i postit dhe detyrës zyrtare për realizimin e çfarëdo leverdie personale ose leverdi për dikë tjetër. Korupsioni ka forma të ndryshme, por gjithmonë ka për qëllim të përvetësohet ndonjë leverdi e paligjshme për veten ose për dikë tjetër. Format më të shpeshta të korupsionit janë: ryshfeti ose mitosja, nepotizmi (favorizimi i familjarëve ose miqve për funksione ose vende të punës duke mos mbajtur llogari për profesionalizmin), shpërdorimi i mjeteve financiare shtetërore, keqpërdorimi i detyrës zyrtare, etj.

Funksionarët shtetërorë dhe persona të tjerë zyrtarë krahas faktit që duhet t’u përmbahen ligjeve dhe nuk duhet të zbatojnë veprime korruptuese të çfarëdo forme, gjithashtu duhet t’u përmbahen standardeve dhe parimeve të caktuara etike. Kjo do të thotë se në punën e tyre duhet të jenë profesionistë, të sjellshëm, të orientuar ndaj shërbimit të qytetarëve dhe të sillen me respekt ndaj të punësuarve, ndaj qytetarëve, kompanive dhe palëve të tjera. Prandaj, në nivel të çdo institucioni miratohen kodekse etike që duhet të respektohen.



A e keni ditur se...

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekziston Komision Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit që është i mëvetësishëm, institucion i pavarur me kompetencë për të parandaluar korrupsionin. Secili qytetar ka të drejtë të parandalojë ose të denoncojë korrupsion dhe qytetarët mund të dorëzojnë ankesa në këtë institucion.



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi nxitë diskutim të shkurtër lidhur me pyetjet si vijon:

- ➔ A mund të jetë, ajo që duam ta arrijmë, shumë më e rëndësishme sesa rruga përmes të cilës do të kalojmë për të arritur deri atje?
- ➔ A keni dëgjuar dikë të arsyetojë sjellje korruptuese me fjalët “është i/e shkathët”? Çfarë mendoni për këtë?
- ➔ A ju ka ndodhur që ndonjë i moshuar (prind/familjar/mësimdhënës) t’ju nxisë drejt sjelljes korruptuese ose jo etike me fjalët “bëhu i shkathët”, ose “nuk më intereson si, me rëndësi është që ta bësh atë”? Si keni reaguar në situatë të tillë?



Fletë pune 5.2

Pyetësor për korrupsionin

Në shoqërinë tonë shpeshherë përdoret fjala korrupsion. Çfarë nënkuptoni ju me nocionin korrupsion?

Në tabelën më poshtë janë dhënë situata të ndryshme nga jeta e përditshme. Lexoni dhe shënoni, sipas jush çdonjëra situatë mund të konsiderohet për korrupsion, sjellje korruptuese ose jo.

A ËSHTË KORRUPSION:		PO	JO
1	Dhënia e dhuratës për një doktor që t'ju kushtojë më shumë vëmendje		
2	Dhënia e parave për një nëpunës policor që t'ua shqyej dënimin për parkim të gabuar		
3	Votimi për një parti të caktuar politike që ta punësojë fëmijën tuaj		
4	Blerja e librit shkollor në mënyrë që më lehtë të merrni notë te mësimdhënësi		
5	Qerasja e nëpunësit në komunë në mënyrë që më lehtë të merret leje për ndërtim të shtëpisë		
6	Të jeni drejtor i Ndërmarrjes Komunale dhe njëherësh të keni ndërmarrje që ua jep me qira kamionët		
7	Ndjekja e orëve private te profesori që punon në shkollën ku mëson nxënësi		
9	Dhënia e dhuratës ose parave për një nëpunës jashtë vendit të punës që t'ju sigurojë termin më të shpejtë për marrjen e pasaportës së re		

Do të lexoni disa deklarata, Ju lutemi tregoni **sa pajtoheni** me secilën prej tyre

		TËRËSISHT E SAKTË	PJESËRISHT E SAKTË	E PASAKTË
1	Korrupsion është marrja e parave për të kryer ndonjë punë			
2	Korrupsion është kur një kryetar komune punon për interesin personal			
3	Korrupsion është të ofrosh para për të kryer ndonjë punë			
4	Për të pasur korrupsion, duhet doemos të ketë shkëmbim të parave			
5	Për të pasur korrupsion, duhet doemos të jetë i përzier një politikan/e i/e zgjedhur			
6	Dhurata për një nëpunës komunal pasi të ndihmojë që të kryeni ndonjë punë më shpejtë se në procedurë të rregullt nuk mund të konsiderohet korrupsion			
7	Nuk ka korrupsion nëse me realizimin e interesit personal askujt nuk i është shkaktuar dëm i drejtpërdrejt			





Përmbajtja:



Sundimi i së
drejtës dhe
shteti juridik

Tretë orë



Qëllime të orës mësimore:

- Të identifikojë ndikimin e dëmshëm të korrupsionit në zhvillimin e individit, grupit dhe shoqërisë.
- Të analizojë mekanizma për parandalimin e korrupsionit dhe mbrojtje nga veprimet korruptuese.



Rezultate nga nxënia:

- Dallon interesin privat nga ai publik dhe përmendë shembuj jo etik në mjedisin e tij.
- Vlerëson se çdo akt që ka për qëllim fitimin personal në dëm të tjetrit është i paligjshëm.



Materiale të nevojshme:

Letër, Fletë pune 5.3



Metoda, teknika, forma:


Analizë e rasteve, punë në grupe, diskutim grupor, teknika „prizmi”




Aktivitet hyrës

(10 min.)

Përmes teknikës “Prizmi” nxënësit e zbërthejnë kuptimin e nocionit “Korrupsion”. Mësimdhënësi në tabelë e shkruan nocionin, e më pas nxënësit duhet të vendosin për dy nocione që lidhen me korrupsion, më pas, nga dy nocione që lidhen me nocionet e përmendura paraprakisht. Pasi që të kenë katër nocione/fjalë në horizontalë, fillojnë të mbyllin prizmin, e që në fund të vijnë deri te nocioni/fjala që do të duhej të jetë e ndërlidhur me korrupsion.





Pjesa kryesore e orës

(30 min.)

Aktiviteti

Nxënësit ndahen në 5 grupe. Secili prej grupeve merr një rast nga *Fleta e punës 5.3*. që duhet ta analizojnë dhe të përcaktojnë nëse bëhet fjalë për korrupsion. Përgjigjet e tyre duhet t'i arsyetojnë.

Pyetje për diskutim:

- ➔ A keni vërejtur ose keni dëgjuar ndoshta për ndonjë rast të ngjashëm?
- ➔ Si do të kishit vepruar ju nëse do të kishit hasur në situatë të ngjashme?
- ➔ Çfarë mendoni, si veprojnë të tjerët në mjedisin tuaj?
- ➔ Përmendni shembuj të sjelljes korruptuese në mjedisin tuaj?
- ➔ Në cilat raste nuk do të kishit denoncuar korrupsion?



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit që të mendojnë për përmbajtjet, përmes pyetjeve vijuese:

- ➔ Çfarë të reje mësuat gjatë orës së sotme?
- ➔ A jeni befasuar nga disa njohuri?
- ➔ Çfarë do të donit të mësoni në mënyrë plotësuese lidhur me këtë përmbajtje?



Fletë pune 5.3

Gjatë kalimit në vendkalimin kufitar, Gorani nuk ka pasur kartonin e rregullt të gjelbër (sigurim i automobilit jashtë vendit). Për shkak të kësaj ai i ka dhënë 2000 denarë nëpunësit policor, i cili pasi i ka marrë paratë e ka lëshuar të kalojë pa problem.

- A është ky rast i korrupsionit?
- Pse po? Pse jo? Sqaroni.
- Si do të vepronit ju në vendin e Goranit?
- Si do të vepronit ju në vendin e nëpunësit policor?

Rasti 2

Drejtori i përgjithshëm i ndërmarrjes publike një pjesë të të ardhurave të realizuara në punën e ndërmarrjes i ka shfrytëzuar për shërimin e nënës së tij, për të cilën ka qenë i domosdoshëm intervenim kirurgjik jashtë vendit.

- A është ky rast i korrupsionit?
- Pse po? Pse jo? Sqaroni.
- Si do të vepronit ju në vendin e drejtorit të përgjithshëm?
- Si do të vepronit ju në vendin e të punësuarve?

Rasti 3

Mësimdhënësja Sabina është mike e mirë me Maren. Djali i Mares është nxënës në klasën e VI-të dhe në lëndën që e ligjëron mësimdhënësja Sabina ka notën 4. Në fund të vitit shkollor mësimdhënësja e përmirëson notën e djalit të mikes së saj të ngushtë nga 4 në 5, në mënyrë që të mos e prishë miqësinë.

- A është ky rast i korrupsionit?
- Pse po? Pse jo? Sqaroni.
- Si do të vepronit ju në vendin e mësimdhënëses Sabina?
- Si do të vepronit ju në vendin e Mares?

Rasti 4

Një e punësuar në Ministri, gjatë orarit të punës flet në telefonin e saj celular biseda private më shumë se dy orë.

- A është ky rast i korrupsionit?
- Pse po? Pse jo? Sqaroni.
- Si do të vepronit ju në vendin e të punësuarës?

Rasti 5

Синот на Ина е многу болен. Докторот бара пари за Ро му обезбедот место во болницата, за Ро може Ро се лекува. Ина Рова пари на докторот и местото е обезбедено. Наскоро болницата започнува со терапија.

- A është ky rast i korrupsionit?
- Pse po? Pse jo? Sqaroni.
- Si do të vepronit ju në vendin e Inës?
- Si do të vepronit ju në vendin e drejtorit?

Përmbajtja:



Zgjedhjet dhe
proceset demokratike
në shoqëri

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- Të sqarojë demokracinë si procedurë, mënyrë e të menduarit dhe veprimt;
- Të kuptojë lidhjen mes zgjedhjeve dhe proceseve demokratike në shoqëri.



Rezultate nga nxënia:

- Diskuton pse është e rëndësishme pjesëmarrja në zgjedhje dhe si është kjo e ndërlidhur me legjitimitetin e pushtetit (shembuj konkret).



Materiale të nevojshme:

Letër, lapsa kimik



Metoda, teknika, forma:

Stuhi e ideve, diskutim grupor, teknika „bingo“



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Çfarë është demokracia? – stuhi e ideve dhe diskutim

Në pjesën hyrëse të orës, përmes teknikës stuhi të ideve, mësimgdhënësi e kontrollon diturinë e nxënësve lidhur me atë se si e kuptojnë demokracinë. Në tabelën shënohet fjala – Demokraci dhe nga nxënësit kërkohet të përmendin se çfarë u bie ndërmend kur e dëgjojnë fjalën.

Pasi që nxënësit do të përmendin disa nocione, mësimgdhënësi nxitë diskutim përmes disa pyetjeve:

- ➔ Nëse demokracia përkufizohet si sundim i popullit, a do të thotë kjo se sundon i tërë populli? Çfarë do të thotë në fakt kjo?
- ➔ Si merren vendimet në një shoqëri (në nivel shtetëror, në nivel lokal, në shkollën tonë)? Sqaroni përmes shembullit. Sa janë demokratike mënyrat në të cilat merren vendimet?
- ➔ A keni votuar ndonjëherë gjatë vendimmarrjes në shkollën tuaj/tonë? Përshkruani se si është zhvilluar procesi. Sa konsideroni se përfaqësuesit e zgjedhur kanë përfaqësuar/përfaqësuar interesat, nevojat tuaja?
- ➔ A keni pasur ndonjë problem në shkollë? Kujt iu drejtuat që t'ua zgjidhë problemin? A është zgjidhur problemi?
- ➔ A janë nxënësit në shkollën tuaj të barabartë me njëritjetrin? A ekzistojnë dallime mes nxënësve? A kanë të gjithë nxënësit të drejta të barabarta?

Mësimgdhënësi i përmbledhë përgjigjet e nxënësve dhe i përshkruan parimet kryesore të demokracisë.



Pjesa kryesore e orës

(20 min.)

Në thelbin e saj, demokracia është formë e sundimit në të cilën pushteti demokratik duhet të rezultojë nga qytetarët dhe të zbatohet vetëm për interesat e përbashkët të qytetarëve. Meqë sundimi i gjithë popullit në kuptimin tekstual të fjalës është vështirë i realizueshëm, sundimi bashkëkohor demokratik realizohet përmes zgjedhjes së përfaqësuesve të qytetarëve në pushtet, e quajtur **demokrati përfaqësuese**. Demokracia përfaqësuese paraqet ushtrimin e pushtetit përmes përfaqësuesve të zgjedhur nga qytetarët të cilët e shprehin mendimin dhe vullnetin e tyre në zgjedhje të mbajtura demokratike me ç'rast përfaqësuesit e zgjedhur në emër të tyre dhe në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e ushtrojnë pushtetin. Demokracia është formë e sundimit të drejtë dhe të mirë që ofron liri të barabartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

Krahas demokracisë përfaqësuese, ekziston edhe **demokrati e drejtpërdrejt (demokrati direkte)**, që karakterizohet me atë që gjatë ushtrimit të pushtetit nuk ka përfaqësues të zgjedhur, por secili qytetar vendos drejtpërdrejt për një çështje të caktuar. Sot, forma më e lartë e demokracisë së drejtpërdrejt është **referendumi**. Përmes referendumit, qytetarët e japin mendimin e tyre për një çështje të caktuar ose marrin vendim të caktuar. Në referendum, qytetarët e shprehin mendimin e tyre duke votuar **për** ose **kundër** një çështjeje të caktuar. Në shtetin tonë, Kuvendi shpallë referendum në nivel shtetëror me iniciativë personale ose me propozim (nënshkrime të mbledhura) të së paku 150.000 qytetarëve.

Shembull i demokracisë së drejtpërdrejtë

Grekët në Greqinë antike, në Athinë, kanë vendosur njërin prej formave të para të demokracisë. Demokracia e drejtpërdrejt paraqet sundim personal nga ana e njerëzve. Të gjitha vendimet e rëndësishme janë marrë në votim para Kuvendit popullor që e kanë përbërë të gjithë burrat e moshës së rritur, qytetarë të Athinës. Demokracia e drejtpërdrejt e Athinës një kohë të gjatë është konsideruar si lloj ideal i demokracisë meqë ka kërkuar nivel të lartë të pjesëmarrjes së të gjithë qytetarëve në pushtet.

Mësimdhënësi pyet: *Çfarë mendoni, cila është ana e mirë e këtij lloji të demokracisë? Në çfarë kritikash do të haste kjo praktikë nëse e shikojmë nga perspektiva e sotme? Kush në fakt i ka marrë vendimet? Cilët qytetarë kanë qenë të përjashtuar?*

Konstatohet se ky lloj i demokracisë ka pasur mangësi që janë përbërë prej mospranimit të grave, robërve dhe të huajve për qytetarë të barabartë të Athinës dhe mos përfshirjen e tyre në marrjen e vendimeve.

Mësimdhënësi përmes pyetjes: *Cila është lidhja mes demokracisë dhe zgjedhjeve?* I nxitë nxënësit që të japin mendimet dhe përgjigjet e tyre, ndërsa mësimdhënësi duhet të drejtojë diskutimin drejt konstatimit se zgjedhjet paraqesin karakteristikën themelore të demokracisë. Përmes zgjedhjeve, votuesit kanë mundësi të për zgjedhin përfaqësuesit e tyre në pushtet dhe t'i konsiderojnë përgjegjës për sundimin e tyre. Në këtë mënyrë, votuesit sigurohen se interesat dhe nevojat e tyre respektohen dhe realizohen përmes përfaqësuesve të cilët i kanë zgjedhur.

Njëra prej vlerave themelore në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë zgjedhjet e lira dhe demokratike. Zgjedhjet u mundësojnë qytetarëve të votojnë dhe të vendosin për të ardhmen e tyre. Qytetarët votojnë për të zgjedhur përfaqësues në nivelet e ndryshme të pushtetit. Ata besojnë se me zgjedhjen e

një partie të caktuar politike ose politikani, do të ndikojnë në mënyrën në të cilën pushteti ndikon në drejtimin në të cilin zhvillohet shteti.

Secili qytetar ka të drejtë të votojë sipas bindjes së tij të lirë në zgjedhje, me ç'rast e drejta e zgjedhësit duhet të jetë:

- e drejtpërdrejtë** – secili qytetar e jep votën e tij drejtpërdrejt, jo përmes ndërmjetësuesit dhe e drejta e votës nuk mund të bartet nga njëri te një qytetar tjetër
- e fshehtë** – garantohet fshehtësia gjatë votimit. Askush nuk ka të drejtë të dijë për kë keni votuar, e as që keni obligim t'i tregoni dikujt për zgjedhjen që e keni bërë
- e barabartë** – vota e çdo qytetari vlerësohet në mënyrë të barabartë
- e përgjithshme** – të gjithë ata që i kanë plotësuar kushtet për të pasur të drejtën e zgjedhësit, e kanë atë pa marrë parasysh gjininë, moshën, racën, nacionalitetin, besimin fetar, statusin social dhe shoqëror, etj.

Njerëzit që i zgjedhim të jenë përfaqësuesit tanë kandidohen në zgjedhjet në të cilat i votojmë.

Kushtetuta e RMV-së ua garanton qytetarëve lirinë e bashkimit për shkak të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera.

Pluralizmi ose diversiteti paraqet supozimin themelor për zhvillimin e demokracisë bashkëkohore. Pluralizmi politik manifestohet përmes formave të ndryshme:

- ➔ - Parti politike
- ➔ - Lëvizje politike
- ➔ - Shoqata të qytetarëve
- ➔ - Grupe të tjera joformale të qytetarëve

Partitë politike janë forma themelore e organizimit politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Partia politike mund të përkufizohet si organizatë e përhershme politike e bashkëmendimtarëve ideor të cilët në mënyrë demokratike luftojnë që të marrin pushtetin në të gjitha nivelet, gjegjësisht grup i organizuar për marrjen e pushtetit politik përmes zgjedhjeve.



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim: Bingo (10 min)

Secili nxënës merr fletë me tabelën si vijon / ose e vizaton në fletore.

Çfarë më la përshtypje	Çfarë kisha të paqartë

- Secili nxënës shënon në fushën e parë një nocion/përmbajtje që i ka lënë përshtypje gjatë orës, ndërsa në fushën e dytë nocion/përmbajtje që ka qenë e paqartë
- Më pas bisedon me edhe katër nxënës dhe i lutë që në fushat tjera të shënojnë nga një nocion por ai të mos përsëritet me të tjerat.
- Kur nxënësi do t'i kompletojë të gjashtë fushat – thërret BINGO dhe ngre dorën.
- Vijon prezantimi i BINGO-s prej 2-3 nxënësve.

Përmbajtja:



Zgjedhjet
dhe proceset
demokratike në
shoqëri

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- Të kuptojë lidhjen mes zgjedhjeve dhe proceseve demokratike në shoqëri.



Rezultate nga nxënia:

- Sqaron se si përmes partive politike qytetarët i shprehin interesat e ndryshëm
- Respekton rezultate nga zgjedhjet demokratike dhe vendimet e shumicës në mjedisin e tij



Materiale të nevojshme:

Diskutim grupor, debat sipas formatit të caktuar, notim moshatar



Metoda, teknika, forma:

Letër, lapsa kimik, Fletë pune 5.4.A, Fletë pune 5.4.B



Aktivitet hyrës

(10 min.)

Mësimdhënësi i njofton nxënësit me nocionet pluralizëm politik, parti politike, pjesëmarrje në zgjedhje dhe nxitë diskutim për të drejtën demokratike të çdo individi për të marrë pjesë në zgjedhje dhe të përcaktohet për programin e një partie të caktuar politike.

Mësimdhënësi pyet:

Shikojeni listën në vijim dhe tregoni, sipas jush, kush duhet të mund të formojë parti politike dhe kush mund të votojë:

	KUSH DUHET TË MUND TË FORMOJË PARTI	KUSH MUND TË VOTOJË
Burra		
Gra		
Persona të dënuar për krim		
Persona më të rinj se 21 vjet		
Persona më të moshuar se 90 vjet		
Persona pa shkollë të mbaruar fillore		

Mësimdhënësi nxitë diskutim lidhur me përgjigjet, ndërsa konstatimi duhet të jetë se të gjitha ato grupe mund të formojnë parti dhe mund të votojnë.



Ora kryesore e orës

(25 min.)

Debat në temën: „Votimi (nuk) duhet të jetë i detyrueshëm“

Nxënësit ndahen në tri grupe. Njëri grup do të mbrojë tezën se „votimi duhet të jetë i detyrueshëm dhe secili qytetar duhet doemos të marrë pjesë në zgjedhje“ (merr **Fletë pune 5.4.A**), grupi i dytë do të mbrojë tezën se “votimi nuk duhet të jetë i detyrueshëm dhe është vetëm përgjegjësi qytetare” (merr **Fletë pune 5.4.B**). Grupi i tretë i nxënësve do të jenë gjykatës.

Dy grupet e para punojnë mëvetësishëm dhe përgatisin argumente për tezat e tyre, e më pas përzgjedhin përfaqësues që do t’i mbrojnë qëndrimet e tyre në raport me tezat (përgatitje 10 minuta). Gjatë asaj kohe grupi i tretë e përgatitë teknikisht debatin dhe merren vesh për mënyrën e dhënies së pikave (shkalla e pikave). Debati do të ketë fitues, por kjo nuk do të thotë se cilado prej tezave është e gabuar. Qëllimi i debatit është që të nxisë të menduarit kritik te nxënësit, ndërtimin e qëndrimit dhe zgjedhjes personale; respektimin e mendimit të kundërt dhe ndërtimin e sjelljes qytetare.

Ekipe në debat:

Ekipi „A“ (Votimi duhet të jetë i detyrueshëm)

Ekipi „B“ (Votimi nuk duhet të jetë i detyrueshëm)

Në fund, grupi i tretë, gjegjësisht grupi i gjykatësve zbaton votimin dhe përzgjedh fituesin në debat. Mësimdhënësi duhet t’i ketë në dispozicion argumentet vijuese potenciale të ekipit afirmues dhe mohues, ndonëse nuk duhet t’ua japë paraprakisht nxënësve në mënyrë që ata të formulojnë argumente për tezën në mënyrë të mëvetësishme. Megjithatë, mësimdhënësi mund t’i udhëzojë nxënësit drejt argumenteve potenciale, nëse vëren se kanë vështirësi për t’i zhvilluar në mënyrë të mëvetësishme.

Ekipi A:

Votimi duhet të jetë i detyrueshëm

1. E rritë pjesëmarrjen politike të qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve

Qytetarët të cilët kanë përvetësuar të drejtën e votës, sipas ligjit janë të obliguar që pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve në një shtet të marrin pjesë dhe të realizojnë këtë të drejtë. Prandaj, ata do të jenë të obliguar që të marrin pjesë aktive në procesin e marrjes së vendimeve dhe krijimin e politikave publike. Meqë qytetarët do të jenë të vetëdijshëm për ekzistimin e një dënimi të caktuar nëse nuk dalin të votojnë, ata do ta kuptojnë më seriozisht procesin e mbajtjes së zgjedhjeve dhe programet e ofruara politike për të cilat do të votojnë.

Për të përvetësuar të drejtën e votës në demokraci, njerëzit kanë luftuar gjatë gjithë historisë moderne. Vetëm gjatë shekullit të kaluar qytetarët e shumë vendeve kanë luftuar për çlirim dhe përvetësimin e kësaj të drejte. Duhet të respektojmë sakrificën e tyre dhe të votojmë.

2. Rritet vëllimi i interesave në agjendat politike të partive

Meqë modeli i votimit të detyrueshëm i urdhëron të gjithë qytetarët që kanë të drejtë vote që të marrin pjesë në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, aktorët politik të cilët luftojnë për pushtet do të duhet të kenë kujdes që në programet e tyre politike t'u kushtojnë vëmendje interesave që zakonisht janë anashkaluar (në të shumtën e rasteve pjesëtarë të grupeve të pakicave dhe bashkësive të marginalizuara). Përmes këtij modeli, edhe partitë politike do të punojnë me përkushtim më të madh në planifikimin e politikave që janë përkatëse për interesat e grupeve shumicë, por edhe grupeve pakicë në një shtet.

3. Rritet legjitimiteti i pushtetit të zgjedhur

Shtetet për suksesin e një lloji të caktuar të zgjedhjeve kanë përqindje të ndryshme të pjesëmarrjes të caktuar lartë, që shpesh ndodhë që të mos arrihet. Në këtë mënyrë, për shkak të detyrimit për të votuar dhe informimit më të madh për kë do të votojnë, do të ishte e pritur që aktorët politik që do ta merrnin pushtetin shtetëror të kenë legjitimitet më të madh. Aktorët politik do të përfaqësonin shumicë shumë më të madhe të interesave të qytetarëve, ndërsa shumica më e madhe prapa vendimit që është marrë do të thotë edhe legjitimitet më të madh.

Ekipi B:

Votimi nuk duhet të jetë i detyrueshëm

1. Mospjesëmarrja në votim paraqet qëndrim dhe është porosi e pakënaqësisë dhe revolt ndaj politikanëve

Qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre me pritje të caktuara për ndryshim në shoqëri. Në momentin kur kërkesat dhe pritjet e tyre nuk përmbushen, qytetarët vendosin të mos u japin mbështetje politikanëve përmes marrjes së qëndrimit të fortë për mospjesëmarrje në zgjedhjet e radhës. Kjo paraqet porosi të qartë të pakënaqësisë që u drejtohet drejtpërdrejt politikanëve të cilët varen nga vota e qytetarëve. Me veprimin e këtillë qytetarët shprehin në mënyrë demokratike revoltin ndaj përgjegjësisë së përfaqësuesve politik.

2. Mosekzistimi i listave të hapura të votimit (ku krahas për partinë politike ose listën e kandidatëve mund të zgjidhet edhe një kandidat nga lista)

Shpeshherë, sistemi politik është i krijuar në atë mënyrë që t'i preferojë listat e mbyllura të votimit. Në këto sisteme nuk mund të vijë deri te mundësia për zgjedhjen e kandidatëve që nuk i takojnë asnjë partie politike. Në sistemin e listave të hapura të votimit, qytetarët mund të votojnë lirisht vetëm për një kandidat që duan ta mbështesin, pa votuar me këtë rast për një parti të caktuar politike. Në këtë mënyrë vijnë më shumë në shprehje politikat specifike për të cilat angazhohen kandidatët e ndryshëm politik.

3. E drejta legjitime e qytetarit që të votojë ose të mos votojë

Secili qytetar ka të drejtën legjitime të votës që është e përcjellë me lirinë e vendimmarrjes së mëvetësishme për realizimin e kësaj të drejte të tij. Kjo liri i mundëson qytetarit që tërësisht të vendosë nëse do ta realizojë fare të drejtën e tij dhe të marrë pjesë në zgjedhje për të votuar ose për të mos votuar. E drejta e votës, në pjesën më të madhe të shteteve në botë, nuk është përcjellë me obligimin për votim të domosdoshëm. Për shkak të kësaj, vendimmarrja për atë a të votohet në zgjedhje i është lënë tërësisht vullnetit të qytetarit.



Diskutim për reflektim dhe vlerësim (5 min)

Mësimdhënësi nxitë diskutim për rrjedhën e debatit dhe rëndësinë që të bisedohet për çështje të këtilla shoqërore. Bashkë me nxënësit duhet të vijnë deri te konstatimi se nuk mund të jemi dakord me të gjithë, por duhet të dimë t'i respektojmë mendimet e tyre, veçanërisht nëse janë mirë të argumentuara dhe të mbështetura me dëshmi. Prandaj, është mirë që ndonjëherë të vihemi në rolin e "tjetrit" dhe të tentojmë ta kuptojnë qëndrimin që e ka për një çështje të caktuar, edhe pse ndoshta nuk jemi dakord lidhur me atë çështje.



Fletë pune 5.4-A

Në një demokraci, votimi mund të paraqitet si përgjegjësi qytetare (qytetari është e pëlqyeshme të votojë, por mund edhe të mos dalë në zgjedhje), por edhe si obligim ligjor (qytetari është i obliguar me ligj që të votojë, e nëse nuk e bën këtë – mund të ketë sanksione). Në shtetin tonë, votimi është **përgjegjësi qytetare**, por ekzistojnë edhe shtete (si Australi, Belgjikë, Greqi, Luksemburg...) ku votimi paraqet **obligim ligjor** të secilit qytetar.

Grupi juaj (Ekipi „A“) ka për detyrë të **mbrojtë idenë se votimi duhet të jetë i detyrueshëm (gjegjësisht obligim ligjor)**.

Keni 10 minuta të mendoni për argumente për mbrojtje të tezës tuaj. Mendoni edhe për argumentet potenciale që do t'i jepnin debatuesit nga grupi tjetër, që të mund të zhvilloni kundër-argumente përkatëse.

Argumente:

Përzgjidhni tre përfaqësues nga grupi juaj që do të duhet ta mbrojnë tezën tuaj dhe merruni vesh se kush cilat argumente do t'i prezantojë. Me këtë rast, duhet të keni parasysh formatin e radhës për rrjedhën e debatit dhe kornizën kohore:

Format për debat:

Kufizim kohor për ekipet për debatim – debati duhet të zgjasë gjithsej 16 minuta, sipas renditjes si vijon:

- ➔ Ekipi A e mbron tezën e mbështetur me argumente (1 minutë)
- ➔ Ekipi B e mbron tezën e tij të mbështetur me argumente (1 minutë)
- ➔ Ekipi A prezanton argumente të reja dhe u bën replikë argumenteve paraprake të ekipit B (2 minuta)
- ➔ Ekipi B prezanton argumente të reja dhe u bën replikë argumenteve paraprake të ekipit A (2 minuta)
- ➔ Ekipi A bën përmbledhjen e debatit të përgjithshëm dhe e nxjerr poentën kryesore të tezës (2 minuta)
- ➔ Ekipi B gjithashtu bën përmbledhjen e debatit të përgjithshëm dhe e nxjerr poentën kryesore të tezës (2 minuta).



Fletë pune 5.4-B

Në një demokraci, votimi mund të paraqitet si përgjegjësi qytetare (qytetari është e pëlqyeshme të votojë, por mund edhe të mos dalë në zgjedhje), por edhe si obligim ligjor (qytetari me ligj është i obliguar të votojë, e nëse nuk e bën këtë – mund të ketë sanksione). Në shtetin tonë, votimi është **përgjegjësi qytetare**, por ekzistojnë edhe shtete (si Australi, Belgjikë, Greqi, Luksemburg...) ku votimi paraqet **obligim ligjor** të secilit qytetar.

Grupi juaj (Ekipi „B”) ka për detyrë të **mbrojë idenë se votimi nuk duhet të jetë i detyrueshëm, por vetëm përgjegjësi qytetare që nuk duhet të jetë e detyrueshme.**

Keni 10 minuta të mendoni për argumente për mbrojtje të tezës tuaj. Mendoni edhe për argumentet potenciale që do t’i jepnin debatuesit nga grupi tjetër, që të mund të zhvilloni kundër-argumente përkatëse.

Argumente:

Përzgjidhni tre përfaqësues nga grupi juaj që do të duhet ta mbrojnë tezën tuaj dhe merruni vesh se kush cilat argumente do t’i prezantojë. Me këtë rast, duhet të keni parasysh formatin e radhës për rrjedhën e debatit dhe kornizën kohore:

Format për debat:

Kufizim kohor për ekipet për debatim – debati duhet të zgjasë gjithsej 16 minuta, sipas renditjes si vijon:

- ➔ Ekipi A e mbron tezën e mbështetur me argumente (1 minutë)
- ➔ Ekipi B e mbron tezën e tij të mbështetur me argumente (1 minutë)
- ➔ Ekipi A prezanton argumente të reja dhe u bën replikë argumenteve paraprake të ekipit B (2 minuta)
- ➔ Ekipi B prezanton argumente të reja dhe u bën replikë argumenteve paraprake të ekipit A (2 minuta)
- ➔ Ekipi A bën përmbledhjen e debatit të përgjithshëm dhe e nxjerr poentën kryesore të tezës (2 minuta)
- ➔ Ekipi B gjithashtu bën përmbledhjen e debatit të përgjithshëm dhe e nxjerr poentën kryesore të tezës (2 minuta).

Përmbajtja:



Administrata
shtetërore
dhe publike
në funksion të
qytetarëve



Qëllime të orës mësimore:

- Të sqarojë funksione dhe përgjegjësi të administratës shtetërore dhe publike;



Rezultate nga nxënia:

- Krahason funksione dhe përgjegjësi të administratës shtetërore dhe publike dhe vëren dallime në situata konkrete;



Materiale të nevojshme:

Fleta letre, lapsa kimik, Fletë pune 5.5.



Metoda, teknika, forma:

Punë në grupe, punë në çifte, diskutim



Aktivitet hyrës

(15 min.)


Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup duhet të mendojë për shërbimet që i marrin, si vijon: pastrim të mbeturinave dhe rrugëve, përdorim të transportit publik, shkuarje në shkollë, shkuarje te mjeku amë dhe fikje të zjarrit.

Secili grup duhet të përgjigjet në pyetjet si vijon:

- 1) Kush e ofron shërbimin?
- 2) Kush e shfrytëzon shërbimin?
- 3) Kush i punëson pastruesit, vozitësit, makinistët, mësimdhënësit, mjekët dhe zjarrfikësit?
- 4) Çfarë do të ndodhë nëse këta njerëz nuk shkojnë në punë?

Më pas, mësimdhënësi çel diskutim për këto pyetje, nga i cili duhet të rezultojë se:

- 5) Ofrues i shërbimeve është shteti.
- 6) Shfrytëzues të shërbimeve janë të gjithë qytetarët.
- 7) Shteti është ai që i punëson pastruesit, vozitësit, makinistët, mësimdhënësit dhe mjekët.
- 8) Mësimdhënësi duhet të sqarojë se nëse këta njerëz nuk punojnë, jeta jonë si qytetarë do të ishte shumë e vështirë dhe nuk do të mund të funksiononim normalisht. P.sh.: do të grumbullohen mbeturina dhe lagjja dhe rrugët tona do të ishin të papastra, nuk do të ketë kujt t'i lajmërohemi nëse shpërthen ndonjë zjarr, etj.



Pjesa kryesore e orës


(15 min.)

Në vendet e zhvilluara qytetarët presin më shumë shërbime nga shteti, nga qasja deri te uji i pijshëm dhe energjia, mirëmbajtja e rrugëve, deri te arsimit cilësor, shëndetësia, siguria dhe realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve. Sa më shumë shërbime dhe të drejta presim aq më shumë njerëz nevojiten në sektorin publik për t'iu përgjigjur këtyre nevojave tona.

Thjeshtë, administrata publike i përfshinë të gjitha institucionet shtetërore që shërbejnë si servis prej ku qytetarët marrin shërbime dhe i realizojnë të drejtat e tyre që u janë të garantuara me ligj.

Nëpunës administrativ janë personat të cilët janë të punësuar në administratën publike dhe ushtrojnë shërbime për qytetarët, bizneset, shoqatat e qytetarëve, etj. Ata ndahen në nëpunës shtetëror dhe publik.

- 1) **Nëpunësit shtetëror janë të punësuar në organet shtetërore dhe lokale, si dhe organet tjera shtetërore: ministritë, organet në përbërje të ministrive, qeveria, kuvendi, presidenti i shtetit, avokati i popullit, shërbimet profesionale të njësive të vetëqeverisjes lokale, etj..**
- 2) **Nëpunësit publik janë të punësuar në institucionet që ushtrojnë veprimtari nga fusha e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, sporti, ndërsa janë të organizuar si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndërmarrje publike.**



**Aktivitet për reflektim dhe vlerësim:
(10 min)**

Nxënësit punojnë në çifte dhe secili çift duhet ta zgjidhë detyrën nga *Fleta e punës 5.5*, gjegjësisht t'i lidhë institucionet në tabelën e radhës me shërbimin përkatës që e ofrojnë. Nxënësit, të drejtuar nga mësimdhënësi, mund të japin shembuj edhe për institucione të tjera me shërbimet e të cilave kanë pasur përvojë.



Fletë pune 5.5

INSTITUCION	SHËRBIM
Shkollë	Kontroll i cilësisë së ajrit
Spital	Huazim të librit
Polici	Vaksinim
Teatër	Mësim me thyesa
Enti i statistikës	Marrja e pasaportës
Bibliotekë	Regjistrim i popullsisë
Inspektorat i mjedisit jetësor	Parashtrim i ankesës për të drejta të shkelura
Avokat i popullit	Shikim i shfaqjes

Tema

6

QYTETARI DHE EVROPA

Përmbajtja:



Bashkimi
Evropian
(BE)



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ T'i sqarojë strukturën, qëllimet dhe funksionimin e BE-së.



Rezultate nga nxënia:

- ➔ Nxënësi e sqaron funksionimin e BE-së përmes analizës së institucioneve të BE-së dhe kompetencave të tyre;



Materiale të nevojshme:

Letër, fllomasterë, Fletë pune 6.1, Fletë pune 6.2



Metoda, teknika, forma:

Teknika: DDM, Punë në grupe (përpilim i hartave mendore), diskutim grupor, vetëvlerësim




Aktivitet hyrës

(10 min.)

Në mënyrë që të shqyrtohet nëse nxënësit kanë dituri paraprakepërfunksionimineBashkimitEvropian, mësimdhënësi e fillon orën me shkrimin e tabelës DDM¹ në dërrasën e zezë. U bënë thirrje nxënësve që fillimisht të përgjigjen se çfarë dinë për BE-në dhe çfarë do të donin të dinë, derisa kolonën e fundit – Çfarë mësova, e plotësojnë në fund të orës.

ÇFARË DI PËR BE-NË?	ÇFARË DUA TË DI?	ÇFARË MËSOVA?

¹ DDM – di, dua, mësova



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Organizimi i punës së Bashkimit Evropian është i ndërlikuar për t'u kuptuar dhe shumë hulumtime tregojnë se një numër i madh i qytetarëve të vendeve-anëtare të Bashkimit nuk e kuptojnë mënyrën në të cilën punon Bashkimi. Pse atëherë të rinjtë nga vendi ynë të mundohen t'i kuptojnë vlerat në të cilat mbështetet Bashkimi, por edhe të njihet mënyra e punës së të njëjtit, veçanërisht lidhur me vendimmarrjen.

Në Bashkimin Evropian ekzistojnë institucione dhe trupa më të ndryshme. Mirëpo, vetëm pesë janë përkufizuar si institucione dhe konsiderohen si më të rëndësishme. Ato janë: Këshilli i Evropës, Parlamenti Evropian, Këshilli i BE-së (Këshilli i ministrave), Komisioni Evropian dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Aktiviteti **Prezantim i** **institucioneve të** **BE-së në formë** **grafike**

Secili nxënës merr një fletë me një prej pesë institucioneve kyçe të BE-së (Fletë pune numër 6.1). Ka 2-3 minuta për ta lexuar, pas çka mblidhet në grup me nxënësit tjerë që e kanë marrë institucionin e njëjtë dhe duhet të bëjnë një paraqitje grafike të institucionit, funksionin e tij, etj. Mund të përdorin skema, harta mendore, vizatime, etj. Me këtë rast, nuk është e thënë që të kufizohen vetëm në informacionet që u janë dhënë, por mund të hulumtojnë edhe në mënyrë plotësuese (nëse kanë qasje në Internet) ose të shtojnë atë që e dinë prej më përpara.

Nxënësve mund t'u tregohen disa paraqitje grafike për shembull.

Secili grup ka 15 minuta për ta bërë paraqitjen grafike, pas çka ua prezantojnë nxënësve të tjerë.



Diskutim dhe konstatim

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e informacioneve nga prezantimet e nxënësve dhe parashtron pyetje:

➔ - Çfarë mendoni, pse BE-ja ka aq shumë institucione të ndryshme?

Konstaton se përkundër faktit që secili institucion ushtron funksione të veçanta të saj, ato shërbejnë edhe për bashkëpunim të ndërsjellë, por edhe kontroll dhe kontrollim të funksionimit të ndërsjellë.



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min)

Secili nxënës në mënyrë individuale merr pyetësor me funksionet dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve të BE-së. Duhet ta plotësojë atë, e më pas ta shkëmbejë dhe krahasojë me një bashkënxënës. Në pyetjet në të cilat ka përgjigje të ndryshme, duhet të merren vesh me konsensus se cila është përgjigjja adekuate. Më pas, mësimdhënësi i jep përgjigjet e sakta të pyetjeve.

Në tabelë e plotëson edhe kolonën e fundit që ishte dhënë në hyrjen e orës (Çfarë mësova)

Pyetësor për reflektim – tabela e plotësuar me përgjigje

Kush	Këshilli i Evropës	Parlamenti Evropian	Këshilli i BE-së (Këshilli i ministrave)	Komisioni Evropian	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
Jep propozime për ligje të BE-së				X	
I aprovon ligjet e BE-së			X		
Përbëhet prej (vetëm) një përfaqësuesi /anëtari nga çdo vend i BE-së				X	
E zgjedhin qytetarët e BE-së		X			
I prezanton interesat e qytetarëve		X			
I prezanton interesat e BE-së /qeveritë e tyre			X		
Vendosë për interpretimin e ligjeve të BE-së					X
Përkufizon drejtimin e përgjithshëm politik të BE-së	X				
Siguron respektim të së drejtës së BE-së					X



Fletë pune 6.1

1. Këshilli i Evropës: trupi më i lartë i Bashkimit Evropian

Këshilli i Evropës është një trup që e përbëjnë kryetarët e vendeve dhe qeverive (Presidentë dhe/ose kryeministra) nga të gjitha vendet e BE-së, si dhe presidenti i Komisionit Evropian. Ky trup thirret katër herë në vit, për shkak të arritjes së marrëveshjes për politikë globale të BE-së dhe për shqyrtimin e përparimit të arritur. Ai është trupi më i lartë për marrjen e vendimeve në Bashkimin Evropian, prandaj takimet e tij në të shumtën e rasteve quhen "samite".

2. Parlamenti Evropian: zëri i njerëzve

Parlamenti Evropian është trup për të cilin votojnë qytetarët e Bashkimit Evropian dhe që i paraqet interesat e qytetarëve të Bashkimit Evropian. Ai i mbikëqyr aktivitetet e BE-së dhe së bashku me Këshillin, i miraton ligjet e BE-së. Zgjedhjet për Parlamentin Evropian mbahen çdo pesë vite, ndërsa të drejtë vote ka secili qytetar i BE-së që është i regjistruar si votues.

Parlamenti Evropian ka tri seli: Brukselin, Luksemburgun dhe Strasburgun. Luksemburgu është shtëpia e zyrave administrative, ndërsa takimet e gjithë Parlamentit mbahen në Strasburg dhe në Bruksel.

3. Këshilli i Bashkimit Evropian: zëri i vendeve anëtare

Këshilli i Bashkimit Evropian, së bashku me Parlamentin Evropian është institucioni kryesor gjatë marrjes së vendimeve në BE. Më parë ishte i njohur si "Këshilli i ministrave", ndërsa shkurtimisht quhet thjeshtë "Këshilli". Siç tregon edhe emri, në kuadër të Këshillit secili vend anëtar merr pjesë me një ministër. Lidhur me atë se cili ministër nga çdo shtet anëtar do të marrë pjesë në punën, varet nga çështjet që do të diskutohen në takimin e ministrave (për shembull, nëse diskutohen çështje të bujqësisë, atëherë janë të pranishëm ministrat e bujqësisë).

Kryesia e Këshillit ndryshon çdo gjashtë muaj në bazë të rotacionit, gjegjësisht secili vend anëtar ka mundësinë gjashtë muaj të jetë kryesues.

4. Komisioni Evropian: promotor i interesit të përbashkët

Komisioni është institucion i pavarur politik që i përfaqëson dhe promovon interesat e BE-së si tërësi. Ai është fuqi udhëheqëse në sistemin institucional të BE-së: propozon rregullore ligjore, politika dhe programe të veprimit dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Parlamentit dhe Këshillit. Atë e përbëjnë 28 komisarë, nga një i propozuar nga secili shtet anëtar. Secili prej komisarëve të Komisionit Evropian është kompetent për ndonjë prej sektorëve të komisionit (për shembull: për sektorin e zgjerimit është përgjegjës komisar i zgjerimit ose për sektorin e mjedisit jetësor është përgjegjës komisar i mjedisit jetësor) dhe ka mandat prej pesë vitesh.

5. Gjykata Evropiane e Drejtësisë: zbatim i ligjit

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, me seli në Luksemburg përbëhet prej 28 gjykatësve (nga një gjykatës nga çdo vend anëtar). Gjykatësit emërohen nga qeveritë e vendeve anëtare, por të gjithë gjykatësit janë të pavarur dhe secili prej tyre ka mandat prej gjashtë vitesh. Detyra kryesore e Gjykatës së Drejtësisë është të sigurojë respektimin e së drejtës së BE-së dhe interpretim dhe zbatim të drejtë të marrëveshjeve të Bashkimit.



Fletë pune 6.2

Pyetësor për reflektim

Shënoni me „√” në kolonën e saktë për secilën prej nëntë pyetjeve më poshtë.

Kush	Këshilli i Evropës	Parlamenti Evropian	Këshilli i BE-së (Këshilli i ministrave)	Komisioni Evropian	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
Jep propozime për ligje të BE-së					
I aprovon ligjet e BE-së					
Përbëhet prej (vetëm) një përfaqësuesi /anëtari nga çdo vend i BE-së					
E zgjedhin qytetarët e BE-së					
I prezanton interesat e qytetarëve					
I prezanton interesat e BE-së /qeveritë e tyre					
Vendosë për interpretimin e ligjeve të BE-së					
Përkufizon drejtimin e përgjithshëm politik të BE-së					
Siguron respektim të së drejtës së BE-së					

Përmbajtja:



Republika e
Maqedonisë
së Veriut në
Bashkimin
Evropian

Ora e parë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të sqarojë raportin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe BE-së
- ➔ Të dallojë bashkëpunimin mes RMV-së dhe BE-së në fusha të ndryshme.



Rezultate nga nxënia:

- ➔ Përshkruan bashkëpunimin mes RMV-së dhe BE-së.
- ➔ Identifikon një pjesë të kushteve që duhet të përmbushen për pranim në BE



Materiale të nevojshme:

Letër, stilograf, Fletë pune 6.3



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, punë në grupe (hulumtim), punë e mëvetësishme




Aktivitet hyrës

(10 min.)

Mësimdhënësi u jep nxënësve të shënojnë në fleta nga një qëndrim personal në pyetjen: *Pse ndjehem në mënyrë evropiane?* Secili nxënës shkruan përgjigjen dhe mësimdhënësi i mbledhë në një enë/kuti: Njëri prej nxënësve "tërheqë" disa përgjigje dhe i lexon me zë. Nxitet diskutim i shkurtër në bazë të përgjigjeve të nxënësve, që duhet të shkojë në drejtim të theksimit të identitetit kulturor evropian.

Pyetje për udhëzim:

- ➔ Çfarë ka kontribuar të ndjeheni si qytetar/qytetare të Evropës? (p.sh. shkëmbime të nxënësve, vizita në shtete evropiane, shikim të filmave evropian, lexim të librave të autorëve evropianë)
- ➔ Çfarë mendoni, si mund të forcohet ndjenja e "qytetar-ëve/eve të Evropës" në shtetet që ende nuk janë anëtare të BE-së?



Pjesa kryesore e orës

(25 min.)

Bashkimi Evropian (BE) paraqet bashkësinë e shteteve nga kontinenti evropian, që janë bashkuar me qëllim që të realizojnë interesa të përbashkët politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Bashkimi Evropian nuk është shtet, por partneritet unik i vendeve evropiane, të njohura si vende anëtare. Deri në vitin 2019 Bashkimi Evropian ka 28 vende anëtare.

Dyert e Bashkimit Evropian janë të hapura për të gjitha shtetet evropiane që i plotësojnë kriteret demokratike, politike dhe ekonomike për anëtarësim. Marrëveshjet për aderimin e një vendi të ri anëtar duhet doemos të jenë të aprovuara njëzëri nga të gjitha vendet anëtare. Para çdo zgjerimi të ri BE-ja duhet doemos të vlerësojë kapacitetin e saj për pranimin e anëtares/eve të re/-ja, si dhe aftësinë e institucioneve të saj që të vazhdojnë së funksionuari me sukses. Zgjerimi i BE-së i forcon dhe stabilizon demokracinë dhe sigurinë në Evropë, veçanërisht në vendet e reja anëtare dhe i rritë dukshëm potencialet e kontinentit për rritje ekonomike dhe tregti.

Aktiviteti Hulumtim

Nxënësit për hulumtimin e përdorin atë që e kanë mësuar paraprakisht dhe hulumtojnë në mënyrë plotësuese në internet. Nëse nuk ka internet në shkollë mësuesi përgatit materiale për secilin prej grupeve. Nxënësit ndahen në 3 grupe dhe secilit grup i jepet njëra prej detyrave vijuese:

Detyrë për grupin 1: Identifikim i kushteve për anëtarësim në BE

Detyrë për grupin 2: Bashkëpunimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian

Detyrë për grupin 3: Përfitime dhe obligime nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian

Grupet punojnë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe konsultim me mësuesin.

Hulumtimi vazhdon për detyrë shtëpie dhe përgatitje të prezantimit në orën e radhës.



Pjesa përfundimtare

(10 min.)

Si reflektim i punës shpërndani nxënësve *Fleta pune 6.3* me ushtrime dhe mundësoni 5 minuta që ta zgjidhin ushtrimin.

Më pas bëni një diskutim të shkurtër për çështjet nga fleta e punës, për secilën nga fushat e përmendura.



Fletë pune 6.3

Shënoni me „√” në kolonën e saktë për secilën prej nëntë pyetjeve më poshtë.

Shteti	Mund të hyjë në BE	Nuk mund të hyjë në BE
Që nuk ka liri të shtypit		
Që zbaton dënimin me vdekje		
Që u mundëson qytetarëve të tij të protestojnë kundër qeverisë		
Që zbaton zgjedhje parlamentare		
Në të cilin pushteti trashëgohet		
Në të cilën armata e përcakton politikën dhe madje mund edhe të ndërhyjë në punët e brendshme me fuqi ushtarake		
Në të cilin njerëzit konsiderohen të pafajshëm derisa faj i tyre nuk është vërtetuar nga gjykata		
Në të cilin ka vetëm një parti që gjithmonë është në pushtet		
Që i mbron pakicat, madje edhe kur shumica është kundër tyre		

Përmbajtja:



Republika e
Maqedonisë
së Veriut në
Bashkimin
Evropian

Ora e dytë



Qëllime të orës mësimore:

- ➔ Të sqarojë raportin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe BE-së
- ➔ Të dallojë bashkëpunimin mes RMV-së dhe BE-së në fusha të ndryshme.



Rezultate nga nxënia:

- ➔ Përshkruan bashkëpunimin mes RMV-së dhe BE-së.
- ➔ Identifikon një pjesë të kushteve që duhet të përmbushen për pranim në BE



Materiale të nevojshme:

Letër, stilograf



Metoda, teknika, forma:

Diskutim grupor, prezantim i rezultateve nga hulumtimi




Aktivitet hyrës

(5-10 min.)

Ora fillon me diskutim të shkurtër në temën “Evropa jemi ne” ose „Vlera të Bashkimit Evropian”

Udhëzime për diskutim:

A keni dëgjuar për frazën „Të bashkuar në diversitet”? Ky është slogani i Bashkimit Evropian dhe paraqet një pjesë të vlerave të Bashkimit. Derisa secili vend në Bashkimin Evropian ka kulturën, gjuhën dhe traditën e tij, të gjithë ata i ndajnë vlerat e njëjta të përbashkëta që duhet doemos t’i respektojnë nëse duan të jenë pjesë e Bashkimit. Një vlerë themelore që i bashkon të gjitha vendet anëtare është demokracia. Kjo do të thotë se vetëm vendet demokratike mund të jenë anëtare të Bashkimit Evropian, Vlerat tjera të Bashkimit Evropian që janë të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare janë: dinjiteti njerëzor, liria, barazia, sundimi i së drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtat e njerëzve që u takojnë grupeve të pakicave.



Pjesa kryesore e orës

(20-25 min.)

Bëhet prezantimi i asaj që është punuar nga hulumtimi nga ora paraprake dhe nga detyra e shtëpisë në temat si vijon:

Grupi 1: Identifikim i kushteve për anëtarësim në BE

Grupi 2: Bashkëpunimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian

Grupi 3: Përfitime dhe obligime nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian

Pas çdo prezantimi zhvillohet diskutim në të cilin përfshihen të gjithë në klasë

UDHËZIME PËR DISKUTIM:

Kritere për anëtarësim në BE:

Çdo vend evropian mund të aplikojë në Bashkimin Evropian nëse i respekton parimet e lirisë, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe liritë themelore dhe sundimin e së drejtës.

- ➔ Shteti që pretendon të bëhet anëtar duhet të ketë institucione të qëndrueshme që do të garantojnë demokraci, sundimin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektim dhe mbrojtje të pakicave;
- ➔ Të ketë ekonomi funksionale të tregut dhe kapacitet për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut në kuadër të Bashkimit;
- ➔ Aftësi për t'i marrë përsipër obligimet që i sjellë anëtarësimi në BE, duke përfshirë edhe mbështetjen për qëllimet e Bashkimit;
- ➔ Administratë publike e cila do të jetë e aftë t'i zbatojë ligjet e BE-së.

Hapa të anëtarëimit në BE (me pasqyrë të Republikës së Maqedonisë së Veriut)

- ➔ Marrëveshje për stabilizim-asocim me BE-në;
- ➔ Aplikacion për anëtarësim dhe marrje të statusit të vendit-kandidat

Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2005 mori statusin e vendit-kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian

- ➔ Marrje të rekomandimit për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE

Republika e Maqedonisë së Veriut ka marrë disa rekomandime për fillimin e bisedimeve

- ➔ Bisedime për anëtarësim me secilin vend-kandidat të përfaqësuar nga Komisioni Evropian

- Mbështetje nga Parlamenti Evropian me shumicë absolute
- Partneritet në procesin e aderimit: ndihmë nga BE-ja për vendet kandidate për ta arritur zhvillimin ekonomik të BE-së

Përfitime nga anëtarësimi në BE

- Paqe dhe bashkim të Evropës;
- Liri, siguri dhe sundim të së drejtës;
- Solidaritet ekonomik dhe social;
- Identitet evropian dhe pranim të diversitetit;
- Politikë e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë;
- Institucione të qëndrueshme me integritet në marrjen e vendimeve;
- Politika për inovacione, zhvillim dhe treg unik evropian;
- Ruajtje të mjedisit jetësor dhe zhvillim të qëndrueshëm;
- Ndihmë rajonale, politikë e përbashkët bujqësore, dimension social për përmirësimin e pabarazisë në shoqërinë evropiane;
- Bashkim ekonomik dhe monetar;
- Arsim dhe sistem shëndetësor më cilësor dhe zhvillim kulturor;
- Politikë e përbashkët e sigurisë dhe e jashtme.

Në bazë të kriterëve për anëtarësim dhe përfitimeve nga anëtarësimi nxirren **obligimet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.**



Pjesa përfundimtare:



Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min)

Në fund të orës pyetni nxënësit tuaj:

- ➔ Çfarë keni ditur për kriteret për anëtarësim dhe hapat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian para se të filloni këtë hulumtim?
- ➔ A i keni përmirësuar dituritë për përfitimet nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian?
- ➔ Në cilat fusha Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të bashkëpunojë më shumë me BE-në?
- ➔ Çfarë ju ndihmoi që të mësoni më mirë/të përvetësoni shkathtësi më të mira?
- ➔ A keni ndërtuar qëndrime personale derisa keni hulumtuar? Çfarë mendoni për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE?